

PARADIGMAT E SIGURISË SË MAQEDONISË: SFIDA DHE MUNDËSI

Fatmir Xheladini

Dorëzuar :

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Skencat Sociale,
me profil Marrëdhënie Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Kristaq Xharo

Numri i fjalëve: 51200

Tiranë , Shkurt 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Me përgjegjësinë time deklaroj se punimi është fryt i punës sime dhe nuk është prezantuar ndonjëherë para ndonjë institucioni tjetër. Punimi nuk përmbanë material të shkruar nga ndonjë person tjetër dhe paraqitja e tyre në punim është bërë konform standarteve të kërkuara për referim dhe citim.

ABSTRAKTI

Sfidat e sigurisë që u shfaqën pas shpërbërjes së shteteve të mëdha mutlinacionale dhe shpalosja e një sërë konfliktesh etnike nga shpërbërja e Jugosllavisë e më gjerë, e sfiduan ndjeshëm zbatueshmërinë e koncepteve ekzistuese për shpjegimin e sigurisë në kontekstin e ri global. Pikëpamja tradicionale e sigurisë, e redukton konceptin kompleks të sigurisë në një sinonim të thjeshtë për pushtet. Konceptet e deriatëhershme, të bazuara mbi shtetin dhe fuqinë dhe të fokusi i tyre mbi aspektet ushtarake të sigurisë, nuk arritën të marrin parasysh kërcënimet e ndryshme joushtarake që filluan të paraqiten si rezultat i ndryshimeve në rendin global.

Pavarësisht qasjeve të ndryshme të formimit të shtetit dhe të shtetndërtimit, që u aplikuan pas Luftës së Ftohtë, ato përsëri kanë qenë të prirura që të angazhohen në një formë shtetndërtimi apo sigurie në një mënyrë që ka kërkuar të ndryshojë gjendja e grupit dominues etnik duke përdorur mekanizmat institucionalë të shtetit. Kjo prirje drejt privilegjimit etnik ka treguar shpesh një preferencë të dukshme për homogjenizimin dhe diskriminimin në procesin e ndërtimit të shtetit. Një rast të veçantë në këtë drejtim përbën edhe Republika e Maqedonisë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1991. Ajo pati sukses në shmangien e një përplasjeje të armatosur në fillim të viteve '90, si rrjedhojë e kërcënimeve të atëhershme të ushtrisë Jugosllave, ndonëse mosidentifikimi i drejtë i sfidave të brendshme nga liderhipi shtetëror i hapi rrugën një revolte të armatosur shqiptare në vitin 2001.

Studimi do ketë si qëllim jo vetëm analizimin e impaktit ushtarak në sigurinë e Maqedonisë, por edhe fusha të tjera si ajo politike, shoqërore, ekonomike etj. Kjo për shkak

të kompleksitetit të përkufizimit të përparësive se çfarë nënkupton në të vërtetë siguria në Maqedoni? Për kë aplikohen masat e sigurisë dhe si mund të konceptohet ajo nga një perspektivë e komunitetit shqiptar që jetonë aty? Një zhvillim i tillë i ngjarjeve kryesisht ndërthuret me identifikimin dhe analizën e implikimeve të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë në një kontekst bashkohor të vlerësimit të masave që do të anulnin perceptimet për rreziqet dhe pasigurinë, si nga jashtë ashtu edhe nga brenda.

ABSTRACT

Security challenges that emerged after the breakup of large multinational states and the exposure of a number of ethnic conflicts from the breakup of Yugoslavia and beyond, sharply challenged the applicability of existing concepts to explain security in a new global context. The traditional view of security, where it is seen as a derivative of power, reduces the complex concept of security in a simple synonym for power. The concepts of the time, based on state and power and their focus on the military aspects of security, failed to take into account the various non-military threats that began to appear as a result of global changes.

Despite different approaches to state formation and nation-building, which the newly established states or those in transition have undertaken after the Cold War, they still have been inclined to engage in a form of state-building or security in a way that sought to change the situation of the dominant ethnic group using institutional mechanisms of the state. This trend towards ethnic privilege has been repeatedly demonstrated as a marked preference for homogenization and discrimination in the process of state building. An instance of reference in this regard constitutes Republic of Macedonia after the declaration of independence in 1991. It succeeded in avoiding armed clashes in the early 90s, as a result of threats from the then Yugoslav army, although the failure of the state leadership to identify the correct internal challenges gave way to armed Albanian revolt in 2001.

The study will aim at analyzing the impact of the Macedonian security challenges through the lenses of a widened security agenda by incorporating into analysis other areas that may influence it such as political and social sectors. This is due to the complexity of defining priorities and what actually constitutes security in Macedonia? For whom security

measures are applied and how those are perceived by the Albanian community who lives there? Such an approach is mostly combined with the identification and analysis of the Macedonia's security paradigms, its implications and evaluation in a contemporary context and the measures that invoke perceptions of risks and uncertainties, both from outside and from within.

FALENDERIME

Fillimisht dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për udhëheqësin shkencor Prof. Dr. Kristaq Xharo i cili me njohuritë, urtësinë dhe përkujdesjen e tij të vazdueshme ka kontribuar në çdo moment të përpilimit të punimit duke ndihmuar në përfundimin e asaj që do të kishte qenë e vështirë.

Një falenderim të veçantë dua të shpreh për Prof. Dr. Përparim Fuga i cili me vizionin, urtësinë dhe profesionalizmin e tij ka qenë një shtysë e rëndësishme që në pikënisjen e punimit.

Një falenderim dua t'ia dedikoj departmentit të shkencave politike/marëdhënie ndërkombëtare dhe shkollës doktrale pran UET tek të cilët kam gjetur gjithnjë inkurajim në tejkalimin e sfidave të shumta gjatë këtij rrugëtimi.

Falenderim të veçantë i dedikojë familjes për mbështetjen e pakushtëzuar duke qenë një motivim për përfundimin e suksesshëm të këtij punimi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë.....	2
Abstrakt.....	3
Abstract.....	5
Falenderime.....	7
Përmbajtja e lëndës.....	8
Lista e shkurtimeve.....	11
KAPITULLI I: HYRJE.....	13
1. Hyrje.....	13
1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	15
1.3 Pyetje kërkimore dhe hipoteza/t e studimit.....	18
1.3.1 Pyetjet kërkimore.....	18
1.3.2 Hipotezat.....	18
1.4 Metodologjia.....	19
1.4.1 Modeli i hulumtimit.....	19
1.4.2 Operacionalizimi i koncepteve.....	21
1.4.3 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave.....	24
1.5 Mundësitë dhe kufizimet e punimit.....	29
1.6. Struktura e punimit.....	31

KAPITULLI II: KONCEPTI TRADICIONAL I SIGURISË: NJË QASJE NDAJ SHTETIT DHE FORCËS35

2.1 Evoluimi i nocionit të sigurisë.....35

2.2 Shkollat tradicionale mbi sigurinë.....39

2.2.1 *Një vështrim mbi teorinë realiste dhe idealiste.....42*

KAPITULLI III: DREJTË NJË KORNIZË TË ZGJERUAR DHE THELLUAR MBI SIGURINË.....59

3.1 Qasja konstruktive drejt sigurisë.....52

3.2.1. *Qasja konstruktive drejt identitetit.....57*

3.2 Qasja e Shkollës së Kopenhagenit.....59

3.2.2. *Teoria e sigurizimit.....64*

3.2.2. *Siguria shoqërore.....69*

3.2.3 *Kompleksi i sigurisë rajonale.....73*

3.3. Përmbledhje mbi dinamikën e studimit dhe analizës.....79

KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK DHE PAVARËSIA.....85

3.1 Zhvillimet historike dhe gjendja
e ndryshueshme e sigurisë.....85

3.2 Zhvillimet deri te shpallja e pavarësisë.....88

3.3 Gjendja demografike dhe grupet etnike.....96

3.4 Identiteti dhe perceptimet ndaj shtetit.....104

3.5 Sistemi dhe organizimi politik.....113

3.6	Konkluzione.....	117
KAPITULLI IV: KONTEKSTI RAJONAL.....		120
4.1	Maqedonia dhe kompleksi i sigurisë rajonale (nënrajonale).....	120
4.2	Federata Jugosllave dhe Serbia.....	125
4.3	Marrëdhëniet me Bullgarinë.....	128
4.4	Marrëdhëniet me Greqinë	131
4.5	Shqipëria.....	136
4.6	Prania e strukturave ndërkombëtare dhe rajonale.....	137
4.7	Konteksti i sigurisë së Maqedonisë nga këndvështrimi i pranisë ndërkombëtare/rajonale.....	141
4.8	Konkluzione.....	149
KAPITULLI V: KONTEKSTI I SIGURISË SË BRENDSHME.....		151
5.1	Dilemat dhe arsyet e përshkallëzimit (sigurimit) të brendshëm	151
5.2	Dilemat e sigurisë dhe agjendat politike.....	156
5.3	Marrëveshja e Ohrit.....	166
5.4	Konkluzione.....	178
KAPITULLI VI: PËRFUNDIME.....		181
BIBLIOGRAFIA.....		189

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

SHP i ARM	- Shtabi i Përgjithshëm i Armatës së Republikës së Maqedonisë
KE	- Komisioni Evropian
PEF	- Politika Evropiane e Fqinjësisë (ENP)
BE	- Bashkimi Evropian
PPSM	- Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP)
PPJS	- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP)
EJL	- Evropa Juglindore
CARDS	- Ndihmë Bashkësisë për Rikonstrukcion, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS)
KFOR	- Forcat e OKB (më vonë NATO) për Ruajtjen e Paqes në Kosovë (KFOR)
MPB	- Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	- Ministria e Punëve të Jashtme
MB	- Ministria e Mbrojtjes
NATO	- Alenca e Atlantikut - Verior (NATO)
OSBE	- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)
UÇK	- Ushtria Çlirimtare Kombëtare

OKB	- Organizata e Kombeve të Bashkuara (UN)
RM	- Republika e Maqedonisë
SHBA	- Shtetet e Bashkuara të Amerikës
KiE	- Këshilli i Evropës
RSFJ	- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UNPREDEP	- Forcat e Shpërndara Parandaluese të OKB (UNPREDEP)

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Hyrje

Përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe dështimi i rendit të deriatëhershëm për të parashikuar situatat e reja kanosëse për sigurinë e shteteve dhe kombeve, u hapi rrugën mendimeve dhe debateve për çështje që kishin të bënin me sigurinë në arenën ndërkombëtare. Dinamikat e rrezikshme të sigurisë që u shfaqën pas shpërbërjes së shteteve të mëdha mutlinacionale dhe shpalosja e një sërë konfliktesh etnike nga shpërbërja e Jugosllavisë e më gjerë, e sfiduan ndjeshëm zbatueshmërinë e koncepteve ekzistuese për shpjegimin e sigurisë në kontekstin e ri global.

Pikëpamja tradicionale e sigurisë, ku ajo shihej si derivat i pushtetit, e redukton konceptin kompleks të sigurisë në një sinonim të thjeshtë të pushtetit. Kjo pikëpamje mund të konsiderohet relavante gjatë Luftës së Ftohtë dhe para saj, kur shtetet ishin në një kompeticion të vazhdueshëm për pushtet. Por, pas Luftës së Ftohtë, koncepti i sigurisë është bërë më i gjithanshëm dhe kompleks.

Konceptet e deriatëhershme, të bazuara mbi shtetin dhe fuqinë dhe te fokusi i tyre mbi aspektet ushtarake të sigurisë, nuk arritën të marrin parasysh kërcënimet e ndryshme joushtarake që filluan të paraqiteshin si rezultat i ndryshimve në rendin global, i vendosur mbi premisat e aspekteve ushtarake mbi sigurinë. Shqetësimet e reja, të vendosura në stade shumëpërmasore të ndërveprimit të shteteve dhe popujve, prodhuan mospajtime dhe perceptime në një gjendje të vazhdueshme transformimi në nivel global, rajonal dhe lokal. Shumë prej shteteve në ndërtim e sipër apo në proces tranzicioni, që u sfiduan nga këto paraqitje në nivel global, dështuan që t'i marrin në konsideratë ato, ose në raste të

ndryshme nuk ishin as në gjendje të përballonin sfidat që ia behën, dhe si rrjedhojë problemet nisën të shfaqen rishtazi duke nxitur konflikte etnike, siç qe rasti me ish-Jugosllavinë e më gjerë.

Pavarësisht qasjeve të ndryshme të formimit të shtetit dhe të shtetndërtimit, që shtetet e sapo krijuara apo në tranzicion kanë ndërmarrë pas Luftës së Ftohtë, ato përsëri kishin prirjen që të angazhoheshin në një formë shtetndërtimi apo sigurie në një mënyrë që kërkonte ndryshimin e gjendjes së grupit dominues etnik, duke përdorur mekanizmat institucionalë të shtetit. Kjo prirje drejt privilegjimit etnik, shpesh ka treguar një preferencë të dukshme për homogjenizimin dhe diskriminimin në procesin e ndërtimit të shtetit. Në të shumtën e rasteve kjo ka ndodhur nëpërmjet një qasjeje të heshtur, duke miratuar politika diskriminuese ndaj grupeve të vogla dhe duke çuar në konsolidimin e ngadalshëm të grupeve të mëdha në hierarkinë e shtetit.

Një rast të veçantë në këtë drejtim përbën edhe Republika e Maqedonisë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1991. Ajo pati sukses në shmangien e një përplasjeje të armatosur në fillim të viteve '90, si rrjedhojë e kërcënimeve të atëhershme të ushtrisë Jugosllave, ndonëse mosidentifikimi i drejtë i sfidave të brendshme nga lidhshipi shtetëror i hapi rrugën një revolte të armatosur shqiptare në vitin 2001. Kjo zhvendosje e gjendjes së sigurisë përbën një moment të rëndësishëm analize për shkaqet dhe arsyet e evoluimit të pasigurisë së Maqedonisë nga siguria e jashtme te pasiguria e brendshme, dhe në distancë kohore me paraqitje të ndryshueshme dhe anasjellatas.

Një zhvillim i tillë i ngjarjeve ndërthuret kryesisht me identifikimin dhe analizën e implikimeve të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë në një kontekst bashkëkohor të vlerësimit të masave që do të anulonin perceptimet për rreziqet dhe pasigurinë, si nga jashtë

ashtu edhe nga brenda. Qasja ndaj këtyre sfidave kërkon një analizë të rethanave të reja të gjendjes së sigurisë në dy drejtime: në vija horizontale, duke analizuar sektorë shtesë që përbëjnë diskursin e rëndësishëm mbi sigurinë në Maqedoni; si dhe vertikale, duke patur parasysh faktin se nivele të rëndësishme të sigurisë në periudhën pas Luftës së Ftohtë përbëhen edhe nga njësi shtesë, që kërkojnë trajtim dhe qasje adekuate.

Për sa më sipër, duket qartë se sa i dobishëm është kërkimi i shkaqeve të tensioneve midis komuniteteve maqedonase dhe shqiptare në Republikën e Maqedonisë, jo vetëm në lidhje me çështjet emergjente dhe ngjarjet që ato shkaktojnë, por edhe në lidhje me faktorët strukturorë që formësojnë kornizën e një përplasjeje të tillë. Faktorë të tillë strukturorë, – sa për të përmendur disa – përfshijnë diskriminimin politik dhe pabarazitë ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Këto elemente që gjenerojnë pakënaqësinë e njerëzve vazhdojnë të jenë të një rëndësie të madhe në Republikën e Maqedonisë.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i paradigmave të sigurisë së Maqedonisë dhe implikimi i sigurisë shoqërore në zhvillimin e politikave të sigurisë, duke analizuar se pse masat e aplikuara për siguri në raste dhe nivele të ndryshme të analizës rezultojnë të kenë qasje të ndryshme në perceptimin dhe trajtimin e tyre. Studimi do përfshijë jo vetëm analizën rreth impaktit ushtarak në sigurinë e Maqedonisë, por edhe fusha të tjera si ajo politike, shoqërore, ekonomike etj., për të analizuar kështu çështjet që karakterizohen si masa të një interesi parësor në arritjen e sigurisë për komunitetin shqiptar dhe mbrojtjen apo cenimin e tyre nga institucionet shtetërore. Kjo për shkak të kompleksitetit të përkufizimit të përparësive se çfarë nënkupton në të vërtetë siguria në Maqedoni. Për kë

aplikohen masat e sigurisë dhe si mund të konceptohet ajo nga një perspektivë e komunitetit shqiptar që jeton aty?

Në funksion të përmbushjes së qëllimit, objektivi i paracaktuar në këtë punim është shqyrtimi i situatës së sigurisë në tre nivele analitike. Sjellja e aktorëve si në mjedisin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm nuk mund të kuptohet pa njohur më parë ambientin e sigurisë dhe karakteristikat e saj për çdo nivel.

i. Identifikimi dhe analizimi i pasojave që vijnë nga masa e përparësisë së çështjeve të sigurisë dhe ndërveprimi i tyre me sigurinë apo pasigurinë e aktorëve.

Për matjen e këtyre implikimeve mbështetemi te sjellja e aktorëve, te diskursi i tyre dhe te perceptimi i sigurisë, sikurse edhe te dokumentet e tyre kryesorë strategjikë. Masa e përparësisë së çështjeve të interesit për aktorët e përfshirë, apo sigurizimi i këtyre çështjeve, përcakton edhe efektet në nivel të brendshëm e të jashtëm të sigurisë.

ii. Identifikimi dhe analizimi i nivelit të bashkëpunimit midis aktorëve në funksion të garantimit të sigurisë.

Për më shumë studimi do thellohet në aspektet e ndryshme të maksimalizimit të stabilitetit nga një pikënisje që në literaturën mbi sigurinë shoqërore referohet si “shtete të dobëta”, ku ndër të tjera, aktorët sigurizues në këto shtete, me nismat institucionale të tyre krijojnë edhe më shumë pasiguri. Kjo gjendje bëhet e rëndësishme kur ndërthuret me pozicionin e tyre në lidhje me marrëdhëniet me aktorë të tjerë me qëllim garantimin e sigurisë.

Një analizë e tillë do shërbejë për të zbërthyer origjinën e tensioneve mes bashkësisë shqiptare dhe maqedonase, në mënyrë që të shohim perceptimet e ndryshme mbi

identitetin e shtetit dhe shtetndërtimit, gjendjen strukturore dhe normat institucionale si arsye e drejtpërdrejtë e konfliktit.

Shqyrtimet e përfshira në këtë studim përqendrohen në dy segmente kryesorë:

i pari tregon një analizë në lidhje me origjinën e tensioneve mes bashkësisë shqiptare dhe maqedonase nga pikëpamja e ideologjisë së shtetndërtimit, në mënyrë që të dalë në pah gjendja strukturore dhe normat institucionale si arsye të drejtpërdrejta të konfliktit;

i dyti i referohet të gjitha parakushteve ekzistuese dhe atyre që janë krijuar rishtas për dinamikën e veprimit dhe kundërveprimit mes komunitetit shqiptar dhe atij maqedonas, të vëzhguar përmes një kuadri konceptor për sigurinë shoqërore në drejtim të një analize për aspektin e brendshëm, duke inkorporuar perceptimet e ndryshme shoqërore në formësimin e politikave të sigurisë.

Po ky shqyrtim i dinamikës së veprimit dhe kundërveprimit do përqendrohet te aspektet e ndryshme të analizës së kompleksit rajonal të sigurisë, duke analizuar perceptimet për kërcënimet ndaj identitetit shtetëror nga jashtë, dhe se si reflektojnë ato në përparësinë e politikave të sigurisë së shtetit nga brenda.

Për më shumë studimi do të thellohet në aspektet e ndryshme të maksimalizimit të stabilitetit nga një pikëpamje që në literaturën për sigurinë shoqërore referohet si “shtete të dobëta”, kur ndër tjera, aktorët sigurizues në këto shtete, me nismat institucionale të tyre krijojnë edhe më shumë pasiguri.

1.3 Pyetje kërkimore dhe hipoteza/t e studimit

1.3.1 Pyetjet kërkimore bazë që ngre studimi janë:

Pyetja kërkimore

- *Si ka ndikuar perceptimi mbi sigurinë në Maqedoni në nivelin e sigurisë së këtij vendi dhe si mund të tejkalohen problematikat e krijuara nga një perceptim i tillë?*

Nënpyetjet kërkimore

- i. Si u është përgjigjur Maqedonia perceptimeve të sigurisë në planin e brendshëm dhe atë të jashtëm?
- iii. Cilët janë instrumentet në përmbushjen e përparësive të politikës fqinjësore dhe asaj në kontekstin rajonal?
- iv. Cilat janë relacionet e brendshme shoqërore mes komuniteteve të ndryshme në Maqedoni, dhe si ndikojnë këto relacione në kohezionin dhe stabilitetin e shtetit?

1.3.2 Hipotezat bazë të studimit

Hipoteza bazë e punimit

Perceptimi mbi sigurinë në Maqedoni, nëpërmjet së cilit janë identifikuar kërcënimet por edhe zgjidhjet e mundshme, kanë bërë që Maqedonia të ballafaqohet me sfida të paradigmes më serioze të sigurisë, dhe në këtë kontekst, një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj Marrëveshjes së Ohrit do mbetet si një objektiv referencë për zgjidhje të qëndrueshme.

Nën hipoteza

Zgjerimi i një perceptimi se çfarë nënkupton siguria, kush dhe çfarë duhet siguruar në Maqedoni, shfaqet si një sifidë, por në të njëjtën kohë edhe si një mundësi për stabilitetin e brendshëm dhe politikën e jashtme të Maqedonisë.

1.4 Metodologjia

1.4.1 Modeli kërkimor

Modeli kërkimor mbi të cilën mbështetet studimi është ai i rastit studimor që vë në qendër të analizës kontekstin e paradigmave të sigurisë së Maqedonisë. Arsyeja e zgjedhjes së modelit “rast studimor” është fakti se ai mundëson një analizë të thelluar të çështjes në fjalë, si dhe grumbullimin e të dhënave të ndryshme për të, që në rastin konkret nisin nga ato faktike dhe vijonë me ato vlerësuese. Për më tepër, rasti studimor përqendrohet te një segment specifik i çështjes, por në të njëjtën kohë duke përdorur një qasje tërësore, sepse në këtë mënyrë bëhet i mundur zbulimi i marrëdhënieve që ekzistojnë midis pjesëve përbërëse të rastit në një kontekst të përgjithshëm shoqëror. (Mathew dhe Ross, 2010 f.128)

Për studimin tonë, modeli i rastit studimor është i përshtatshëm ngaqë mundëson identifikimin dhe analizën e mekanizmave shkakësorë që mund t’u referohen parakushteve ekzistuese dhe atyre të krijuara rishtas në dinamikën e veprimit dhe kundërveprimit. Për të analizuar gjithë këtë, punimi nisët nga qëllimi i studimit, objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e tij.

Duke pasur parasysh këtë, rasti studimor i këtij punimi ndahet në tri nivele analize, që nënkutpon se objekti i analizës në këtë rast do të jetë Maqedonia si objekt referent shteti në nivel të mesëm; aspekti rajonal, duke patur si kontekst institucionet rajonale, siç janë ato të BE-së dhe fqinjësia e Maqedonisë në nivel makro dhe komunitetet brenda Maqedonisë, me fokus të veçantë te komuniteti shqiptar.

Çështjet e sigurisë së komunitetit dhe identitetit të grupeve etnike zënë një vend të rëndësishëm në diskursin mbi sigurinë në Maqedoni dhe në rajon, dhe në raste të tilla, kur kemi të bëjmë me shtete që ndërveprojnë për arsye gjeografike apo kulturore, kjo na çon në zgjedhjen e një analize të kësaj natyre.

Prandaj analiza e rastit në tri nivele na jep mundësinë që në kushte kur çështja e debatit të sigurisë ka të bëjë me relacionet e jashtme të objektit referues shtet, por edhe më gjerë me spektrin rajonal, si dhe me implikimet e brendshme të komuniteteve që konstituojnë shtetin. Kjo për arsyen që të shpjegojmë mekanizmat shkakësorë që mund të sjellin perceptime apo dhe implikime të ndryshme që mund të jenë të ndërvarur me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, punimi synon të identifikojë variablat që ndikojnë në krijimin e situatave të ndryshme, duke shpjeguar mekanizmat shkakësorë dhe se si reflektojnë ata mbi sigurinë.

Strategjia kërkimore për këtë studim do përqendrohet te një kombinim i kërkimit krahasues dhe vlerësues. Ndonëse modeli i kërkimit u përmend më lart, se është ajo e rastit studimor, ku mundësohet grumbullimi i shumë të dhënave të ndryshme, është e dobishme që në këtë rast të merren variacione më të sakta nga kërkimet, në mënyrë që të kemi mundësi të bëjmë një analizë rreth dukurive të ndryshme të ndërveprimit shoqëror.

Kërkimi krahasues përdoret për të studiuar paraqitje që mund të analizohen paralelisht duke përfshirë një shqyrtim të hollësishëm të një aspekti, të një politike, çështjeje apo karakteristike brenda rastit, dhe këto krahasohen mbi bazën e një grupi kriteresh të përbashkëta, duke spikatur ngjajshmëritë dhe dallimet në kontekst nga pikpamja e dy ose më shumë perpesktivave të ndryshme. Kërkimi krahasues ndihmon në gjetjen e përgjigjes për pyetjen dhe hipotezën e dytë kërkimore që lidhet me faktorët që përcaktojnë procesin e sigurizimit në raste të ndryshme. Ndërsa kërkimi vlerësues lidhet zakonisht me një ndërhyrje ose ndryshim që është bërë duke vlerësuar nëse ndërhyrja ka arritur ndryshimin ose rezultatet e parashikuara apo është vijuar më tej me implikime të tjera. Kërkimi vlerësues mundëson mbledhjen e një game të gjerë të dhënash, si sasiore ashtu edhe cilësore. (Mathew dhe Ross, 2010)

Kërkimi vlerësues në këtë studim fokusohet si te vlerësimi i spektrit të sigurisë rajonale lidhur me Maqedoninë, ashtu edhe te vlerësimi i implikimeve të sifdave dhe mundësive të situatës së sigurisë në aspektin e brendshëm për Maqedoninë. Vlerësimi i situatës së sigurisë për Maqedoninë kryhet nëpërmjet identifikimit të treguesve kryesorë të paradigmave të sigurisë së këtij shteti, duke zbuluar sjelljen e aktorëve të sigurisë në të tria nivelet e analizës: diskursi publik mbi sfidat dhe mundësitë e sigurisë, dokumentet themelore/statutore dhe strategjike mbi sigurinë në Maqedoni. Kërkimi vlerësues përdoret për t'i dhënë përgjigje pyetjes së parë kërkimore dhe hipotezës së parë. (Mathew dhe Ross, 2010)

1.4.2 Operacionalizimi i koncepteve

Qëllimi i këtij studimi do të jenë paradigmat e sigurisë së Maqedonisë dhe implikimi i faktorëve të ndryshëm në përpilimin e politikave të sigurisë së Republikës së

Maqedonisë. Së këndejmi, qasja e punimit do jetë e orientuar te përkufizimi i dhënë nga Buzan, i cili merr rastin e një shteti të përbërë nga tre elemente: ideja e shtetit, gjendja fizike e tij dhe shprehja institucionale. (Buzan, 1991)

Ky përkufizim na jep mundësinë e një qasjeje shumëpërmasore, që kombinon perspektivat historike në një situatë ndryshimi në marrëdhëniet mes shtetit dhe organizimit të atyre ideologjive që kanë si pasojë dinamikën e ndryshimit të qasjes ndaj paradigmave të sigurisë në formë apo në thelb. Nisur nga kjo, çështjet e natyrës së identitetit të shtetit do i analizojmë që nga fillimi e në vazhdim, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë për konceptin dhe identitetin e shtetësisë dhe sovranitetit të Maqedonisë. Në këtë mënyrë do të bëjmë disa shpjegime se si krijohen dhe formulohen interesat shtetërorë apo si rrjedh ky proces nga perspektiva e aktorëve të përfshirë.

Baza fizike e shtetit nënkupton çështje si territori, kufijtë dhe popullsia, që janë të gjithë elementet që përbëjnë shtetin. Qëllimi i analizës në këtë drejtim është vëzhgimi i variablës së komuniteteve që përbëjnë shtetin dhe ndikimin e saj në korrelacion me çështjet e sigurisë së Maqedonisë. Kjo do të bëhet përmes analizës së funksionit themelor të shtetit, për të siguruar dhe plotësuar nevojat e komunitetit në mënyrë të përshtatshme dhe në bazë të perceptimit të tyre në drejtim të asaj që përbën siguri për ta. Analiza e funksionit të shtetit dhe nevojave të komuniteteve nxjerr në pah se çfarë qasjeje percepton ai për komunitetet, inkluzive apo ekskluzive, dhe anasjelltas: si perceptohet ajo nga komunitetet.

Një hapësirë të rëndësishme në këtë studim do të kenë edhe aspektet normative/institucionale dhe dokumentet e rëndësishme që rregullojnë marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme të shtetit. Kjo do të bëhet gjatë paraqitjes së zhvillimeve mbi adoptimin e këtyre dokumenteve që në shpalljen e pavarësisë më 1991 (si dhe kushtetuta e

adoptuar po atë vit), mbi ndryshimet që ndodhën si rezultat i luftës së vitit 2001 dhe mbi aspiratat e shqiptarëve të Maqedonisë për një përfshirje të plotë si entitet i veçantë dhe shtetformues. Këto dokumente do të analizohen në bazë të ngjarjeve historike që e paraprin dhe e përshpejtuat këtë adoptim.

Por, njëkohësisht, duke e marrë në konsideratë politikat e sigurisë dhe rëndësinë e tyre në kuadër të hapësirës në të cilën ndodhet fizikisht shteti. Një pjesë të rëndësishme do të ketë edhe aspekti ndërkombëtar/rajonar i sigurisë, kështu që analizat dhe rekomandimet që përmban studimi përkojnë me lidhjet e shtetit maqedonas në kontekstin e kompleksit të sigurisë rajonale dhe statusin e saj për sa i përket progresit dhe perspektivave në kuadër të integritimeve euroatlantike.

Studimi i kushton vëmendje analizës së çështjeve të prekura më lart dhe sigurimit të tyre. Në këtë drejtim, të një rëndësie të veçantë paraqiten masat që ndërmerren në procesin e sigurimit të tre elementeve që përbëjnë shtetin. Për të arritur te një kuptim i drejtë i procesit të sigurimit, është e rëndësishme të kemi një qasje shumëpërmasore, në mënyrë që të kuptojmë kërcënimet që paraqiten për këto tre segmente, dhe se si perceptohen ato më tutje. Kjo mund të arrihet përmes një analize që kërkon shtjellimin e realitetit social, ku analiza përqendrohet në përfitim të konstruktit shoqëror.

Por, për të analizuar sigurimin është e nevojshme të futemi te konstelacionet politike dhe shoqërore, gjë që mund të arrihet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Analiza e diskursit politik paraqitet e një rëndësie të parëdoshme, sepse përmes saj kuptojmë fjalorin me të cilin është ndërtuar dialogu ndërmjet aktorëve të përfshirë. Si është përqendruar dhe zhvilluar diskursi dhe në ç'masë e ka ngritur peshën e çështjes në diskutim. Një rol të rëndësishëm këtu ka edhe sfondi publik i dialogut, dhe jo vetëm i personit apo individit të

përfshirë, sepse që andej matet niveli që ka prekur dialogu në masën publike. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998)

Më tej akoma në këtë drejtim, studimi inkorporon mënyrën e teoretizimit të politikës së sigurimit dhe funksionin e saj në parandalimin e konflikteve në shtet. Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë të gjitha karakteristikat e shoqërisë maqedonase dhe të sistemit të sigurisë, politika e sigurisë perceptohet si një veprimtari gjithëpërfshirëse për realizimin e atyre qëllimeve politike që mund të ndikojnë mbi parandalimin e përplasjeve të brendshme në vend dhe përshkallëzimin politik, para së gjithash në lidhje me çështjet ndëretnike dhe ndërpolitike, por edhe për sa i përket çështjes së konsensusit politik për çështjet kryesore të sigurisë.

1.4.3 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

Duke qenë se punimi përqendrohet te rasti studimor si model kërkimi, duhet theksuar se është e nevojshme një larmi të dhënash për një trajtim adekuat të temës së zgjedhur. Kjo pasi lind nevoja e një mbulimi të hollësishëm dhe e një eksplorimi të detajuar për trajtimin e të gjitha aspekteve të shtruara për shqyrtim. Me përzgjedhjen e rastit studimor si model kërkimi, subjekti i analizës mund të jetë shumëpërmasor, por gjithmonë duke qartësuar aspekte të veçanta të interesit dhe çfarë do jetë në shqyrtim gjatë analizës. (Mathews dhe Ross, 2010, f. 128)

Gjatë këtij procesi, lidhja e domosdoshme dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me hipotezat e studimit dhe pyetjet kërkimore të theksuara më lart është themelore. Të dhënat e grumbulluara do të shërbejnë për një shpjegim më konkret të dukurive me anë të provave, si dhe duke qartësuar dyshimet e mundshme të shtruara nga pyetjet kërkimore. Pra,

materiali i grumbulluar do të shërbejë për të provuar hipotezën e këtij studimi. Në bazë të të dhënave të grumbulluara mbi ngjarjet dhe ndodhitë, do mund të analizojmë ecuritë e këtyre ngjarjeve dhe ndryshimet që kanë sjellë, si dhe cilat kanë qenë implikimet e këtyre ndryshimeve. (Sokoli, 2011, f. 68)

Meqë më sipër u theksua se qasja metodologjike e përdorimit të të dhënave është e kombinuar, ngaqë do përfshijë elemente cilësorë dhe sasiorë, duhet nënvizuar se gjetja dhe spikatja e të dhënave cilësore dhe sasiorë shpeshherë sjell vështirësi në identifikimin dhe grupimin e tyre.

Kjo ndodh ngaqë që të dyja njësitë e të dhënave janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, dhe në raste të caktuara sjellin rezultate që kryesisht lidhen me njërën ose me tjetrën njësi. Për të arritur te rezultati i duhur lipset pasur parasysh larmia e analizës dhe aspektet krahasuese që të çojnë në konkluzione që në të njëjtën kohë janë të ndjeshme ndaj çështjes në diskutim dhe nga ana tjetër provojnë vërtetësinë e saj.

Në rastin e këtij punimi, ku kemi të bëjmë me studime që i përkasin analizës së ndërveprimit shoqëror, të dhënat cilësore do të zënë një vend të rëndësishmëm në analizën dhe përgjigjet për pyetjet kërkimore. Të dhënat cilësore do bëjnë të mundur që punimi të trajtojë shfaqjet dhe rastet që analizohen në mënyrë të natyrshme nga ata njerëz që kanë qenë të pranishëm në mjedisin ku ka ndodhur ngjarja, duke gjetur përgjigjen dhe kuptimet mbi ngjarjet nga vetë aktorët, dhe se si i formësojnë ata interpretimet për to. Duke qenë se aspektet e temës kërkimore fokusohen te ndërveprimet shoqërore, është e domosdoshme të kuptohet qasja që gjeneron kuptimet mbi zhvillimet në fjalë dhe mbi ngjarje të caktuara shoqërore, dhe se si zhvillohen më tej këto bindje te nivelet konkrete të veprimit shoqëror. Kërkimet e bazuara në të dhëna cilësore përqendrohen në një kuadër më të zgjeruar mbi

proceset shoqërore që ndihmojnë formësimin e kuptimeve dhe interpretimeve të ndërveprimit shoqëror, gjë që bën të mundur shpjegimin a asaj që nuk mund të kuptohet kollaj nga një vëzhgim i rastit. (Mathews dhe Ross, 2010, f. 141)

Në procesin e identifikimit dhe analizimit të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë, përdorimi i të dhënave cilësore lidhet me grumbullimin e dokumenteve që kanë të bëjnë me pyetjet e studimit, të cilat mund të jenë në formë të shkruar ose intervista të ndryshme e fjalime. Këto dokumente, në të shumtën e rasteve janë të karakterit strategjik dhe pikë reference në zhvillimin dhe thellimin e politikave të sigurisë së Maqedonisë në përgjithësi.

Disa nga dokumentet kryesore të cilat mbështeten të dhënat cilësore të studimit janë:

- i. dokumente të aprovuara nga qeveria dhe parlamenti i Republikës së Maqedonisë;
- ii. dokumente të Komisionit European, institucionet e ndërlidhura kombëtare dhe rajonale;
- iii. deklarata dhe analiza të këtyre institucioneve dhe krerëve të tyre dhe aktorëve të tjerë relevantë në sistemin ndërkombëtar, si BE, SHBA, NATO dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm globalë, rajonalë dhe lokalë.

Analiza e tekstit në këtë rast paraqitet si një segment i rëndësishëm në identifikimin dhe shtjellimin e paradigmave të sigurisë së Maqedonisë. Kështu, studimi orientohet më tepër te debati i aktorëve kryesorë të përfshirë ose te aktorët që paraqiten si palë e tretë. Kjo do të bëhet në atë mënyrë që dokumentet e analizuara të nxjerrin në syprinë natyrën argumentuese dhe besueshmërinë e tyre. Nga këtu rrjedh se dokumentet e cituara do të

përdoren si për të verifikuar faktet që gjenden në to, ashtu edhe për një analizë të mëtejshme të kontekstit në të cilën janë përpiluar, si dhe implikimet që mund të kenë pasur. (Mathews dhe Ross, 2010, f. 277)

Disa nga dokumentet bazë që do merren në shqyrtim janë: Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e viti 1991, me amendamentet kushtetuese të viteve në vijim; Marrëveshja Kornizë e Ohrit (2001); ligji për punë të brendshme (1995), ligji për Agjencinë e Zbulimit (1995), Strategjia e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë (1998), ligji për mbrojtjen (2001), koncepti kombëtar i sigurisë dhe mbrojtjes (2003), ligji për punë të jashtme (2006), ligji për përgjimin e komunikimeve etj.

Dokumentet në rastin konkret do të shërbejnë si për mbledhjen e të dhënave ashtu edhe për analizën e tyre. Dokumentet do përdoren për të faktuar gjendjen reale, por edhe si objekt analize dhe interpretimi duke shtjelluar kontekstin e formulimit të tyre dhe efektet që kanë sjellë implikimet pas aprovimit. Të dhëna të tilla janë të kombinuara dhe do jenë në funksion të analizës së studimit. Për përdorimin e analizës së tekstit rreth këtyre dokumenteve, do shtrohen këto pyetje:

- i. Cili është burimi i tekstit?
- ii. Cili është roli që ka dokumenti në sigurinë e Maqedonisë?
- iii. Në cilin kontekst është hartuar dokumenti?
- iv. Cilët janë objektivat dhe mesazhet e tekstit?

Por, për të arritur një konkretizim të analizës së teksit dhe këtyre dokumenteve, është i nevojshëm një këndvështrim – në raste të veçanta – me një metodë të kombinuar. Për këtë arsye, pjesë e rëndësishme e grumbullimit të të dhënave janë edhe ato sasiore, për të theksuar dhe radhitur. Kjo ngaqë dokumentet në fjalë, në të shumtën e rasteve nuk e

shpjegojnë shkakun që ka bërë të mundur përpilimin e tyre, por edhe për faktin se në të vërtetë ato krijojnë një realitet shoqëror nga ku grupe të ndryshme shoqërore mbështeten pas tyre. (Mathews dhe Ross, 2010, f. 141)

Të dhënat sasiore do na japin mundësi për të kategorizuar si dokumentet ashtu edhe rezultatet e dala syresh, që në sfond reflektojnë te ndërtimi i ndërveprimit shoqëror. Këto lloje të dhënash mund të na japin përgjigje për pyetjet që karakterizojnë interpretimet mbi dokumentet që nuk shpjegojnë paraqitjet e mëpastajme shoqërore, duke përdorur një kombinim të qasjes statistikore dhe qasjes analitike. Ato janë të rëndësishme për të matur kuptimet shoqërore, duke i identifikuar nëpërmjet të dhënave dytësore, pa pasur mundësi që të analizojnë proceset me të cilat është ndërtuar, negociuar dhe pranuar kuptimi në bazë të ndërveprimit shoqëror. (Mathews dhe Ross, 2010, f. 147)

Një qasje e tillë sasiore do ketë domethënien e një pohimi për mundësitë e rezultatit, duke mëtuar të gjejë njësi matëse pa dhënë një shpjegim të mëtëjshëm. Me analizën e mëtëjshme të këtyre të dhënave studimi do synojë të arrijë një përmbledhje dhe shpjegim për pyetjet dhe hipotezën. Analiza e mëtëjshme do orvatet që të përshkruajë të dhënat e mbledhura, duke përshkruar tiparat e të dhënave, në mënyrë që të mund të zbulojmë lidhjet ndërmjet të dhënave të ndryshme. (Mathews dhe Ross, 2010, f. 345)

Për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore punimi përqendrohet te pyetjet kryesore të cituara në nënkapitullin paraprak, ku studimi fokusohet duke dhënë përgjigje për ballafaqimet në plan të brendshëm dhe të jashtëm, për relacionet mes komuniteteve dhe ndikimi i dokumenteve të ndryshme në perceptimin e sigursisë së Maqedonisë.

Në këtë studim do përdoret edhe metoda e përzier, siç e theksuam më lart, për të pasur mundësi që nëpërmjet mbledhjes së kombinuar të të dhënave të analizojmë paraqitjet

shoqërore nga këndvështrime të ndryshme. Për të arritur këtë qëllim, qasja e kombinuar e të dhënave do të na lejojë të analizojmë dhe identifikojmë si paraqitjet shoqërore ashtu edhe sfidat që shfaqen për masat a aprovuara. Për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore, nganjëherë na nevojitet një pako e kombinuar të dhënash. Përgjigjja për një pyetje kërkimore kërkon të dhëna sasiore dhe (ndonjëherë) cilësore. Kurse për pyetje të tjera kërkimore, mbase janë të nevojshme përgjigjet e kombinuara. (Mathews dhe Ross, 2010, 144)

1.5 Mundësitë dhe kufizimet e studimit

Në paraqitje të reduktura si ato më lart mund të vihet re se studimi synon të vendosë në funksion elemente empirike dhe analitike, në shumë raste ndërthurur edhe me metodologji krahasimore, për të ndërtuar një kuadër sa më të plotë dhe shkencor të interpretimit të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë, si nga pikëpamja e stabilitetit të brendshëm ashtu edhe nga ana e gjeopolitikës rajonale.

Studimi i një problematike të tillë shoqërohet me mundësi dhe me kufizime të ndryshme. Kur flasim për mundësi i referohemi faktit se siguria në Maqedoni është një fushë dinamika e së cilës paraqet objekt studimi më tepër në prizmin e ngjarjeve të një kohe të caktuar sesa një vlerësim për shkakësinë dhe dinamikën e ndërveprimit shoqëror, si dhe sukseset dhe dështimet teorike dhe politike të analizës dhe përballjes me këto raste. Studimi synon të kalojë mbi një trajektore që ngërthen një analizë të zgjeruar në kontekstin kohor, por edhe të veprimeve që tejkalojnë kornizën tradicionale të analizës së sigurisë, duke spikatur elemente shtesë të analizës mbi sigurinë.

Në bazë të kërkimeve të deritanishme rezulton se punimet shkencore mbi sigurinë në Maqedoni janë të kufizuara kryesisht në aspektet përshkruese, duke lënë mënjanë

implikimet e shumta të gjendjes së sigurisë, që varrojnë duke filluar nga implikimet gjeopolitike deri tek ato ekonomike, sociale dhe rajonale. Për më tepër, duke qenë se siguria në Maqedoni merret kryesisht me parandalimin e përplasjeve të brendshme dhe strukturimin e shtetit në politikën e jashtme, atëherë kërkimi shkencor mbi këtë problematikë do të jetë me interes qoftë për studime të mëtejshme kërkimore, qoftë për politikëbërësit në Maqedoni, ngaqë studimi është konceptuar si multidisiplinar.

Në rastin konkret, mundësitë e studimit të kësaj problematike mund të jenë edhe kufizuese. Duke qenë se problematika e sigurisë së Maqedonisë është një temë që përshkruhet akoma si kërkuese e stabilitetit, ajo përfshin një dinamikë fluide që është e bazuar në përcaktimet prioritare të politikës ditore. Kjo e vështirëson edhe më shumë punën kërkimore, duke qenë se është një proces ku studimi i dinamikave dhe i impakteve mund të hasë kufizime.

Çështjet e sigurisë së Maqedonisë si objekt kërkimor kanë një rëndësi të veçantë dhe zënë një vend të rëndësishëm në axhendën e politikëbërësve të këtij vendi dhe më gjerë. Duke qenë se çështjet e sigurisë formësojnë politikën e parandalimit të përplasjeve të mundshme në axhendën e brendshme, ato reflektojnë edhe te përpilimi apo axhenda e politikës së jashtme. Që këtë paraqitet nevoja e një studimi mbi këtë problematikë, me qëllim identifikimin dhe analizimin e sigurisë, si në plan të brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm, dhe cilat mund të jenë implikimet në segmentet e lartëpërmendura.

Por, duke marrë në konsideratë ndërvarësinë e aktorëve brenda këtij konteksti, studimi i paradigmave të sigurisë së Maqedonisë si një aktor i vetëm nuk mund të jetë i plotë pa një analizë të situatës rajonale, apo për më shumë edhe europiane. Rjedhimisht, rëndësia e studimit është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me rëndësinë e projekteve të

integritet të Maqedonisë në strukturat euroatlantike, dhe kështu shtrohet dilema se çfarë, si dhe kur do të ishte e arsyeshme për politikëbërësit e Maqedonisë ta aprovojnë dhe miratojnë këtë platformë.

Aspektet e lartëpërmendura paraqiten si një mundësi përfitimi në drejtim të stabilitetit të jashtëm, por, në të njëjtën kohë, hapet dilema e rrugës përmes së cilës duhet arritur një objektiv i tillë në reformat që kërkohen në aspektin e brendshëm. Në këtë kontekst nevojitet të përcaktohen orientimet e politikës së sigurisë për sa i takon qëllimit të ecurisë së shtetit në aspektin rajonal, por edhe në arritjen e objektivit tjetër, që në rastin e Maqedonisë është stabiliteti i brendshëm.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave shoqërohet me disa kufizime, që kryesisht janë kufizime metodologjike. Këto kufizime kanë të bëjnë me sasinë e të dhënave në dispozicion, bazën dhe burimin e tyre, vështirësitë në përzgjedhjen e deklaratave apo dokumenteve të përshtatshme, ndikimin e variablave të jashtëm në situatën e sigurisë së Maqedonisë dhe larminë e dinamikave të brendshme në çdo nivel të analizës, që ndikojnë në përcaktimin e paradigmave të sigurisë së Maqedonisë në tërësi.

1.6. Struktura e studimit

Studimi është i ndërtuar në gjashtë kapituj, duke nisur nga paraqitja dhe plani studimor deri te kapitulli i fundit që pasqyron përfundimet e kapitujve pararendës. Këta kapituj janë pjesë e një hipoteze të vetme të lidhur me temën e studimit “Paradigmat e sigurisë së Maqedonisë: sfida dhe mundësi”. Një lidhje fragmentare e brendshme, e bazuar në fakte, vërehet në të gjithë kapitujt. Kapitujt e analizuar janë konceptuar në nivele të

ndryshëm dhe paraqiten në kuadër rajonal, deri tek ai shoqëror, duke analizuar të dhënat dhe paraqitjet në çdo kapitull, bazuar në tre nivelet e analizës mbi të cilët mbështetemi.

Hyrja e studimit, që është edhe kapitulli i parë, përbëhet nga prezantimi i studimit në përgjithësi, duke spikatur natyrën e problemit të shtruar bashkë me hipotezat bazë, si dhe duke ngritur ato pyetje të cilave synojmë t'u japim përgjigje. Po ashtu, trajtohen edhe përcaktimet themelore dhe synimi që mëton të arrijë studimi, duke prezantuar metodologjinë tek e cila do mbështetet, kufizimet dhe risitë që priten.

Kapitulli i dytë merret me kuptimin e sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe me evoluimin e koncepteve bazë të saj gjatë periudhave të ndryshme historike. Këtu veçohen disa nga zhvillimet dhe kuptimet bazë mbi sigurinë ndërkombëtare dhe qasjet e ndryshme të analizës së saj. Zhvillimi i konceptit të sigurisë në këtë drejtim jep edhe një mundësi për një shtjellim të tërthortë mbi kuptimin tradicional të sigurisë dhe çfarë paraqet ai për aktorët kryesorë. Kështu, një vështrim i shkurtër rreth shkollave tradicionale, që ndahen në realiste dhe liberale, prezantohet me qëndrimet e tyre bazë, kryesisht mbi shtetin dhe për shtetin.

Kapitulli i tretë hap një diskurs të plotësuar mbi sigurinë, si rrjedhojë e ndryshimeve gjeopolitike dhe ndryshimeve të mëdha që ndodhën kryesisht pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Qëndrimet klasike mbi sigurinë janë të pamjaftueshme për përgjigjet që synon studimi, dhe në këtë drejtim kemi edhe aspektet mbi zgjerimin dhe thellimin e analizës së sigurisë në kushte të ndryshueshme. Ky evoluim ofroi mundësinë dhe kontekstin e përshtatshëm për një diskurs ndryshe mbi sigurinë, duke analizuar segmente shtesë. Kapitulli shqyrton në detaje edhe qasjet konstruktiviste, në veçanti ato të Shkollës së

Kopenhagenit, duke paraqitur doktrinat kryesore, literaturën dhe konceptet bazë nën një këndvështrim analitik.

Duke qenë se konceptet e sigurisë ndryshojnë në nivelin e analizës dhe fushat që duhen analizuar, kapitulli i ofron qasjet e shkollës konstruktiviste me një theks te qëndrimet bazë të saj, që përbëjnë një shkëputje nga qasjet tradicionale, duke veçuar ndërveprimin si burim sigurie.

Shkolla e Kopenhagenit, që është një ndërthurje e këtyre koncepteve, merr më shumë vëmendje, duke shtjelluar nocionet bazë të zgjerimit dhe thellimit të analizës së sigurisë.

Ky këndvështrim prezanton aspektin e thelluar dhe të zgjeruar në platformën e tij teorike, si dhe fushën e ndërveprimit. Konceptet teorike në vazhdim do të shërbyjnë si një kornizë bazë ku gjen mbështetje studimi. Kapitulli përfundon me një prezantim përmbledhës për këto qasje.

Kapitulli i katërt ndalet te niveli i analizës së shtetit nga një këndvështrim tradicional, duke veçuar aspektet më të rëndësishme të shtetndërtimit në Maqedoni. Analiza e kapitullit fokusohet te rrethanat gjeopolitike, duke iu nënshtruar një qasjeje tradicionale të kontekstit të sigurisë në Maqedoni. Kështu na shfaqet pasqyra e zhvillimeve historike të shtetformimit në Maqedoni, për të analizuar diskursin e mëvonshëm politik, por edhe se si u shndërruan në sfida këto zhvillime për vetë sigurinë e shtetit.

Zgjedhjet vendimmarrëse që rrodhën gjatë kësaj periudhe janë reflektim i ndërtimit të shprehisë fizike dhe institucionale të shtetit, si dhe i pasojave që mund të sjellin. Kjo është e rëndësishme për të arritur në konkluzione mbi legjitimitetin dhe dëndësinë e kësaj pranie në të gjitha fushat e jetës, dhe se si mund të perceptohen ato në përgjithësi. Për më

tepër, në këtë kapitull identifikohen edhe pikënisjet e një sërë çështjesh të rëndësishme për sigurinë e Maqedonisë në vijimësi.

Kapitulli i pestë fokusohet te siguria në Ballkan, ku fillimisht kemi situatën në rajon, nëpërmjet përdorimit të një qasjeje analitike. Më pas fokusi kalon tek identifikimi i aktorëve që ndikojnë në këtë situatë, sikurse edhe niveli i bashkëpunimit midis faktorëve të këtij rajoni dhe perceptimet e ndryshme që kanë për njëri-tjetrin aktorët fqinj të Maqedonisë. Duke qenë se në këtë fazë studimi merret me sfidat dhe mundësitë rajonale, detyrimisht që marrëdhëniet me BE-në si një organizatë rajonale dhe aktor i rëndësishëm, edhe segmente kyçe të analizës fokusohen te marrëdhëniet me të. Kapitulli shqyrton edhe sfidat dhe mundësitë që paraqiten për Maqedoninë në një kontekst të ndryshueshëm rajonal të sigurisë, si në politikat e jashtme ashtu edhe në ato të brendshme.

Kapitulli i gjashtë shpalos një dinamikë ndërveprimi dhe disa çështje të një rëndësie të veçantë në aspektin e brendshëm të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë. Një dinamikë e tillë zhvillimore shpie drejt një analize të zgjeruar në atë hapësirë ku ndodhin ngjarjet, dhe se si ndërthuren ato në proces me rezultate që në raste të veçanta dalin nga një diskurs politik që lidhet me stabilitetin dhe sigurinë e shtetit. Në këtë kontekst vjen edhe analiza në nivel të sigurisë shoqërore, për të parë dhe reflektuar mbi ato zhvillime që detyrojnë një komunitet të ketë perceptime të ndryshme për sigurinë. Nga veçoritë e zgjerimit të fushave të sigurisë vihet re se siguria për një komunitet, në raste konkrete mund të jetë një veprim ndryshe nga ai që sipas shtetit shënon mbrojtjen e brendshme të sigurisë.

Kapitulli i shtatë dhe i fundit merret me konkluzionet dhe rekomandimet përfundimtare si rrjedhoja logjike të kapitujve pararendës, në funksion të dhënies së një përgjigjeje për pyetjet kryesore dhe mbrojtjen e hipotezave fillestare.

KAPITULLI II: KONCEPTI TRADICIONAL I SIGURISË: NJË QASJE NDAJ SHTETIT DHE FORCËS

2.1 Evoluimi i nocionit të sigurisë

Në këtë kapitull, duke pasqysruar konceptin bazë të sigurisë, fillimisht do sjellim pikëpamjet kryesore mbi atë se çfarë nënkuptohet me nocionin siguri. Duke marrë në konsideratë këtë, do vijojmë më tej me një aspekt më të gjerë të sigurisë, duke u fokusuar te koncepti tradicional, si reflektim mbi sfidat me të cilat përballet shteti si objekti kryesor referues i një qasjeje tradicionale.

Në kuptimin klasik, që shpeshherë i atribuohet Weber-it, siguria përcaktohet si një monopol i domosdoshëm i përdorimit të forcës brenda dhe jashtë kufirit të një territori të caktuar. Kështu, për rrjedhojë, siguria e shteteve mund të sfidohet nga një ndryshim që mund të kërcënojë monopolin e përdorimit të masave të dhunshme, qoftë përmes pushtimit të jashtëm, qoftë nga rebelimi i brendshëm. Këtu kemi edhe një qasje për kuptimin e sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, si në rastin e sistemit uestfalian të shteteve të forta, ku sistemi ndërkombëtar ka rënë pre e konflikteve dhe përdorimit të forcës në një rreth anarkik dhe në një garë të përhershme.

Në shekullin e njëzetë, koncepti i sigurisë filloi të përdorej në qarqet akademike dhe në sistemet e sapokrijuara ndërkombëtare, bazuar te qëllimi i tij si një çështje me rëndësi për politikën ndërmjet shteteve, duke u inkorporuar fillimisht në Konventën e Ligës së Kombeve në vitin 1919, dhe më pas në Kartën e Kombeve të Bashkuara në vitin 1945. Në

artikullin 1.1. të Kombeve të Bashkuara, qëllimi i referencës së tij përshkruhet si vijon: “...për ruajtjen e paqës dhe sigurisë ndërkombëtare (...) dhe për parandalimin dhe shmangien e rreziqeve që kërcënojnë paqen.” Ndonëse citimi i lartëpërmendur shërben për të referuar rreth qëllimit të rendit ndërkombëtar të sigurisë, ai tregon edhe rëndësinë që ka siguria për shtetet anëtare në këto organizata. Qëllimi i tij në këtë kontekst lidhet ngushtë me një qasje tradicionale, si para dhe pas formimit të këtyre organizatave, dhe ka të bëjë me luftën dhe paqen midis shteteve.

Duke qenë se që prej viti 1945 objekti kryesor të cilit i referohet siguria ka qenë shteti, megjithatë, shumë nga kërcënimet e mëdha për sigurinë e tij kanë evoluuar duke ndryshuar edhe fokusin se çfarë përbën siguri për shtetin. Ekskluziviteti i përdorimit të forcës nga ana e shtetit, qoftë brenda e qoftë jashtë kufijve, filloi të ndryshonte pas Luftës së Dytë Botërore, duke i dhënë një kuptim më të gjerë e të ndryshueshëm nocionit se ç’është siguria dhe si duhet kuptuar.

Fjala “siguri” rrjedh nga latinshtja – *securitas*. Nga fjalorët dhe enciklopeditë e shumta përcaktohet si “liri nga rreziku dhe frika”. Në fjalorin e marrëdhënieve ndërkombëtare, botuar nga “Penguin”, hasim këtë përkufizim: “Mungesa e kërcënimeve ndaj vlerave të pakta.” (Evans & Newnham, 1998) Vëmë re se siguria, nën një qasje të tillë nuk nënkupton vetëm gjendjen materiale të forcës, por edhe vlerat që duhen siguruar.

Stephen Walt, një studiues i spikatur për çështjet e sigurisë, e përkufizon atë të lidhur ngushtë me aspektin ushtrak dhe me mjetet që e bëjnë të mundur: “...kërcënimet, përdorimi dhe kontrolli i forcës ushtarake.” (Walt, 1991, f. 2) Kjo shkakton një ndarje të

thellë mbi kuptimin e ngushtë të sigurisë dhe përkufizimit të qartë të saj, duke e vlerësuar atë në një kontekst tradicional, që ka të bëjë me mjetet dhe mënyrat për ta arritur.

Një qëndrim tjetër ka studiuesi Arnold Wolfers, sipas të cilit siguria mbulon jo vetëm një gamë mjetesh, por edhe qëllimesh, deri në atë shkallë sa politika të rrafsheve të ndryshme kombëtare të konsiderohen si politika të sigurisë, duke iu referuar asaj si një kuptim divergjent veprimesh, që përveç forcës ushtarake nënkuptojnë edhe një seri politikash të tjera që plotësojnë kërkesat e kombit, duke e planifikuar atë si një objektiv të politikës kombëtare. Ai e përkufizon sigurinë “si një vlerë nga e cila një komb mund të aspirojë dhe të përfitojë më shumë ose më pak.” (Wolfers, 1952, f. 484)

Nga kjo vihet re se koncepti për sigurinë nënkupton gjëra të ndryshme në varësi të qëndrimeve të veçanta të analistit apo edhe vetë aktorit që trajton termin siguri. Një qasje e tillë ka hapur mundësinë e një diskursi të larmishëm mbi konceptin e sigurisë, duke hapur dilemat dhe interpretime të ndryshme mbi natyrën, nivelin dhe fushat që ajo përfshin. Ky diskurs ndaj qasjeve për sigurinë u zhvillua në veçanti në peridhat pas përplasjeve të mëdha botërore dhe zhvillimit të vrullshëm të mjeteve të forcës në dispozicion të aktorëve shtetërorë.

Në sajë të këtyre ndryshimeve kemi dhe shpërndarjen e fokusit të studimit të sigurisë në drejtime që mundësuan zgjerimin e trajtimit të çështjeve që lidhen me një koncept të zgjeruar dhe të thelluar të sigurisë. Në rrafshin *horizontal* kemi një sërë çështjesh që filluan të konsiderohen si tema që kanë të bëjnë me sigurinë e shtetit, duke futur në kornizën e analizës fusha shtesë që përbënin kërcënim për shtetin. Përfshirja e këtyre fushave ka të bëjë me debatin e lartëpërmendur, ku trajtohet çështja se çfarë përbën siguri

dhe cilat janë vlerat që duhen siguruar nga kërcënime të tilla, si dhe cilat janë masat që duhen ndërmarrë për sigurimin e tyre.

Në të njëjtën kohë, një ripërkufizim i tillë u shfaq edhe në linjë *vertikale*, duke përcaktuar objekte referuese për të cilët siguria ishte po aq e rëndësishme në trajtim të rreziqeve që shfaqeshin tashmë jo vetëm për shtetin, por edhe për aktorë të tjerë në teatrin global, bazuar në nivelin e shtrirjes së veprimtarisë së tyre. Niveli i analizës ka të bëjë me objektin referues të sigurisë dhe lokacionin ku shtrihet veprimtaria e tij, dhe siç do të shohim në vijim, ai mund të jetë sistemi, shteti apo individ, në varësi të qasjes teorike që përdoret.

Një zhvillim i tillë i debatit, se çfarë përbën siguri, detyrimisht hapi edhe mundësinë e një konceptualizimi më të përqendruar jo vetëm se çfarë nënkupton siguria, por duke u përgjigjur edhe për disa pyetje të ngritura, të cilat do përafronin kutipimin mbi të. Studiuesi David Baldwin ngriti një sërë pyetjesh që do kontribuonin ndjeshëm në përafrimin e një koncepti të njehsuar mbi sigurinë, duke specifikuar ato elemente të përbashkëta që mund të çonin drejt një qëndrimi dhe pyetëtori gjatë përkufizimit të konceptit të sigurisë. Kështu, nga një koncept i gjerë dhe i debatueshëm mbi sigurinë, drejt pyetjesh si kush duhet siguruar? Cilat vlera duhen siguruar? Po për sa i takon kërcënimeve, cilat duhen veçuar? Ç'mjete duhen përdorur? Çfarë kostoje dhe kohe duhet shpenzuar për evitimin e kërcënimeve? Në këtë mënyrë, të tilla çështja mund të na shpiejnë drejt një kuptimi dhe një analize më të përqendruar mbi konceptin e sigurisë. (Baldwin, 1997, f. 17)

Siç e shohim, kemi të bëjmë me trajtime të ndryshme për konceptin e sigurisë, duke spikatur ndasi të ndryshme të studiuesve. Përgjithësisht, qasjet tradicionale kanë të bëjnë

me përqendrimin e studimeve mbi paqen dhe fuqinë, ku si aktor kryesor shfaqet shteti, në një ambient ndërkombëtar anarkik. Deri në përfundim të Luftës së Ftohtë, këto dy qasje ishin të përfaqësuara nga studimet realiste, që janë të bazuara te fuqia. Nga ana tjetër, paqja paraqitet si një koncept liberal dhe idealist. Kështu që, për një kuptim më të qartë të këtyre dy shkollave, në faqet në vazhdim do merremi shkurtimisht pikërisht me doktrinat bazë të tyre.

2.2 Shkollat tradicionale mbi sigurinë

Përgjithësisht, qasja tradicionale në analizën e sigurisë është e bazuar te perceptimi për atë siguri që është krijuar në bazë të kuptimit mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, e dominuar nga lidhjet dhe qasjet që fokusohen te faktori shtet. Në këtë kontekst, në kornizat e perceptimit dominojnë edhe aspektet e zgjidhjes ushtarake të problemeve të sigurisë. Për një pamësi më të drejtpërdrejtë se çfarë nënkuptohet me studimet mbi sigurinë, lind nevoja e analizës se ç'është ajo lloj sigurie që nga perspektiva studiuesve të shkollave tradicionaliste paraqitet si një koncept që merret me studimin e rreziqeve, përdorimin dhe kontrollimin e forcës ushtarake. (Cavelty dhe Mauer, 2010)

Objekti referues i sigurisë, sipas studimeve tradicionale, lidhet me sigurimin e shtetit, që në fakt paraqet objektin qendror nëpërmjet të cilit nënkuptohen dinamikat e fushës së sigurimit territorial në botëkuptimin e universit të shteteve. Në këtë kuptim, mbrojtja e territorit të shtetit përbëhet nga asgjësimi i rreziqeve me mjete ushtarake në një ambient konkurrues shtetesh ku mbrojtja e sigurisë kombëtare ka të bëjë me mbijetesën e

shtetit nëpërmjet përcaktimit të kërcënimeve, të arsyeve për kërcënimet dhe të mënyrës për uljen e kërcënimeve.

Sipas qasjes tradicionale, siguria e shtetit ka katër elemente bazë ku orientohen politikat shtetërore të sigurisë në identifikimin dhe asgjësimin e rreziqeve. Këto segmente lidhen kryesisht me kushtet që kanë të bëjnë me sigurinë fizike, autonominë, zhvillimin dhe rendin e shtetit. Si i tillë, shteti aprovon dhe implementon masa ushtarake ndaj kërcënimeve nga jashtë dhe brenda. (Collins a.d., 28)

Në kuptimin tradicional të sigurisë dominon perceptimi se:

- Shtetet janë aktori kryesorë i sistemit ndërkombëtarë;
- Në plotësim të interesave të tyre ata krijojnë një garë të përhershme anarkiste.
- fuqia/ushtria është është një instrument i domosdoshëm në plotësimin e interesave të shtetit.
- përplasjet mund të pengohen duke krijuar një sistem ekuilibri të fuqisë mes shteteve. (Waltz, 1979, f. 106)

Pavarësisht shfaqjes së paraqitur të studimeve mbi sigurinë tradicionale, vlen të kujtojmë se ngjarjet e rëndësishme pas Luftës së Dytë kishin një qasje disi të zgjeruar, dhe kishin si referues sigurië probleme shtesë, që si të tilla kanë një ndikim nismues mbi zhvendosjen e debatit për pranimin e mësimin tradicional për sigurim më të zgjeruar, përkundër faktit se edhe në këtë drejtim i kushtohet më tepër rëndësi pozicionimit qendror në shtet në kontekstin e sigurisë kombëtare. Por, ajo që duhet veçuar është se si rezultat i kësaj shfaqet ideja alternative për mbrojtje, sipas së cilës marrëdhëniet ndërkombëtare të

bazuara te fuqitë ushtarake paraqesin vetëm një pjesë të problemit dhe burimit kryesor të paqëndrueshmërisë, dhe për shkak të kësaj situate është i patjetërsueshëm perceptimi për sigurinë dhe paqen – situata të cilat paraqesin një zhvendosje të lehtë në parime të së drejtës sociale dhe marrëdhënieve mes njëri-tjetrit. (Cavelty dhe Mauer, 2010 11)

Mbi bazën e prezantimit tradicional, se siguria është ajo çfarë nënkupton siguria ushtarake, një perceptim disi më i zgjeruar për sigurimin ushtarak në mungesë lufte është ndarja dhe në të njëjtën kohë lidhja mes sigurisë dhe politikës, që në njëfarë mënyrë paraqitet me një fushë më të gjerë, por përsëri jo mjaftueshëm për qëllimin e studimit. Në këtë drejtim, edhe pse identifikojnë parametra shtesë të sigurisë jashtë asaj ushtarake, përsëri trajtimi i këtyre parametrave për qëllime ushtarake e ka mbyllur debatin në kufijtë shteto-centrikë të analizës së sigurisë. Shafaqja e këtyre mendimeve sugjeron që një zgjerim i konceptit të sigurisë të trajtohet më tepër në drejtim të studimeve strategjike, ku si pikë reference do të jetë përsëri shteti dhe lufta, si dhe kompeticioni ndërshtetëror (Cavelty dhe Mauer, 2010, f. 3)

Nisur nga kjo, për shkollat tradicionale siguria përbën një vëzhgim të ambientit të sigurisë mbi shtetin dhe për shtetin. Shteti trajton çështje të sigurisë që kanë të bëjnë me kanosjet nga jashtë, por edhe ato nga brenda, duke formuluar politika për t'i asgjësuar këto kërcënime nëpërmjet fuqisë. Siguria shtetërore në këtë pikëpamje, në të shumtën e rasteve është e lidhur edhe me sistemin politik të shtetit: demokratik apo totalitar, që më pas të përcaktojë se si do të formulohen kërcënimet. Këto kërcënime, bazuar në sistemin ekzistues shtetëror, drejtojnë politikat e shtetit si në sistemin ndërkombëtar për aleancat që ai zgjedh, ashtu edhe në atë të brendshëm, duke përcaktuar perceptimin mbi mirëqenien. (Collins a.d., 29)

Për nevojat e këtij studimi kjo shfaqet e rëndësishme në trajtimin e lidhjeve që zgjedh të shqyrtojë shteti si aspekte të sigurisë në plan të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe cilat janë perceptimet që përcaktojnë formulimin e politikave shtetërore nga një kënvështrim i sigurisë bazuar te teroitë tradicionale. Kjo vlen më tepër për të trajtuar dilemat që shfaqen në drejtim të formulimit të politikave kombëtare.

2.2.1 Një vështrim mbi qasjen realiste dhe idealiste

Qasja e mësimin realist mbi sigurinë veçohet me tre supozime bazë ku përqendrohet analiza realiste mbi funksionimin e sistemeve. Ajo bazohet në tri premisa kryesore se bota funksionon në saxe të ekzistencës së a) grupeve, b) egoizmit të grupeve dhe c) fuqisë. Grupimi si i tillë është njësi sociale dhe politike dhe në një gjendje të tillë paraqet aspirata bazuar në interesin e tyre. Ky interes i grupimit mund të jetë egocentrik dhe në varësi të kohës dhe nevojës mund të sjellë përplasje dhe konflikte me aspiratat dhe interesin e një grupi tjetër. Për të shprehur aspiratat dhe plotësuar interesin në një gjendje konfliktuoze krijohet një situatë anarkike, ku raporti i fuqisë paraqitet si thelbësor në arritjen apo humbjen e aspiratës dhe interesit të grupimit (Gilpin, 1996, 7-8).

Ndonëse si një qasje e studimit të mardhënieve mes kombeve është shumë e hershme me rrënjë që në antikuitetin e lashtë, paraqitet bashkëkohore të mësimin realist e kanë zanafillën me veprën e Eduard Karrit (Edward Carr) Kritika Njëzetvjeçare e botuar në vitin 1939. Një mori veprash të studiuesve tjerë siç janë Frederik Shumani, Harold Nikolson, Martin Uajt dhe të tjerë i dhanë një kornizë të mjaftueshme realizmit dhe ideve të saja për forcën, frikën dhe anarkinë duke dhënë shpjegime të rëndësishme mbi përplasjet dhe luftën.

Kulminacionin e qëndrimeve të saja ky mësim e ka me paraqitjen e veprës së Hans Morgenthaut pas luftës së dytë botërore, e që tezat e tij në këtë fushë i ka prezantuar në librin Politika mes kombeve (1948). Sipas Morgenthau-t dhe sipas përfaqësuesve të tjerë të realizmit klasik, arsyeja kryesore për ndeshjet dhe luftërat rrjedh nga vetë natyra e njeriut dhe relatat që grupet ndërtojnë në një gjendje të organizuar në drejtim të akumulimit të mirave materiale. Dëshirat e njeriut dhe grupit dhe nevojat e tyre që shfaqen rishtazi hapin shtigje të një egoizmi ndaj grupeve tjera të organizuara dhe fuqisë që ata posedojnë. Aspiratat e tilla hapin garën në kërkim të përhershëm të akumulimit të fuqisë në një ambient shtetesh dhe grupesh, ku në mungesë të një autoriteti të përhershëm për të vendosur rregulla krijohet një gjendje anarkike (Cavelty & Mauer, 2010, f. 10).

Sipas realistëve grupimet kryesorë në mardhëniet ndërkombëtare janë shtetet dhe në veprimet e tyre ata janë aktorë racional në përmbushjen e interesave shtetërore. Si e tillë politika ndërkombëtare matet nëpërmjet prizmës së interesit shtetëror dhe nevojave që ajo ka për të krijuar kushte të mbijetesës. Në kushte kur shtetet mundë të kenë sjellje të ndryshme kah sigurimi i interesave të tyre kjo shpie në drejtim të nxjerrjes së nevojës së akumulimit sa më të madh të fuqisë për tu mbrojtur nga aspirata dhe kushtëzimet që mundë të paraqiten rishtazi nga aktorët e tjerë në skenën ndërkombëtare. Duke qenë se interesi kombëtar mbrohet vetëm me forcë, atëherë ajo medoemos duhet të akumulohet mjaftueshëm që ta mbrojë këtë interes në kushtet e një mjedisi anarkik ndërkombëtar. Në këtë kontekst, Morgenthau thekson se një garë e të tillë në politikën ndërkombëtare i jep prioritet forcës dhe si e tillë politika ndërkombëtare është e kushtëzuar nga domosdoshmëria e akumulimit të forcës që e bën atë një tipar bazë të politikës ndërkombëtare. (Morgenthau, 1978, 4)

Pikërisht kjo përmbajtje përbën thelbin e dilemës fuqi-siguri, nëpërmjet së cilës është shprehur mendimi kyç për problematikën në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në varësi të këmbënguljes për të shtuar siguri për veten, shtetet i dëmtojnë shumë lehtë aspiratat për siguri të shteteve të tjera. Kështu, mund të theksojmë se dilema fuqi-siguri vjen nga frika e mposhtjes, e stimuluar nga shfrytëzimi i mundshëm i mjeteve luftarake që zotërojnë subjektet e tjera (Cavelty dhe Mauer, 2010, f. 16).

Krahasuar me dilemën tradicionale të mëparshme të sigurisë, është i pakontestueshëm fakti se koncepti për dilemën fuqi-siguri mundëson një qëndrim dhe një analizë më të lartë konceptuese për përmbajtjet kontradiktore të konceptit të sigurisë. Respektivisht sipas këtij koncepti, kuptimi i marrëdhënieve ndërkombëtare për sigurinë kombëtare të shteteve duhet të forcohet pikërisht nëpërmjet ndarjes së konceptit siguri nga koncepti fuqi. Koncepti teorik i shfaqur për dilemën fuqi-siguri ofron një kornizë shumë – më të mirë – për analizën e qasjes së BE-së ndaj shteteve në këtë drejtim, me mundësinë që shtetet të krijojnë qëndrime më transparente për kuptimin e interesit kombëtar, në mënyrë që kjo të krijojë mundësi bashkpunimi në sistemin anarkik ndërkombëtar. (Jervis, 1978, f. 9).

Përndryshe, qasja klasike realiste ndalet tek ndërveprimet e shteteve për të garantuar sigurinë nga një optikë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ndryshime të rëndësishme të qëndrimeve të realistëve për të garantuar sigurinë nëpërmjet optikës së marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe që këtej nëpërmjet aktorit referues të shtetit, paraqet studiuesi Kenneth Waltz. Në veprën e tij Teoria e politikës ndërkombëtare, ai si pjesë qëndrore të shpjegimit të marrëdhënieve ndërkombëtareset nga qasja e shkencave politike duke e theksuar edhe nivelin sistematik të shteteve dhe duke zgjeruar njësitë e analizës deri

tek vet shteti sepse edhe vet politika që shfaqet si e tillë në fakt është një proces i cili ndodh në luftën për pushtet dhe fuqi. Si e till ky proces politik shfaqet edhe në një ambient anarkik dhe garues mes shteteve për akumulim të forcës të cilat në arritjen e objektivit të till zakonisht edhe përplasen mes tyre dhe përbën pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së politikës ndërkombëtare. (Waltz, 1979, 23)

Në këtë kontekst Waltzi për herë të parë paraqet një kornizë teorike në procesin e analizës së mardhënieve ndërshtetërore duke i dhënë një rëndësi të veçantë nivelit analitik. Lokacioni në të cilën duhet analizuar mardhëniet e shteteve gjendet në tre nivele të mundshme analize dhe atë: njeriu, shteti dhe niveli sistematik i shteteve. Një qasje e tillë has në një zgjerim fillestarë duke trajtuar mardhëniet e shteteve në mënyrë që edhe reflekton mbi formën organizative të vet shteteve dhe qasjes që ato kanë me shtetet e tjera. Një qasje e këtillë analitike jep mundësin e gjetjes së arsyeve të sjelljes së shteteve nga tre burime dhe lokacione të ndryshme. (Waltz, 1979, 13)

Sipas Waltz-it, politika ndërkombëtare paraqet një sistem të përbërë nga dy nivele, të cilat janë ndërveprime: niveli strukturor dhe niveli i sistemeve fillestare. Duke u bazuar në këtë nivelet janë të rëndësishme për mënyrën se si ata artikulojnë politikën e qasjes ndaj shteteve tjera nga këndvështrimi i organizimit të njësive dhe mënyra se si ata sillen në relacion me shtetet e tjera. Por fakti që ajo rezulton si interes i politikës së jashtme nuk mjafton në gjetjen e përgjigjeve të duhura mbi atë se si shfaqen politikat e jashtme dhe çfarë implikimesh mundë të bartin ato. Përbërja strukturore dhe mundë të jap shpjegime mbi atë se çfar do të jenë përgjigjet e sistemit mbi problemet e caktuara duke ndërlidhur nivelet në gjetjen e shpjegimeve të sjelljes së shteteve. (Waltz, 1979, 73)

Nga kjo që thamë mund të përfundojmë se mësimet realiste ndjekin një paradigmë të tërthortë të sigurisë, ku objekti shtet paraqitet si një element kryesor në analizën e sigurisë. Për të ruajtur sigurinë shteti projektton aktivitete që kryesisht janë të orientuara në aspektin ushtarak të rritjes së fuqisë, e gjithë kjo duke pasur si qëllim sigurinë e shtetit në relacion me shtetet e tjera. Por, shteti si i tillë, i përcaktuar me mësimet realiste si një entitet territorial, aplikon të njëjtën qasje edhe në politikat e sigurisë së brendshme në kuadër të territorit mbi të cilin ushtron autoritet. Edhe në rastet kur përmbushja e aspektit të sigurisë bëhet më komplekse dhe kërkon një politikë të ulët, siç u përmend më lart, përsëri të tilla aplikime janë në shërbim të maksimalizimit të potencialit ushtarak në arritje të qëllimit, që është shtrirja e autoritetit absolut mbi territorin.

Ndryshe nga qasja e studimeve të sigurisë së realistëve, shpjegimet e të cilëve për sa i përket formës së sigurisë bazohen te çështjet e fuqisë, teoricienët liberalë i drejtojnë këto çështje në shumë drejtime, duke i kushtuar një kujdes normave dhe institucioneve përkatëse ndërkombëtare. Duhet theksuar se edhe për përfaqësuesit e teorisë liberale, çështja për rëndësinë e fuqisë nuk mund të evitohet plotësisht për shpjegimin e marrëdhënieve të sigurisë. Megjithatë, ndryshe nga realistët, që e përfaqësojnë plotësisht këtë temë, teoricienët liberalë e zgjerojnë diafragmën duke u përqendruar te natyra e njeriut nën një tjetër pasqyrim, ku kujdesi institucional – para së gjithash – fokusohet te të drejtat individuale, gjë që shpie drejt një raporti më paqësor mes shteteve. (Cavelty dhe Mauer, 2010, 21)

Si drejtim teorik, në përgjithësi liberalizmi ngulmon të shpjegojë kushtet në të cilat zhvillohen dhe realizohen liritë politike dhe parimet liberale drejtuese, si në kuadër të shteteve ashtu edhe për sa i takon marrëdhënieve të tyre të ndërsjella. Në këtë drejtim,

ambienti i duhur demokratik dhe liritë individuale krijojnë mundësi shkëmbimesh të ndërsjella, si në nivel individual ashtu edhe në atë shtetëror, duke krijuar një ndërvarësi ekonomike e cila sjell parakushtet për një qasje paqësore reciproke mes shteteve. Rrgullimi i sitemit shtetëror bazuar mbi premisat demokratike prodhon politika ndërvarësie që evitojnë përplasjet, duke mundësuar kështu një klimë bashkëpunimi. (Cavelty dhe Mauer, 2010, f. 27)

Kështu, teoricienët liberalë, për një ide të tillë nisen nga dilema e sigurisë së Herzit, ku interesi i shteteve prodhon kundërmasa nga shtetet e tjera, dhe si rrjedhojë ato inkuadrohen në një garë të përhershme. Interesat e përbashkët të shteteve nismojnë një zhvillim të patjetërsueshëm bashkëpunimi konstruktiv, që i përjashton karakteristikat e mundshme të dilemës forcë-siguri. Pikërisht si aktorë racionalë, shtetet i perceptojnë karakteristikat pozitive nga gjetja e zgjedhjeve të përbashkëta për probleme të përbashkëta, ku bashkëpunimi i tyre në sferën e sigurisë krijon relacione edhe më të sigurt, dhe paralelisht me këtë siguria paraqet një instrument të rëndësishëm për mbrojtjen e interesave të përbashkët. Kjo arrihet përmes një shkalle të institucionalizuar shkëmbimesh mes shteteve, gjë që detyrimisht çon drejt një sigurie reciproke. (Doyle, 1997, f. 19)

Në këtë drejtim mund të theksojmë se liberalizmi përfaqësohet me karakteristika që në thelb nënkuptojnë liritë individuale, pjesëmarrjen politike, pronën private dhe mundësi të njëjta për të gjithë. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, sipas liberalëve, natyra njerëzore, prosperiteti, demokracia dhe varësia ekonomike do të prodhojnë relacione të ndryshme nga ato për të cilat bëjnë fjalë realistët. Si më i rëndësishëm paraqitet fakti se një gjendje e tillë do të shkaktojë një situatë demokratike që minimizon konfliktin ushtarak. Së dyti, bashkëpunimi dhe ndërvarësia ekonomike minimizon mundësinë e përplasje ushtarake;

dhe së treti, institucioneet ndërkombëtare minimizojnë mundësinë e përplasjeve ushtarake. (Cavelty dhe Mauer, 2010, f. 29)

Në bazë të asaj që u paraqit më parë, vëmendja e këtij studimi është drejtuar drejt analizës së zhvillimit dhe karakteristikave të bashkëpunimit ndërshtetëror në kuadër të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale, veçanërisht nëpërmjet optikës për kontributin e tyre drejt sigurisë në përgjithësi dhe drejt promovimit të bashkëpunimit rajonal në veçanti, si një akt përmirësimi i sigurisë mes shteteve në rajon dhe më gjerë. Po ashtu, duke pasur parasysh faktin për rëndësinë e bashkëpunimit mes shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare, hulumtimi në këtë studim, në njëfarë mase do bazohet edhe mbi qëndrime dhe supozime të caktuara neoliberales.

Në lidhje me teza të tilla nga aspekti i sigurisë, institucionalistët liberalë theksojnë se në një mjedis si ai pas Luftës së Ftohtë, sfidat e reja për shtetet nuk do burojnë nga marrëdhëniet anarkike dhe mungesa e baraspeshës së forcave, siç shpjegohet në qëndrimet e realistëve, por nga proceset që ndodhin në vendet në tranzicion dhe ato në zhvillim; domethënë, nga sfida për forcimin e proceseve demokratike në këto shtete. Në këtë kontekst, ndryshimet demokratike në shtetet e lartpërmendura në sferën ekonomike, politike dhe të sigurisë paraqesin një faktor kryesor për transformimin e tyre nga shtete armike në shtete partnere për bashkëpunim. Kështu transformohet edhe dilema për sigurinë, e cila fillon të haset/zbulohet edhe nga sfidat joushtarake për sigurinë. Në këtë drejtim, siguria tani shfaqet në formën e një sistemi fluid bashkëpunimi formal e joformal në nivele të ndryshme, si në hapësirën lokale ashtu edhe në atë globale dhe anasjelltas.

KAPITULLI III: DREJTË NJË KORNIZE TË ZGJERUAR DHE THELLUAR MBI SIGURINË

Në kuadër të këtij kapitulli, vëmendja është e drejtuar nga qasjet teorike të analizimit të konceptit të sigurisë nga një këndvështrim të sifdave dhe shkollave bashkëkohore të analizës së sigurisë. Në këtë drejtim, sipas analizës së qasjes konstruktiviste dhe shkollës së Kopenhagës, studimi ka për qëllim të zbulojë se cilat janë paradigmat e sigurisë së Maqedonisë në periudhën e zhvillimit të saj si shtet entitet dhe cilat janë mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ajo nga një këndvështrim më i zgjeruar dhe i thelluar mbi sigurinë e saj.

Duke filluar nga fakti se në një fushë më të gjerë teorike mbi sigurinë, koncepti për sigurinë nënkupton që edhe në nivel të brendshëm, aktorët apo shtetet mund të shpërndajnë vlera të ndryshme si dhe norma e simbole nëpërmjet të cilave formohet identiteti i tyre shoqërorë specifik. Bashkëngjitur këtij konstatimi është edhe fakti se me një qasje të shkollave të lartëpërmendura në marrëdhëniet ndërkombëtare, shtetet janë të ndërlidhura nëpërmjet ndërveprimeve në shumë sfera të ndryshme, duke e përfshirë edhe sigurinë, përmes së cilës shtetet kanë interes të përbashkët, krijojnë reciprocitet dhe ndërtojnë besueshmëri ose përballen me frikën dhe skepticizmin. Nisur nga kjo, përqendrimi i sigurisë shpërndahet në të njëjtën dinamikë edhe në aspektin e brendshëm gjatë procesit të krijimit të politikave të sigurisë së shtetit.

Në këtë kapitull, duke pasqyruar konceptet bazë të qasjes konstruktiviste dhe asaj të Kopenhagës, fillimisht do sjellim pikpamjet e këtyre qasjeve dhe doktrinave të tyre mbi sigurinë, dhe duke marrë për bazë këto të fundit do vijojmë më tej duke treguar aspektin më të gjerë të sigurisë nga këndvështrimi i sfidave moderne pas Luftës së Ftohtë, me të cilat

vazhdojnë të ballafaqohen shtetet. Në të njëjtën kohë do të veçohen aspektet teorike të modelit me të cilën shtjellohet analiza për sfidat dhe mundësitë e sigurisë së Maqedonisë.

Kapitulli do trajtojë veçoritë e analizës përmes ndërverprimit shoqëror dhe konceptit të sigurisë së zgjeruar. Në sajë të qasjes së Shkollës së Kopenhagenit do të ndalemi edhe te siguria shoqërore si fragment i sigurisë së zgjeruar dhe të thelluar, me anë të së cilës do zbulohen sfidat e sigurisë së Maqedonisë nga perspektiva e identiteteve të brendshme dhe se si perceptohen ato nga komunitetet.

Kocepti i sigurisë shoqërore shfaqet për herë të parë në vitet '80 nga B. Buzan, i cili paraqet pesë sektorë mbi të cilët analizohet siguria në aspekte bashkëkohore, ku për nevojat e punimit veçojmë atë të sigurisë shoqërore, që kalon mbi konceptin e njohur të sigurisë deri më tani, si paraqitje e mbrojtjes ushtarake për shtetin dhe mes shteteve në një sistem ndërkombëtar. Siguria shoqërore është e lidhur ngushtë me sigurinë politike, dhe si e tillë përbën identitetin politik të shtetit dhe ekuilibrin shoqëror brenda saj. Dallimet e identitetit të grupeve të ndryshme, qofshin ato etnike apo kulturore, sjellin perceptime të ndryshme që ndikojnë në përpilimin e politikave të sigurisë dhe çfarë duhet siguruar brenda shtetit.

Perceptime të tilla nxjerrin dilema që kanë të bëjnë me çështjen se çfarë përbën në të vërtetë siguri për këtë apo atë grup etnik/kulturor. Koncepti analitik i Buzan-it shqyrton aspekte mikro dhe makro të sigurisë, dhe nga ky prizëm, përveç aspekteve tradicionale të analizës studimi do ketë mundësinë të shqyrtojë edhe aktorë të tjerë kontribues të sigurisë brenda shtetit, veçanërisht në ato shtete që përbëhen nga dy ose më shumë identitete, siç është rasti i Maqedonisë. Nga ky këndvështrim, punimi do synojë të shqyrtojë aspekte të

sigurisë dhe se si e perceptojnë njerëzit sigurinë brenda shtetit, një qasje kjo që do të na çojë deri te pyetje se çfarë duhet siguruar realisht.

Në bazë të paraqitjes së aspekteve teorike të sigurisë nga njëra anë dhe qëllimeve të hulumtimeve nga ana tjetër, në këtë studim nuk do jenë të përfshira të gjitha përpjekjet teorike për kuptimin e politikës së jashtme, siguruese dhe mbrojtëse të Maqedonisë. Në këtë kontekst, lënda konkrete e analizës do jetë qasja konstruktive drejt sigurisë dhe qasjes së shkollës për studime të sigurisë së Kopenhagenit në veçanti.

Nga ana tjetër, në kuptimin e qasjes teorike drejt sigurisë së Maqedonsë duhet të veçohet fakti se literatura që hulumton sfidat dhe përvojat në këtë sferë, si dhe modelet dhe institucionet që analizohen janë të vëllimshëm. Kjo literaturë, nga njëra anë tenton të mundësojë një rishikim historik të ideve për sigurinë e Maqedonisë, kurse nga ana tjetër orvatet të sqarojë përvojën pozitive dhe negative nga realizimi i saj. Gjithashtu, në një pjesë të madhe të literaturës, karakteristikat e sigurisë së Maqedonisë janë të analizuara konkretisht nga prizmi i politikës së jashtme ose më konkretisht i asaj rajonale. Natyrisht që një qasje e kësaj natyre nuk mund të pranohet si një qasje e vetme adekuate, pasi politikat rajonale që prekin sigurinë e Maqedonsë në shumë raste nuk janë në përputhshmëri, ose më së shumti paraqiten si perceptime për çështjen se çfarë përbën siguri për Maqedoninë. Analiza e këtyre perceptimeve do të nxjerrë në pah dallimet mes perceptimeve se si nënkuptohet siguria rajonale nga sfidat e paraqitura në aspektin e brendshëm.

Pavarësisht ndikimit të madh të politikës së jashtme dhe asaj rajonale në drejtim të pyetjeve për sigurinë e Maqedonisë, pjesa më e madhe e literaturës së saj për sigurinë para së gjithash është përshkruese, dhe në veçanti e fokusuar në zhvillimin e relacioneve

shtetërore me fqinjët, duke përshkruar identitetin e brendshëm dhe dilemat që paraqiten. Një pjesë e mirë e saj është e fokusuar te veprimet institucionale të Maqedonisë, me theks te ndryshimet e zbatuara me kontratat e BE-së dhe të marrëdhënieve me NATO-n. Pjesa më e madhe e literaturës është e natyrës informuese, në kuptimin që përqendrohet te dobia dhe humbja në pikën që Maqedonia të zhvillojë përbërësit e duhur siguries dhe mbrojtës.

Nga ky këndvështrim, ajo që është e padiskutueshme është se Maqedonia mund të perceptohet si një model adekuat i komunitetit të sigurisë, në kuadër të të cilit pyetjet e hapura mes subjekteve të saj konstitutive vlerësohen dhe trajtohen brenda kornizave të perceptimit të sigurisë në kufijtë e teorive të sigurisë tradicionale përmes aktit të shpalljes së pavarësisë në vitin 1991. Bashkë me këtë, kriteri teorik për ekzistencën e sigurisë shoqërore brenda një shteti nënkupton që Maqedonia si një aktor më vete nëpërmjet akteve të mëvonëshme të ndryshimeve kushtetuese përmes Marveshjes paqësore të Ohrit, e plotëson në një masë të madhe kriterin a një analize të zgjeruar dhe përtej kornizave të sigurisë tradicionale.

2. 1 Qasja konstruktive drejt sigurisë

Në kuptimin terminologjik, konstruktivizmi është shqyrtuar për herë të parë nga ana e Nicholas Onuf në veprën e tij më me ndikim *Bota që kemi krijuar* (1989). Onuf vë në dukje se mund të flitet për një qasje më të gjerë teorike drejt studimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila përfshin një spektër të caktuar temash dhe fushash nga politika ekonomike deri tek organizatat ndërkombëtare, siguria dhe mbrojtja. Në vazhdimësi Alexander Wendt paraqitet si një studiues i spikatur i konstruktivizmit dhe rëndësisë që i jep ndërveprimit shoqërorë në mardhëniet ndërkombëtare me veprën e tijë *‘Teoria*

Shoqërore e Mardhënieve Ndërkombëtare’ e cila hapi shtigjet për një kornizë teorike dhe një analizë konstruktiviste mbi mardhëniet ndërkombëtare.

Qasja konstruktive analizon rolin dhe funksionin e fakteve shoqërore dhe ndikimin e praktikës sociale në kuptimin e politikës botërore deri në atë masë, sa që konstruktivizmi paraqitet si një këndvështrim i kundërt me neorealizmin dhe neoliberalizimin, të cilët përbëjnë një qasje racionale drejt marrëdhënieve ndërkombëtare. Në shpjegimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë, konstruktivizmi e drejton vëmendjen kah proceset shoqërore dhe kah thelbi i dyfishtë i normave që ndërmarrin një pozicion qendror nëpërmjet të cilit mund të kuptohen si proceset e brendshme ashtu edhe proceset politike ndërkombëtare. Sipas konstruktivizmit, një pozicion i tillë mundëson një analizë të përshtatshme në lidhje me potencialet e konfliktit ndërmjet normave të ndryshme konstruktive të nivelit kombëtar, por edhe në procesin me të cilin përshtaten normat në marrëdhëniet ndërkombëtare. (Katzenstein, 1996, f. 2)

Pikëpamjet kryesore konstruktiviste përqëndrohen në faktin se mjedisi në të cilin shtetet dhe aktorët e tjerë politikë veprojnë dhe identitetet politike janë të rëndësishme në perceptimet e ndërtuara në atë mjedis duke spikatur se vlerat që ndërton shoqëria janë po aq të rëndësishme sa edhe asetet materiale që ajo posedon. Në bazë të kësajë ambienti në të cilën shtetet dhe kombet veprojnë mundë të përcaktoj më drejt dhe saktë interesat nacionale. (Katzenstein, 1996, 13)

Së këndejmi del se interesat e shteteve nuk paraqiten në mënyrë të pavarur, por si rezultat i mjedisit apo rrethanave të tyre. Konstruktivizmi promovon pikëpamje të ngjashme edhe në lidhje me kuptimin e sigurisë. Kështu, sipas këtij drejtimi, siguria nuk përbën një

gjendje objektive, por atë çfarë bëjnë shtetet, dhe si pasojë ajo është e konstruktuar në mënyrë varshmërie në kornizat e marrëdhënieve ndërkombëtare. (Katzenstein, 1996, 4)

Në lidhje me kërcënimet për sigurinë, konstruktivistët mendojnë se nuk është një çështje e thjeshtë. Pyetja që shtrohet është se a do jetë i perceptuar në mënyrë të përshtatshme ndikimi i kërcënimeve të drejtpërdrejta? Sipas tyre nuk bëhet fjalë për një objekt referent, statik dhe konkret të sigurisë, ngaqë ai paraqet një kategori të ndryshueshme dhe dinamike. Konkretisht, konstruktivizmi e përkufizon sigurinë si mungesë kërcënimi për vlerat kryesore. Gjithashtu, në kuptimin objektiv, siguria reflekton mungesën e kërcënimeve ndaj këtyre vlerave. Kurse në kuptimin subjektiv, mungesën e frikës që vlerat do të ishin të kërcënuara. (Cho, 2009, 79)

Që kur u paraqit në vitet '80, konstruktivizmi kaloi në një qasje teorike më të shquar për analizën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Nëpërmjet kombinimit të qasjes dhe afrimit sociologjik të teorisë kritike, konstruktivistët theksojnë se shoqërisht bota ndërtohet nëpërmjet ndërveprimeve ndërsubjektive, që do të thotë se normat, identiteti dhe idetë janë të një rëndësie shumë të madhe për sa i përket krijimit dhe dinamikës së politikës botërore. Kështu, mund të themi se në një formë të përgjithësuar nis edhe rëndësia e një analize për këtë shkollë për nevojat e studimit.

Megjithatë, edhe përkrah fokusit të tyre të pyetjeve të sigurisë, shkalla që kanë zhvilluar konstruktivistët për sa i takon teorisë së sigurisë ndërkombëtare është e kufizuar. Ajo i ndan konstruktivistët nga teoricienët e tjerë kritikë, koncepti për siguri i të cilëve është përkufizuar si përkushtim drejt zhvillimit dhe nga teoria realiste për politikë botërore e të cilëve, si tërësi paraqitet në një masë të konsiderueshme të politikës për siguri dhe fuqi. Nga perspektiva e realistit, një perceptim i dukshëm është se konstruktivizmi kryesisht

shmang fokusimin e fuqisë dhe sigurisë politike dhe në vend të kësaj fokusohet te zhvillimi i normave të udhëheqjes me garën mes shteteve dhe institucionalizimit të formave më të gjera të komunitetit politik. (Mearsheimer, 1994/95, 19)

Një perceptim i tillë nga ana e relaistëve për sigurinë, sipas konstruktivistëve paraqet një koncept të ngushtë të sigurisë, e përkufizuar nëpërmjet shteteve, ushtrive dhe përdorimit të kërcënimeve me forcë. Konstruktivistët konsiderojnë se qasja e tyre praktikisht mundëson një kuptim më të sofistikuar dhe më të tërësishëm të dinamikës, e cila lidhet me sigurinë tradicionalisht, duke filluar nga natyra e fuqisë e deri te dyshimi i sigurisë dhe baraspeshës së fuqisë. (Hopf, 1998, 179)

Kështu, konstruktivistët janë të mendimit se periudhat kohore dhe gjendja strukturore dhe sistemike e shteteve domosdoshmërisht kanë dhe reflektimin se si shtetet sillen në arenën ndërkombëtare. Çështjet e sigurisë janë ngushtë të ndërlidhura me fusha të sistemit dhe vlerave kulturore të lartëpërmendura dhe si të tilla reagojnë në formësimin e interesave kombëtare dhe definimin e prioriteteve të sigurisë kombëtare. Qasjet konstruktive pranojnë se janë aktorët që reagojnë bazuar mbi faktorët kulturorë dhe në sajë të kësajë ndërtojnë politika sigurie. Siç vërehet edhe në veprën P. Katzensteinit, një prej studiuesëve më eminent të konstruktivizmit aspektet kulturore dhe normat mbisunduese të sistemit përbëjnë ndër elementet më të rëndësishëm të politikës ndërkombëtare. (Katzenstein, 1996, f. 2)

Gjithashtu, një qasje të mundshme për kuptimin e afërsisë konstruktive drejt sigurisë paraqet edhe perceptimi që vetë siguria të kuptohet si tegues se përsëri vlerave materiale përbërës të rëndësishëm të sigurisë janë edhe idetë që i japin kuptim vlerës materiale dhe si perceptohet ajo. Idetë dhe mendimet janë të rëndësishme sepse ato na japin

kuptimin mbi jetën shoqërore dhe mbi cilat vlera ajo ndërtohet. Për më tepër normat në rastin kur ato përbëjnë lidhje me sigurinë nuk janë vetëm indicje të thjeshta shoqërore por kanë një efekt më të thellë. Normat dhe idetë në këtë rast definojnë identitetet dhe japin drejtimin e përkufizimit të sjelljes së përgjithshme duke rregulluar sjelljen e shteteve dhe duke i informuar ato se çfarë në të vërtetë janë ata, si duhet të sillen dhe çfarë duhet të bëjnë në raste. Pra në një gjendje të këtillë normat janë reflektim i asaj që e bënë shtetin dhe institucionet e saj të sillen në mënyrë të veçantë duke ndërmar veprime mbi bazë të asaj që besojnë se janë. (Katzenstein, 1996, f. 5)

Fokusi i një mënyre të ngjashme shtrihet mbi njohjen e faktit se perceptimet mbi sigurinë, dilemat që mund të shfaqen dhe supozimet për mosbesim të përbashkët ku ajo shtrihet nuk është një tipar i pashmangshëm i politikës ndërkombëtare si rrjedhojë e gjendjes anarkike. Në vend të kësaj duhet parë si në një konstrukt shoqëror, që është specifik për momente të caktuara historike dhe forma të caktuara të politikës së identitetit. Në këtë kontekst, konstruktivistët besojnë se siguria është një konstrukt shoqëror, që në kontekste të ndryshme nënkupton qasje të ndryshme. Siguria kuptohet edhe si një mekanizëm për negociatë dhe garë, ku aktorët garojnë për përkufizimin e identitetit dhe disa vlerave të një grupi, në atë mënyrë që të përftohet një veprim politik. Identiteti dhe normat konsiderohen si qendrore për studimet për siguri, bashkë me kufijtë për një veprim të realizueshëm politik e legjitim. Përfundimisht, organet dhe strukturat janë bashkërisht të përcaktuara, edhe pse bota është ashtu siç e kemi formuar ne; madje edhe ndryshimet strukturore janë gjithmonë të mundura, edhe pse është shumë e vështirë të gjejmë zbatim. Ekzistojnë ndryshime të cilat nuk janë të parëndësishme midis qasjeve konvencionale dhe konstruktive në lidhje me çështjet e kuptueshme dhe empirike, duke e përfshirë edhe epistemologjinë dhe identitetin,

por përkushtimi themelor i përbashkët i idesë së sigurisë si konstruksion shoqëror mundëson një diskutim për sa i përket “qasjes konstruktive drejt sigurisë”. (Cho, 2009, 97)

Vetë konstruktivizimi duhet të kuptohet në variantin e tij konvencional dhe kritik, ku kjo e fundit është më fort e lidhur me teorinë kritike shoqërore. Mundësia e konstruktivitetit konvencional për t’u paraqitur si alternativë e rrjedhave kryesore të teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare shfaq nevojën për një qasje më të thellë hulumtuese. Një program i tillë përfshin rikuptimin konstruktiv të teorisë së bashkëpunimit. Një lëndë të parë për interesin e veçantë në këtë drejtim për qasjen e konstruktivistëve paraqesin edhe pyetjet e lidhura me identitetin e politikës botërore si dhe teoria e politikës dhe kulturës vendëse nga këndvështrimi i teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare. (Katzenstein, 1996, 4) Kjo rrejdhimisht përbën edhe nevojën e spikatjes së çështjes së identitetit për analizën e mëvonshme të studimit.

3.1.2. Qasja konstruktive drejt identitetit

Pavarësisht faktit se identiteti ka luajtur një rol të rëndësishëm në studimet e sigurisë në forma të ndryshme, konstruktivistët janë ata që i kanë dhënë një lidhje të rëndësishme identitetit dhe sigurisë. Ndonëse dallimet mbi mënyrën e analizës dhe rëndësisë që identiteti ka në sigurinë kombëtare janë të shumta për konstruktivistët ajo ngel e rëndësisë së veçantë për hulumtimin mes kornizave të ndryshme dhe të qasjeve të zgjedhura të analizës së sigurisë. Për të pasur një kuptim më analitik të këtyre qasjeve konstruktiviste duhet mbështetur tek ndarja e shumpërfulur e Ted Hopfit në lidhje me “identitetin” që përbënë një kornizë të kapshme për hulumtimin e dallimit mes qasjeve konstruktive siç janë ajo konvencionale dhe kritike. (Hopf, 1998, 181)

Për konstruktivistët konvencionalë shqetësimi kryesor gjatë përcaktimit të lidhjes mes sigurisë dhe identitetit është të dëshmojë se identiteti kombëtar dhe përvoja e ndërlidhur historike ose konteksti kulturor ndihmon në përcaktimin e përmbajtjes së interesave të një shteti, dhe si rrjedhojë edhe për mënyrën me të cilën do silllet shteti në politikën globale. Kështu, konstruktivistët mendojnë se shteti silllet në një mënyrë të caktuar, ngaqë ai influencohet nga rrethanat e sigurisë, dhe se këto rrethana reflektojnë normativën kulturore dhe institucionale. Normat krijohen nga ekzistenca e ideve dhe idetë zhvillojnë ndërveprime sociale, që japin mundësi zgjedhjeje për atë se çfarë dhe si duhet ndërvepruar me politikat në momente të caktuara. Për ta përmbledhur, mund të themi se identiteti shtetëror formohet nga normat shoqërore që reflektojnë zgjedhjen e një sjelljeje të caktuar për të formuluar intereset kombëtare apo shtetërore të saj. (Cho, 2009, 79)

Identitetet janë të përkufizuar si relativisht të qëndrueshëm ose të grumbulluar, duke i mundësuar analistit të hulumtojmë se pse shtetet kanë një sjellje të caktuar, ku paraqitet një lidhje e arsyeshme midis identitetit dhe interesave. Studimet e Peter Katzenstein paraqesin një kuadër analize të rëndësishëm në formulimin e politikave kombëtare. Siç u përmend më parë në seksionin paraprak, ai mendon se aspektet kulturore të formulimit të politikave mundësojnë institucionalizimin e identitetit të shtetit, qeverisë dhe aktorëve të tjerë politikë, dhe rrjedhimisht ato kanë rëndësi për rezultatet që mund të kenë për sigurinë kombëtare. (Katzenstein, 1996, 16) Segmentet e kësaj qasjeje janë të rëndësishëm në nxjerrjen e mësimave kur bëhen analiza që kanë të bëjnë me sigurinë dhe si përdoren mjetet siguruese në raste dhe ambiente të caktuara, që në teorinë tradicionale për sigurinë nuk paraqetnin si të rëndësishme, siç e pamë nga sa trajtuam më lart.

Për konstruktivistët kritikë shqetësimi kryesor përgjatë hulumtimeve të lidhjes mes sigurisë dhe identitetit është të vërtetohet se si përshkrimet e identitetit kombëtar, për shembull, paraqitja e historisë, bëhen dominues në një kontekst të caktuar. Si reflektim i gjithë kësaj, ato ndihmojnë për vërtetimin e kufijve për një veprimtari legjitime dhe reale politike. Këtu identiteti është thellësisht i qëndrueshëm, i kushtëzuar dhe i përket një gare të përhershme. Nga kjo pikëpamje, paraqitja e sigurisë dhe kërcënimeve mund të ketë një rol shumë të rëndësishëm, pikërisht në përcaktimin e çështjes se kush jemi “ne” dhe kush janë “të tjerët”, prej të cilëve duhet të mbrohem. Sipas kësaj, studimet e identitetit bëhen studime të paraqitjeve të ndryshme, të cilat garojnë në përpjekjen për të dhënë një shpjegim real se cili mund të jetë ai grup dhe si duhet të sillët. Për konstruktivistët kritikë, analistët të cilët mundohen ta përkufizojnë “identitetin kombëtar” të një kombi ose shteti, rrezikojnë të përfshihen në këtë luftë të fuqisë politike, dhe kështu do privilegjojnë përkufizime të caktuara të identitetit duke nënshtruar të tjerë në të njëjtën kohë. (Cho, 2009, 91)

3.2 Qasja e Shkollës së Kopenhagenit

Pas përfundimit së Luftës së Ftohtë, debatet për qasjet tradicionale të sigurisë, që kishin filluar tashmë, po merreshin seriozisht nga analistë dhe studiues të ndryshëm. Evoluimi i analizës dhe debatit mbi sigurinë filloi të zhvendoset nga baza tradicionale me segmente bashkëkohore të analizës së sigurisë duke inkorporuar qasje dhe fusha të tjera përtej koncepteve tradicionale. Perspektivat tradicionale, sidomos ato të bazuara mbi konceptin realist, deri në atë kohë e konsideronin sigurinë si derivat të fuqisë, e përqendruar te aktori shtet në një gjendje anarkike. Në vazhdimësinë e saj vërehen segmente shtesë, si ai

i shkollës konstruktiviste, që e bazon gjendjen e sigurisë te ndërveprimet socio-kulturore dhe normative institucionale.

Në një larmi të tillë diskutimesh mbi zgjerimin e sigurisë kemi edhe paraqitjen e Barry Buzan me librin *Njerëzit, shtetet dhe frika*. Në këtë vepër ai thekson se siguria paraqitet në shumë fusha të tjera jashtë asaj ushtarake dhe politike. Ai argumenton se koncepti i sigurisë në një këndvështrim realist është shumë i ngushtë, dhe si i tillë nuk reflekton te sfidat që paraqiten për sigurinë në një kontekst bashkëkohor.

Për Buzan-in siguria ka të bëjë me “mbrojtjen e lirisë nga kërcnimi dhe aftësinë e shteteve dhe shoqërive për të mbrojtur identitetin e tyre të pavarur dhe integritetin funksional kundër forcave të ndyshimit që ata i shohin si armiqtësore. Qëllimi thelbësor i sigurisë është mbijetesa, që gjithashtu, në mënyrë të arsyeshme, përfshin një gamë të konsidereushme shqetësimesh për kushtet e mbijetesës. Deri në pikën që ky varg shqetësimesh pushon së merituari urgjencën e sigurisë, që i identifikon kërcënimet si mjaft të rëndësishme për të mobilizuar veprime emergjente dhe masa të jashtzakonshme, duke përfshirë përdorimin e forcës dhe bëhet pjesë e pasigurive të përditshme”, është një nga kompleksitetet e konceptit. (Buzan, 1991, 432)

Nisur nga ajo që theksuam më sipër si gjendje sigurie, mund të pohojmë se Shkolla e Kopenhagenit shqyrton aspekte mikro dhe makro të sigurisë, dhe kështu ajo përbën një aktor analize që ndërthuret me të tjerë e që nxjerrin një pasqyrë më të gjerë fushash analize që mundësojnë një kuptim më të lehtë se çfarë përbën siguri për një shtet apo komunitet. Një shqyrtim i tillë i sigurisë, që kryesisht është i përqendruar në aspektin social të analizës e që e sjell këtë qasje afër mësimëve konstruktiviste, ka të bëjë me çdo aspekt që

kontribuon apo influencon në perceptimin e sigurisë. Nisur nga kjo mund të veçojmë se shkolla dhe mësimet e Kopenhagenit e nisin analizën e zgjeruar në drejtim të

- nivelit të njësisë së analizës;
- fushës së analizës;
- sigurimit dhe desigurimit të çështjes. (Stone, 2009, 2)

Premisa e nivelit të analizës nënkupton objektin referues si një matës hapësinor apo gjeografik, dhe kjo njësi matëse, siç e thamë më sipër, përkon edhe me qasjet tradicionale, sidomos me ato neorealiste, dhe si të tilla ndahen në:

- niveli i sistemit ndërkombëtar në nivel global dhe nënsistemet ndërkombëtare si organizatat rajonale;
- niveli i njësive, siç janë shtetet, kombet grupet shoqërore dhe nënnjësitë, si administrata dhe grupet/lobet e ndryshme;
- individit (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 5-6)

Nisur nga referencat e mëhershme, marrëdhëniet shoqërore të aktorëve të sigurisë mund të ndodhin në nivele të ndryshme hapësinore dhe gjeografike, që nënkupton lokacionet ku ndodhin ndërveprimet dhe ku përcaktohet objekti referues. Lokacioni është gjendja ku gjenden burimet dhe rezultatet e shpjegimit. Arsytet e shpjegimit, në të shumtën e rasteve mund të lidhen me njëra- tjetrën nga një nivel më i ulët në një më të lartë, nga një grup shoqëror deri te shteti dhe më lart, ose anasjelltas. Nivelet paraqesin një kuadër rreth të cilit mund të diskutohet për teoritë, por ajo nuk paraqet një teori në vetvete por thjesht një lokacion burimi si rezultat i së cilës ndërtohen teoritë. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 26)

Kjo qasje, siç pranohet edhe nga vetë studiuesit, është afër qasjeve neorealiste, dhe si e tillë i nënshtrohet kritikave: se ajo forcon nocionin e analizës shtetocentrike. Por, në të njëjtën kohë, duke analizuar natyrën e njësive brenda, ndonjëherë mund të paraqiten si më të mëdha se shteti, siç bëhet me studimet apo nënnjësitë rajonale; por ndodh që të jenë edhe më të ndryshme, siç janë grupet shoqërore në nivel grupi identitar me një analizë epistemologjike. Këto relata nivelesh në fusha të ndryshme, mund të themi se ndodhin si një zhvendosje më e zgjeruar dhe e thelluar e kësaj qasjeje drejt konstruktivizmit. Kjo sidomos bëhet evidente duke marrë në analizë makro dhe mikro nivelet dhe fushat e analizës, që janë kuadri ku formësohet analiza në një mënyrë më të diversifikuar. (Stone, 2009, 4)

Fushat e analizës apo zgjerimi i referohet postulatit të lartëpërmendur, se siguria ka të bëjë me mbijetesën, që gjithashtu, në mënyrë të arsyeshme përfshin një gamë të konsidereushme shqetësimesh për kushtet e mbijetesës. Adoptimi i këtij koncepti të zgjeruar në fusha të ndryshme është rezultat i nevojës për të kuptuar më lehtë logjikën e asaj se cilat janë relatat e njësive në fusha të ndryshme ndërveprimi. Këto fusha, ndonëse kanë pasur rëndësi në diskursin e mëhershëm për sigurinë, janë konsideruar si qasje në analizë të teorisë politike, pa vënë re rëndësinë e tyre, veçmas në logjikën e sigurisë. Bazuar te debatet e zgjerimit për sigurinë, kjo shkollë thekson se sektorët e rëndësishëm në kuptimin e sigurisë janë pesë, dhe analizohen si një koncept me ndërveprime specifike, duke veçuar:

- sigurinë ushtarake që ka të bëjë me ndërveprimin ushtarak në mbrojtje të shtetit dhe perceptimet ushtarake të të tjerëve ndaj shtetit;

- sigurinë politike, që nënkupton stabilitetin e sistemit shtetëror dhe legjitimitetin e tij;
- sigurinë ekonomike, që merret me shqetsimet ndaj resurseve materiale të mjaftueshme për mirëmbajtjetjen e fuqisë së shtetit;
- sigurinë shoqërore, që i referohet shqetësimeve për qëndrueshmërinë dhe për konditat e rigjenerimit të gjuhës, kulturës, normave dhe identitetit;
- sigurinë mjedisore, që ka të bëjë me mirëmbajtjen e kushteve mjedisore lokale dhe globale, ku njeriu kushtëzohet në ekzistencën e tij. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 8)

Një qasje e tillë multisektorale lejon një këndvështrim më të gjerë të objektit referues, duke përjashtuar shtetin si objekti i vetëm ndërveprues, duke zbërthyer disa fusha të tjera ndërvepruese. Ato analizohen si segment i veçantë, por jo krejt të pavarura nga njëra-tjetra. Marrëdhëniet e detyrimit ushtarak nuk ekzistojnë të pavarura nga marrëdhëniet e shkëmbimit ekonomik, autoritetit politik apo identitetit.

Kjo qasje mundëson vlerësimin e çdo fushe në mënyrë të zbërthyer, por detyrimisht ato ndërlidhen me njëra-tjetrën për të formuar një pasqyrë të qartë dhe të përgjithshme mbi sigurinë. Një nevojë e tillë për konceptualizimin është e qëllimshme, që të dallohet ai që mund të jetë një vendim politik nga një ndërmarje ushtarake. Ato duhen të dallojnë patjetër objektin referues nga aktori që ndërmer një akt të tillë, që Shkolla e Kopenhagenit i referohet si sigurizim. Në fakt, sigurizimi është linja ndarëse mes ndërveprimit shoqëror për të evidentuar rrezikshmërinë deri në masën që gjenerohet aplikimi i masave të jashtëzakonshme përtej procedurave të rregullta.

Sigurizimi i mbledh të gjitha qasjet në një kornizë të përbashkët, ku kalon në një nivel tjetër analize. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 5)

3.2.1. Teoria e sigurizimit

Në këtë pjesë të punimit, koncepti për paradigmën e sigurisë së Maqedonisë analizohet përmes programit të teorisë së sigurizimit.

Teoria e sigurimit daton që nga fundi i viteve '80, dhe është e iniciuar nga ana e Olev Waever-it, si hulumtues i institucionit të Kopenhagenit për hulumtimet e paqes. Qëllimi për zhvillimin e kësaj teorie rrjedh nga një ndryshim rrënjësorë që u paraqit me ndryshimet globale që pasuan luftën e ftohtë dhe një zgjerim i koncepteve mbi studimet e sigurisë kryesisht të atyre tradicionale. Teoria e sigurizimit paraqet në vete një zgjatje dhe kornizë mbështetëse që sjell studimet e zgjeruara dhe të thelluara të sigurisë në një kornizë analitike mbi të cilën mundë të shtjellohen diskursi për siguri.

Në këtë drejtim mund të theksohet se ngjallja e debatit nga njëra anë përmes përkrahësve të idesë së konceptit për siguri të zgjeruar përtej qasjes tradicionale të studimit të saj dhe fokusit të dimensionit ushtarak dhe, nga ana tjetër, përkrahësve për kuptimin tradicional për sigurinë, se nuk duhet të zgjerohet koncepti për sigurinë, gjithsesi pati një ndikim shumë të rëndësishëm mbi krijimin e teorive të reja për konceptin e sigurimit. Në këtë kontekst vlen të theksohet përsëri se Shkolla e referuar e Kopenhagenit për studime të sigurisë pozicionohet përmes ideve tradicionale nga njëra anë dhe përmes përkrahësve për zgjerimin e konceptit për siguri me sferën politike, ushtarake, ekonomike, sociale dhe ekologjike nga ana tjetër. (Buzan, Waever dhe Wilde 1998, 4)

Duke filluar nga një pozicion i tillë, Waever-i tregon se përkufizimi për sigurizim paraqitet si rezultat i aktiviteteve që ndërmerr politika e jashtme nga rregullat e vendosura të lojës, dhe kështu e kufizon problemin dhe e prezanton atë si një problem urgjent, si dhe mëton zgjidhjen e problematikës së paraqitur me masa urgjente duke e përçar veprimin e sigurizimit në një version tjetër edhe më ekstrem në politikë.

Në shpjegimin e kësaj teze, Waever-i niset nga qëndrimi se çdo pyetje mund të paraqitet si:

- jopolitike kur aktori nuk përballlet me një pyetje konkrete dhe ajo nuk është pjesë e një debati publik;
- politike, kur pyetja është pjesë e politikës dhe paraqitet si e domosdoshme që qeveria të vendosë dhe të sigurojë mjetet përkatëse për zgjidhjen e saj;
- sigurizimi, kur pyetja parashtrohet si kërcënim ekzistencial dhe në bazë të kësaj janë të domosdoshme masa të shpejta dhe urgjente për zgjidhjen e kërcënimit. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 23)

Kështu pra, thelbi i teorisë për sigurizim shtjellon idenë se në marrëdhëniet ndërkombëtare ngjarjet për probleme të përcaktuara paraqesin probleme të politikës urgjente, dhe jo se ato mund të paraqesin gjithmonë rrezik për shtetin. Por, para së gjithash ato bëhen të tilla me vendimin e aktorit të sigurizimit. Aktor i sigurizimit nuk është gjithnjë vetëm shteti si i tillë, sikurse pozicionohet për këtë çështje qasja realiste; përkundrazi, këtë rol mund ta kenë edhe liderët politikë, ekspertët, organizatat ndërkombëtar etj. Kjo do të thotë se është aktori ai që paraqet argumentet për karakterin ekzistues të kërcënimit në referimin e objektit konkret të kërcënuar. Objekti i referentit në këtë drejtim paraqet pikërisht atë që ka nevojë për mbijetesë si i tillë, e që rezulton nga kërcënimi aktual dhe momental. Rrjedhimisht, mund të themi se kriteri për sigurizim ka të bëjë me faktin se kur

çështja për të cilën prezantohet kërcënimi ka një efekt politik, atëherë procesi i sigurizimit ka filluar. Dhe nëse aktori ia del që nëpërmjet politizimit të lartpërmendur të ndërmarrë hapa jashtë kornizave dhe rregullave të përcaktuara, atëherë kemi të bëjmë me një rast sigurizimi të plotë. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 24-25)

Këto lloj projektesh mund të jenë të ndryshme, ngaqë në kushte të caktuara ka mundësi të shumta që e njëjta çështje të shfaqet me perceptime të ndryshme për objektet referente të cilave duhet t'u sigurohet mbijetesa. Në praktikë ky ndryshim në reflektim mund të paraqitet nga kuadri i sistemit politik, që është ai demokratik ose autokratik, ose nga çështja në shqyrtim. Duhet të përmendim se lidhja e paraqitur më lart ndërmjet sigurizimit dhe politizimit jo gjithmonë kalon nëpërmjet aparatit sistematik të shtetit: ajo mund të implemetohet edhe nga entitete të tjera shoqërore (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 24)

Pavarësisht nga objektet referuese të përmendura si elemente kryesore në sigurizim si pjesë e rëndësishme e sigurizimit janë dhe dy pjesë përbërse për të përmbushur sigurizimin dhe atë aktori sigurizues dhe audienca. Kjo pjesë është ndoshta edhe pjesa më e rëndësishme e procesit të sigurizimit për të patur atë plotësisht të sukseshëm. Aktorët sigurizues janë ata që duhet nëpërmjet aktit ligjërues për të bindur një audiencë specifike për egzistimin e një kërcënimi egzistencial që kanoset. Në qoftë se një çështje parashtrohet dhe “pranohet” nga ana e publikut, aktorët mbikëqyrës të sigurizimit do të nisin zbatimin e masave urgjente, ku mund të ndikojnë edhe jashtë ligjeve dhe procedurave të parashtruara në orvatje për zgjidhjen e kërcënimit të pranishëm. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 41).

Në këtë kontekst, Buzan thekson se sigurizimi zbatohet në bazë të pranisë së kërcënimeve egzistenciale, të cilat si të tilla legjitimojnë edhe thyerjen e rregullave eksistuese. Më tutje ai thotë se që një sigurizim të jetë i suksesshëm i duhen tre përbërës:

kërcënimi i pranishëm, trajtimi urgjent për evitimin e tij dhe efektet e marrëdhënieve mes njësisë nga efektet e thyerjes së rregullave në proces të sigurizimit të plotë (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 24-25)

Si rrjedhojë mund të themi se teoria e sigurizimit është zhvilluar si mjet analitik, dhe si qëllim të vetëm ka pasur ndihmën ndaj analistëve që të vërtetojnë se kush ka kryer sigurizim, me çfarë mjatesh dhe çfarë pasojash. Aktori i sigurimit dhe analisti i sigurimit janë dy funksione dhe dy emërtime të ndryshme. Analisti nuk është në atë pozitë që të ndërhyjë në ekuacione të japë rekomandime lidhur me sigurizimin.

Sipas Buzan-it, etiketimi i diçkaje si çështje sigurimi vjen nga aktori politik, jo nga analistët. Analistët komentojnë veprimet e aktorëve politikë, i vërtetojnë dhe plotësojnë kriteret e sigurimit. Analisti është ai që vlerëson se a është efikas aktori në mobilizimin e mbështetjes në lidhje me referencën e sigurimit. Për tentativat për konvertimin e ndonjë çështjeje nga aspekti i sigurisë, fillimisht gjykojnë aktorët dhe qytetarët e tjerë të përgjithësuar, e më pas në bëjnë interpretimin dhe masim shkallën e ndjekjes së tyre. Përfundimisht, për t'u vlerësuar rëndësia e ndonjë modeli sigurimi, analistët studiojnë efektet e tij mbi njësitë e tjera. Aktori urdhëron një hap shumë të rëndësishëm: zbatimi i ndonjë akti politik në një gjendje sigurie (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 33-34)

Sekuritizimi si i tillë veçohet si një akt ligjërimi, ku shqipërimi i sajë në vetvete përbën aktin. Duke shprehur kërcënimin aktori mëton të lëviz çështjen jashtë një sfere të politikës së rregullt në atë të sigurisë me vetë faktin se në procese sipër e lëviz çështjen në drejtim të legjitimitetit të përdorimit të masave të jashtëzakonshme. Kjo kryesisht ka të bëjë me përdorimin e një diskursi, apo akti ligjërues dhe si i tillë ndonjëherë shihet edhe si politizim i skajshëm i çështjes. Por ajo që e bënë të veçantë këtë çështje dhe e nxjerr nga

orbita e të qenurit thjeshtë një politizim i skajshëm, sepse e e veçon atë me aplikimin e masave të jashtëzakonshme në një kohë të caktuar me kërkesë të menjëhershme të zgjidhjes së saj me mjete që nuk janë të parapara.

Në çdo rast, për një vlersim të duhur të sigurizimit nuk është shumë e dobishme për të bërë një diferencim qënësorë për të shfaqur realitetin e një kërcënimi të vërtetë apo politik. Më e rëndësishme që në vet ndërmarrjen e nismës për sigurizim të shihet vet procesi si ti tillë për të kuptuar dinamikën dhe ndërveprimin e aktorëve të rëndësishëm të kyçur në të gjithë që mundëson për të shmangur dilemat e sigurisë që paraqiten bashkarisht me çështjen e diskutuar.

Në lidhje me natyrën e kërcënimeve ekzistuese, gjithashtu mund të themi se edhe në sektorë të ndryshëm, kërcënimet janë të drejtuara drejt objekteve të ndryshme referente. Kështu që, për shtetin, mbijetesa është e perceptuar nëpërmjet prizmit të kërcënimeve të sovranitetit, për shoqërinë në lidhje me identitetin, në sektorin ekonomik drejt kompanisë ose sektorit të rëndësishëm të cilit i mundësohet thyerje rregullash ekonomike etj.

Synim i këtij studimi, në rastin konkret është që nëpërmjet mekanizmit të sigurizimit të analizojmë sfidat dhe mundësitë e paradigmave të sigurisë së Maqedonisë në sektorin e sigurisë shoqërore. Prandaj është e rëndësishme që në vijim të jepen disa segmente kryesore të analizës në fushën e sigurisë shoqërore dhe çfarë paraqet ajo në të vërtetë.

3.2.2. Siguria shoqërore

Siç u përmënd edhe më herët, Shkolla e Kopenhagenit thekson në specifikën e saj disa nga elementet që mund të gjenden në shkollat tradicionale dhe ato më bashkëkohore. Analiza e Buzan-it mund të konsiderohet si një shkrimje e lehtë e shkollës neorealiste dhe asaj konstruktiviste. Ai e bën këtë duke pranuar qëndrimin neorealist se “sistemi politik ndërkombëtar është një anarki që në një kuptim tjetër aludon mungesën e një sistemi gjithpërfshirës qeverisjeje”. (Buzan, 1991, 26)

Buzan e pranon argumentin e realistëve që siguria të lidhet meoemos me mbijetesën, por, gjithashtu, në të njëjtën kohë shton se ndonëse varianti ushtarak është më i rëndësishmi, një shtet mund të sigurojë edhe aspekte të tjera të jetës shoqërore, si gjuhën, kulturën apo identitetin kombëtar, që mund të konsiderohen si kërcënime ndaj sigurisë kombëtare shtetërore. Teza e tij zgjerohet me faktin se ai inkorporon qëndrimin se siguria dhe kërcënimet nuk janë qëllime fikse, por rezultat i konstruksioneve shoqërore. Fakti që Buzan i zgjeron fushat referuese të sigurisë në ato sociale, si rezultat i ndërveprimeve shoqërore, bën që sistemi analitik i tij të jetë edhe konstruktivist në të njëjtën kohë. (Collins a.d., 215)

Siguria e shtetit dhe sovraniteti i tij, siç u shtjellua më herët, ka qenë njësia kryesore në të cilën janë përqendruar debatet për sigurinë. Por, sikurse edhe debati për zgjerimin e fushave të studimit mbi sigurinë, siguria shoqërore filloi të shihet si një objekt paralel referues krahas asaj shtetërore, dhe në fakt në një masë të madhe, sepse në terminologjinë tradicionale, shteti si objekt referues analize bazohet në territorin e tij të formalizuar me anë të kufijve shtetërorë dhe legjitimuar përmes sistemit politik dhe institucional. Por, duke u nisur nga fakti se shumë shtete nuk paraqesin një kohezion kombëtar, qoftë në aspekt të

brendshëm territorial apo nga jashtë, rrjedhimisht koncepti i identitetit shoqërorë paraqitet si shumë i rëndësishëm. (Buzan, Waever dhe Wilde,1998, 119)

Kështu mund të kuptojmë se diskutimi në shumicën e rasteve ndihmon në vërtetimin e kufijve për një veprimtari legjitime dhe reale politike, ku identiteti është thellësisht i qëndrueshëm, i kushtëzuar dhe i përket një gare të përhershme. Nga kjo pikëpamje, paraqitja e sigurisë së identitetit dhe kërcënimeve ndaj tij mund të ketë një rol shumë të rëndësishëm, me përcaktimin e asaj se kush jemi “ne” dhe kush janë “të tjerët”, nga të cilët duhet të mbrohemi. (Cho, 2009, 91)

Sipas kësaj, studimet e identitetit bëhen studime të paraqitjeve të ndryshme të cilat garojnë me njëra-tjetrën në përpjekjen që të japin një shpjegim të qenësishëm në lidhje me çështjen se cili mund të jetë ai grup dhe si duhet të sillet brenda asaj që identifikot si “ne” në një grup komuniteti. Sipas Waever-it, kjo nënkupton që siguria shoqërore përcaktohet si aftësi e komunitetit për të mbijetuar brenda kushteve të pranuar për evolucion në një kornizë të modelit tradicional dhe normativ, që e identifikon komunitetin si gjuha, kultura, identiteti kombëtar, që mund të mos perputhen me organizimin apo gjendjen gjeografike territoriale të shtetit. Kur këto komunitete bien ndesh me agjendën e shtetit dhe mbijetesa e tyre është në një gjendje të kërcënuar, atëherë paraqitet një nevojë që brenda sistemit shtetëror të identifikohet një apo më shumë komunitete që mëtojnë të sigurojnë identitetin e tyre shoqëror të identifikimit. (Buzan, Waever dhe Wilde,1998, 120)

Sipas autorëve këtu flitet gjithmonë për identitetin kolektiv të një komuniteti, që nëpërmjet ndërveprimit shoqëror ka arritur deri në një nivel sa të krijojë mekanizma të mjaftueshëm që të politizojë dhe të ndërmarrë masa sigurimi, që nënkupton se bëhet fjalë për një gjendje të formuar të identitetit shoqëror. Kështu, siguria e shtetit mund të kanoset

nga kërcnimet ndaj identitetit të tij, por ajo mund të kanoset edhe nga një kohezion i ulët i brendshëm, si në rastet e shteteve multietnike. Mund të themi se siguria shoqërore i referohet një njësie, që si e tillë ka arritur të identifikojë veten nëpërmjet kulturës, gjuhës dhe normave tjera shoqërore në një njësi kolektive, dhe ajo mund të shfaqet brenda shtetit në disa njësi që jo detyrimisht reflektojnë identitetin institucional shtetëror. (Cavelty dhe Mauer, 2010, 106)

Ndonëse siguria shoqërore fillimisht është paraqitur në kompleksin e studimeve rajonale nga Buzan, ajo rrjedhimisht është edhe e ndryshueshme dhe agjenda e saj është përcaktuar nga aktorë të ndryshëm në vende dhe kohë të ndryshme. Kërcnimet më të theksuara ndahen në tri kategori:

- emigracioni që ka në fokus ndryshimet në saje të lëvizjeve demografike;
- konkurrenca horizontale që u referohet ndryshimeve kulturore që duhet të bëjë një grup për shkak të influencave të tjerëve;
- konkurrenca vertikale ku për shkak të integritimit ose dezintegritimit grupet zgjedhin identitete të ngushta ose të gjera. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 121)

Kërcnimet ndaj shoqërive mund të paraqiten edhe në sektorët e tjerë të identifikuar më herët në analizën e sigurisë së Shkollës së Kopenhagenit, dhe në rastin e studimit do të trajtohen në faza të ndryshme, duke zgjedhur si aktorë referent në nivel njësishtë grupet etnike dhe duke i analizuar çështjet në sektorë të ndryshëm për të cilën agjenda e diskutimit referohet si në rastet ushtarake, politike dhe ekonomike. Kjo për arsye se përkufizimi objektiv ndaj sigurisë shoqërore paraqitet si i vështirë ndaj faktit që grupet shoqërore janë tepër fluide, dhe si të tilla kanë një qasje të natyrshme ndaj ndryshimeve në kohë. Ndonëse kërcnimet ndaj identitetit të komunitetit apo grupit shoqëror në të shumtën e herëve janë në

trajta kulturore, ato paraqiten të rrezikuara edhe në forma ushtarake. Raste të tilla janë ato të spastrimeve etnike, vrasjeve të organizuara ndaj grupeve minoritare brenda shtetit apo dëbimit të dhunshëm. (Collins a.d., 223)

Nga kjo mësojmë se shoqëritë mund të reagojnë në disa mënyra për të siguruar mbijetesën, dhe kjo ndodh kur ekzistojnë mënyra që agjenda e sigurisë të futet në sigurinë shtetërore, por në raste jokohezioni identitar brenda shtetit ato janë të detyruara të zgjedhin edhe mjete joshtetërore për t'u mbrojtur nga kërcnimet. Këto kërcnime, siç e thamë më lart, mund të jenë të natyrës ushtarake, por ato paraqiten edhe në forma joushtarake. Kërcnime të tilla, që fillimisht mund të jenë kulturore, shumë shpejt mund të politizohen dhe të tërheqin nga pas nevojën për zgjidhje. Ky çast mund të ketë edhe agjendë trajtimi brenda institucioneve, por në të njëjtën kohë, nëse nuk trajtohet në mënyrën e dëshiruar, mund të shkaktojë antagonizma të tjerë nga komuniteti tjetër, apo institucionet shtetërore. Masat reaguese mund ta përshkallzojnë çështjen duke krijuar një proces veprimi dhe kundërveprimi. (Collins, f. 228)

Siguria shoqërore është ndoshta më kompleksja nga pesë sektorët e propozuar nga Shkolla e Kopenhagenit, sepse paraqitet si e vështirë në ndarjen e saj nga sektori politik dhe kërcnimet ndaj saj kanë të bëjnë me identitetin dhe ekuilibrin ose mungesën tij të forcat brenda kufijve të një shteti, dhe si të tilla shtetet që përballen me këtë sfidë ku mungon kohezioni, në raste të caktuara edhe mund të mos jenë të përgatitura për t'u përballur me ndryshimet kulturore dhe identitare brenda tyre. Dallimet kulturore që shfaqen si kufij identiteti brenda shtetit nuk janë gjithmonë në kohezion me vetë shtetin. Është e qartë se siguria shoqërore është e lidhur thellësisht me sigurinë politike dhe madje atë ushtarake. Prandaj është e rëndësishme që të studiohet ky sektor, posaçërisht kur paraqiten dilema të

tilla rreth sigurisë, ndonëse është e vështirë të aplikohet, pasi ka të bëjë me kategorinë e kulturës dhe identitetit. (Stone, 2009, 5)

3.2.3 Kompleksi i sigurisë rajonale

Për të pasur një ide më të qartë të konceptit të rajonit, Buzan-i e përkufizon qartë çështjen se çfarë nënkupton rajoni në një koncept sigurie, ku theksohet se rajoni “është një nënsistem domethënës dhe i rëndësishëm i relacioneve të sigurisë që ekziston brenda një numri shtetesh, fati i të cilëve lidhet me afërsinë gjeografike të tyre”. (Buzan, 1991, f. 188)

Ai veçon se një rajon duhet të ketë dy ose më shumë shtete që e përbëjnë, si dhe duhet të jenë në një afërsi gjeografike me njëri-tjetrin. Afërsia gjeografike e shteteve duhet të krijojë një varësi të tillë, saqë pasojat e rreziqeve të jenë më të ndjeshme në nivel rajonal sesa në atë global. Duke qenë e tillë, siguria e një shteti ka pasoja më të drejtpërdrejta nga një destabilizim i shtetit në rajon, ose politikën e tij mund të ndikojnë më drejtpërdrejtë se zhvillimet e tjera në nivel global që mund të lidhen me atë shtet. Për më tepër ai e zgjeron nivelin e varësisë deri në shkallën ku shtetet në rajon janë të lidhur aq shumë, sa siguria parësore e një shteti të mos konsiderohet e ndarë nga tjetri. (Buzan, 1991, f. 190)

Intensiteti i çështjeve të sigurisë është shumë i lartë nisur nga premisa gjeografike dhe lokacioni ku ndodhet shteti. Ndonëse çështjet globale mund të kenë një efekt, ato përsëri ngelen më të buta se çështjet që janë të lidhura mes shteteve që i takojnë një rajoni. Kjo ka të bëjë edhe me analizën e niveleve, që e veçon dhe e thekson në zgjerimin e analizës së sigurisë në drejtim vertikal, duke i zgjeruar nivelet e analizës nga ato tradicionale, që njiheshin deri më sot, drejt analizës së sigurisë ndërkombëtare. Buzan-i i ndan ato në pesë nivele, duke i shtuar niveleve të analizës edhe atë ndërmjet aktorit shtet

dhe sistemit anarkik ndërkombëtar, i apostrofuat si nënsistemi ndërkombëtar i marrëdhënieve të sigurisë në një nivel më të vogël se ai global, dhe shërben si urë lidhëse ndërmjet dy nivele të përmendura. (Buzan, Waever, dhe Wilde, 1998, f. 6)

Një theks i veçantë i pozitës gjeografike normalisht ka të bëjë me faktin se shtetet në raste të tilla kanë mundësi shkëmbimesh shumë më lehtë dhe më shpejt ndërmjet tyre sesa me një shtet apo komb që është në një distancë më të largët. Ndërveprime të tilla krijojnë mundësi shkëmbimesh në shumë fusha, ndonëse qasja tradicionale që ka shqyrtuar aspekte të sigurisë është fokusuar vetëm në ato ushtarake dhe politike. Por, një afërsi e tillë gjeografike detyrimisht që prodhon edhe shkëmbime që zgjaten në fusha të tjera, që mund të kenë implikime në çështje të sigurisë. Me zgjerimin e fushave të sigurisë zgjerohet edhe koncepti i përkufizimit të çështjeve të sigurisë, që tashmë ndërlidhin jo vetëm aktorin shtet, por edhe “njësitë e tjera të rëndësishme, që në procesin e sigurimit dhe desigurimit janë aq shumë të lidhura, sa që njëra nuk mund të analizohet dhe zgjidhet e veçuar nga tjetra”. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, f. 201)

Në vazhën e një trajtimi të tillë, në kushte të ndryshimeve historike në qasjet mbi sigurinë kemi edhe përkufizimin dhe klasifikimin e ndërveprimeve rajonale bazuar në intensitetin e tyre, homogjene dhe heterogjene. Një zhvendosje e sfidave të sigurisë në një ambient të pas Luftës së Ftohtë hapi mundësinë e zgjerimit të shkëmbimeve, tanimë jo vetëm përmes shteteve, por edhe përmes njësive të tjera që akumulojnë mjaftueshëm fuqi për të ndërmarrë veprime në sektorë të ndryshëm jashtë atyre tradicionalë, që në veçanti ishin standarde në konceptet tradicionale të sigurisë. Tashmë, me paraqitjen e sfidave të reja për shtetet, normalisht edhe me zgjerimin e koncepteve të sigurisë shihet se këto veprime mund të jenë të sferave politike, ekonomike, kulturore apo edhe sferave të tjera, që

në një moment të caktuar mund të kenë implikime sigurie. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, f. 16-17)

E gjithë kjo dinamikë veprimesh rajonale zhvillon edhe një koncept tjetër mjaft të rëndësishëm në kuptimin e kompleksit rajonal të sigurisë. Ndonëse shtetet mund të jenë në një rajon dhe të kenë ndërvaresi në çështje të sigurisë, kjo ndërvaresi ndërtohet ndërmjet tyre bazuar në qasjen paqësore ose armiqësore. Në bazë të predizpozitave pozitive apo atyre negative është edhe shfaqja e rajonit në nivel global. Një qasje e tillë e shtjellon më thelbësisht kuptimin e dy nivele të tjera nga një pikënisje e analizës në nivelin rajonal. Paraqitja e shteteve nëpërmjet rajonit që i takon në arenën e zgjeruar globale fillon nga ndërveprimet që prodhon çdo rajon më vete. Këto ndërveprime rajonale shpalosen nëpërmjet një spektri të gjerë aspektesh të përvojës historike, politikës shtetërore dhe ideologjisë së sistemit, deri te gjendja materiale e tyre. Një qasje e tillë mund të na e japë më lehtë kuptimin mbi implikimet e fuqive të mëdha në rajon, por për më tepër ajo mund të sqarojë edhe veprimet e shteteve në nivel lokal dhe kombëtar. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 45)

Perceptimet armiqësore kryesisht prodhojnë edhe rajone që mund të kenë projekte që ndjellin frikë dhe distancim në marrëdhëniet e shteteve brenda rajonit. Këto raste lidhen më shumë me qasjet tradicionale të sigurisë dhe sistemeve të kaluara, siç është ai i ekuilibrit të fuqive etj. Një rajon i tillë, në përparësimin e politikave të sigurisë ka logjikën e dyshimit, mosbesimit, përplasjes dhe konfliktit. Sipas autorëve të teorisë ka disa rajone të kësaj natyre, dhe ata prodhojnë një gjendje konfliktuale bazuar në perceptimet e shteteve mes njëri-tjetrit. Këtu veçohen dy segmente të rëndësishëm të lidhjes së nivelit rajonal me atë global, sepse nga njëra anë përcaktohet karakteri i shtetit – e bashkë me të

edhe ai i rajonit – dhe, nga ana tjetër theksohet edhe ndërhyrja dhe depërtimi i forcave me sfond dhe kapacitet global me propozime ose qëndrime. (Buzan, 1991, f. 189)

Ndërsa rajonet që karakterizohen me ndërveprime perceptimesh paqësore, varësia e tyre kryesisht përkufizohet me bashkëpunimin e ndërsjellë mes shteteve, që si rrjedhojë prodhon stabilitet rajonal dhe një masë të zhvilluar bashkëpunimi. Kjo qasje i lidh shtetet deri në pikën sa trajektorja e bashkëpunimit pozitiv ngrihet në sekuenca ku varësia e shteteve në rajon krijon miqësi, dhe me raste edhe aleanca, që në vetvete përfshijnë mbështetje nga rreziqet e mundshme dhe përkrahje. Një mënyrë e tillë zhvillimore tregon se kompleksitetet rajonale të sigurisë ndryshojnë nga njëri-tjetri në rrafsh global në varësi të ambientit dhe konstelacioneve historike, ekonomike e kështu me radhë. Pra ata janë të ndryshueshëm edhe përbrenda tyre, saqë në rast të qasjes miqësore ose përfshirjes së aktorëve të tjerë mund të krijojnë një kolektivitet sigurie. E gjithë kjo në varësi të dinamikës së zhvillimit të kontekstit dhe përbërjes së shteteve brenda rajonit dhe ndërveprimeve në nivele të ndryshme, në varësi të dendësisë së problematikave lokale në ato ndërkombëtare dhe anasjelltas. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 46)

Një qasje e tillë e kompleksitetit të sigurisë rajonale shërben për të ndjekur ndryshimet dhe gjendjen në nivel rajonal, dhe se si këto të fundit mund të implikojnë aktorët në çështje të sigurisë që lidhen me ta. Kjo sepse kompleksitetet e sigurisë kanë një strukturë të qëndrueshme gjeografike, që në thelb edhe mund të jenë të ndryshueshëm bazuar në një gjendje anarkike që mund të ekzistojë brenda tyre. Ndërveprimet ndërmjet aktorëve krijojnë një konstrukt social që përbën edhe dinamikën e shpërndarjes dhe gjendjes së aktorëve brenda tij. Në raste të veçanta, kur aktorët në bazë të interesave të tyre e përkufizojnë si një problem të rëndësishëm për të ndërmarrë veprime të përbashkëta, kjo mund të gjenerojë një

zhvendosje, dhe ndërveprimi i tyre mund të krijojë një konstrukt rajonal. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 52)

Mënyra e ndryshimit dhe evoluimit të kompleksit të sigurisë rajonale mund të ndodhë në rastin kur njësitë që bëjnë pjesë kanë një influencë më të gjerë nga transformimet që mund të ndodhin nga jashtë ose nga faktorë që kanë një impakt në rajon. Një rast i tillë është edhe rajoni i Europës Juglindore ose Ballkani, ndonëse autorët e krijimit të konceptit të kompleksit të sigurisë rajonale nuk i atribuojnë të gjitha karakteristikat e rajonit, që të formojë një kompleks të pavarur rajonal me ndërveprime që gjenerojnë vlera dhe veprime krejtësisht të pavarura nga aktorë të jashtëm. Për këtë arsye, ai konsiderohet një nënkompleks rajonal, duke pasur parasysh se tani ka filluar një proces ndryshimi dhe evoluimi nga çfarë paraqitej në fazat fillestare gjatë dhe pas luftrave të mëdha dhe menjëherë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 378)

Në bazë të këtij transformimi të nënrajonit europiano-juglindor dhe duke u bazuar te karakteristikat ku përqendrohet evoluimi me një qasje armiqësie, në një rajon ku miqësia dhe bashkëpunimi krijojnë ndërvarësi, ndryshe mund të karakterizohet edhe si komuniteti plural i sigurisë. Ky koncept paraqitet i rëndësishëm për punimin tonë sepse ai i jep një kuptim prirjeve për integrim dhe bashkëpunim rajonal thuajse të gjitha shteteve në rajon. Integrimi në institucionet europiane nënkupton edhe transformimin e rajonit të Ballkanit nga një nënkompleks rajonal në një pjesë të barabartë të një komuniteti sigurie me një stad të lartë zhvillimi. Së këndejmi shfaqet e nevojshme një qasje dhe një shpjegim i shkurtër mbi komunitetin e sigurisë. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 56)

Nisur nga kjo mund të theksojmë se kocepti i sigurisë së përbashkët në bazë të ndërveprimeve të një grupi subjektesh, të cilët veprojnë bashkarisht dhe integrohen, sa mes

tyre ka bindje të ndërsjellë se anëtarët e njëres apo tjetres shoqëri nuk do t'i imponojnë interesat e tyre me dhunë, por në mënyra të tjera. Koncepti i komunitetit të sigurisë nënkupton se në arenën ndërkombëtare shtetet mund të ndajnë vlera, norma dhe simbole me të cilat marrin identitetin e tyre të veçantë shoqëror. Ky qëndrim për përkufizimin e konceptit të sigurisë së përbashkët lidhet me atributet e veprimit dhe varësisë së cekur më parë në teorinë e kompleksit të sigurisë rajonale, ku shtetet janë të lidhur nëpërmjet ndërveprimeve të ndryshme në fusha të panumërta, duke përfshirë sigurinë, që kanë dhe mund të ndajnë interesa të përbashkëta për të ndërtuar besimin, ose në të kundërtën do ketë frikë dhe mosbesim të ndërsjellë. (Deutsch, 1957)

Ashtu si te qasja që paraqet Buzan-i për krijimin e komplekseve të sigurisë, që për nevojat e punimit duhet theksuar se edhe komunitetet e sigurisë mund të karakterizohen me paraqitjen dhe ndërveprimet që i japin përparësi politikave sigurizuese, ata mund të jenë në gjendje të brendshme me një nivel zhvillimi të qëndrueshëm dhe në bazë të kësaj paraqiten veprime me njësi të tjera. Një paraqitje tjetër e llojit të komunitetit të sigurisë mund të jetë plurale, kur komuniteti i sigurisë përbëhet nga shtete që shfaqen formalisht në arenën ndërkombëtare si të pavarur dhe ndërveprojnë bashkrisht për arritjen e sigurisë së plotë. (Deutsch, 1957)

Koncepti i sigurisë së përbashkët mund të arrihet në mënyra të ndryshme, por më e theksuara nga Deutsch-i ngelet ajo e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jo nëpërmjet forcës, por në mënyra të tjera, që e pëjashtojnë dhunën. Këto mënyra nënkuptojnë gjetjen e një trajte institucionale të përbashkët, ku do artikuloreshin aspiratat dhe do menjanohej frika e ndërsjellë. Normalisht shtetet duhet të ndërmarrin hapa konkretë në krijimin dhe institucionalizimin e procedurave, ku mund të artikulohen interesat e tyre.

Institucionalizimi në këtë rast shihet si një metodë ku frika dhe kërcënimi eliminohen nëpërmjet komunikimit, dhe kështu shmanget edhe përdorimi i forces. (Deutsch, 1957)

Në fakt, kjo qasje kërkon një analizë të detajuar të aspekteve integruese dhe teorive mbi integrimin, në mënyrë që ta kuptojmë qartë mënjanimin e dhunës në arritjen e sigurisë së përbashkët. Teoritë e integritit merren me shtjellimin fushës së debatit shkencor në lidhje me procesin dhe rezultatin e integritit, ndërsa qasjet teorike përfshijnë mënyrat individuale të dëgjimit dhe të kuptuarit e integritit, që vetëm disa syresh mund të quhen teori të plota të integritit. Teoria e integritit siguron një bazë për ta kuptuar më mirë procesin e kyçjes së institucioneve kombëtare te institucionet zyrtare për shtete të caktuara, që kanë marrë drejtimin e një organizmi të përbashkët. Në bazë të këtyre dispozitave mund të kuptojmë se si institucione të tilla kombëtare u adoptuan dhe u ngritën në funksion të një përputhjeje me dispozitat ekzistuese dhe marrëveshjeve të krijuara rishtas për futje të plotë në BE, si një institucion mbikombëtar.

3.3 Përmbledhje mbi dinamikën e studimit dhe analizës

Në këtë kapitull paraqitëm teoritë bashkëkohore mbi sigurinë dhe si reflektojnë ato mbi të. Janë teoritë tradicionale që përqendrohen tek aspekti ushtarak, fuqia dhe paqja, dhe shkollat më bashkëkohore që veçojnë me qasjet e tyre mbi kompleksin e ndërveprimeve shoqërore. Nëse për realistët shteti si paraqitje e natyrës njerzore është gjithçka kur flitet mbi sigurinë, për konstruktivistët është rezultat i përvojës historike mbi të cilën reagon shoqëria.

Arsyeja e një prezantimi për konstruktivizmin dhe shkollën e kopenhagës lidhet me synimin e punimit, që analizën e mëtejshme ta mbështesë mbi teoritë e Shkollës së

Kopenhagenit për sigurinë, si qasje me një aplikim të zgjeruar dhe të thelluar mbi analizën e saj.

Synimi i aplikimit të kësaj qasjeje për analizën tonë është që të parqitet një pasqyrë më e zgjeruar dhe gjithëpërfshirëse gjatë identifikimit të dilemave dhe mundësive të sigurisë së Maqedonisë. Duke aplikuar këtë qasje do kemi mundësinë që të shtjellojmë dinamikën komplekse të zhvillimeve të sigurisë në Maqedoni nga një këndvështrim që mundëson një analizë mbi shumë fusha dhe impaktin që ato kanë mbi sigurinë e shoqërive dhe shteteve në një kontekst të zgjeruar, kjo sepse si çdo reflektim mbi sigurinë dallon nga njëri shtet te tjetri, ose nga një rajon te tjetri. Në kushte të tilla është e pritshme që konsideratat mbi sigurinë prodhojnë argumente dhe kundërargumente. Prandaj, për të pasur konsideratë ndaj kësaj kemi parasysh ambientin e sigurisë që rethon objektin referues si dhe çfarë sistemi politik e legjitimon atë. Kjo bëhet edhe më e vlefshme në kuptimin më të qartë të dinamikës së zbardhjes së këtyre sfidave nga këndvështrime të ndryshme, duke patur në konsideratë kompleksitetin me të cilën ballafaqohet shteti si një tërësi, por edhe shoqëritë që e përbëjnë atë në veçanti.

Në këtë drejtim punimi analizën e sajë në vazhdim do ta fokusojë në tre nivele duke filluar në nivel të shtetit, me një analizë makro në nivel të kompleksit rajonal dhe vazhduar më tutje me një qasje reth sigurisë shoqërore ku objekt referues paraqet sigurinë shoqërore. Duke u nisur nga fakti se qasja tradicionale e shohin aktorin shtet si objektin kryesorë referues mbi sigurinë e sajë analiza fokusohet tek zgjidhja e çështjeve të sigurisë me masa ushtarake dhe forca si elemente kryesore në arritjen e një objektivi sigurie. Por disa nga sfidat në një gjendje të ndryshueshme sigurie kishin edhe trajta tjera veç atyre

ushtarake që si rrjedhojë paraqitet nevoja e një analize ndryshe si në qasjen rajonale të kushteve të sigurisë ashtu edhe në gjendjen e brendshme të sigurisë që shteti bazohet.

Ndonëse analiza në nivele paraqitet edhe tek qasjet tradicionale ato nuk paraqiten me një kornizë të analizës në rafshin rajonal apo edhe atë të sigurisë shoqërore. Qasja e Shkollës së Kopenhagenit në këtë drejtim ka një segemnt neorealist, sepse e bazon objektin e saj referues në shkallë/nivele njësish dhe këtu shteti paraqitet si ndërlidhës në mes analizës në nivel rajonal dhe asaj shoqërore. Pëveç analizës mbi rajonin dhe ndëveprimet e shteteve që përbëjnë rajonin që si pasojë krijojnë ndërvarësi sigurie mes tyre ajo në të njëjtën kohë e pozicionon shoqërinë në objekt referues jo në shkallën e individit, por të një komunitetit të organizuar deri në masën që të artikulojë qëndrime për kanosjet që i paraqiten identitetit të saj dhe njëkohësisht është në një nivel organizativ që të ndërmarrë masa dhe të mobilizojë veprime në mbrojtje të saj.

Pra, një ndërthurje e tillë analize në nivele dhe sektorë na jep shansin që punimi të ketë një qasje më të zgjeruar dhe më të thellë të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë. E gjithë kjo në funksion të një analize më kuptimplote të dinamikës së brendshme të shtetit, dhe se si mund të reflektojnë në përcaktimin e përparësive të politikave të sigursë dhe atyre të jashtme.

Duhet theksuar që në fillim se qasje e Shkollës së Kopenhagenit mundëson që nëpërmjet nivelit të analizës të zbardhen marrëdhëniet që kanë të bëjnë me shoqërinë si një komunitet me identitet të formësuar dhe me kapacitete të mjaftueshme për të marrë masa të jashtëzakonshme mbrojtjeje nga kanosjet ndaj identitetit të saj. Nisur nga kjo duhet theksuar se me zgjerimin e analizës së sigurisë veçohenn lidhjet e rëndësishme mes sigurisë shoqërore dhe identitetit. Nëse shteti kujdeset për kërcënimet që i adresohen sovranitetit,

komunitetet shoqërore i hetojnë kërcënimet ndaj mbijetesës së identitetit të komunitetit të organizuar politikisht dhe nevoja e tyre për të gjetur mënyra mbrojtjeje rritet. Një qasje e tillë na lejon të analizojmë aktin e fjalimit që referohet ndaj komunitetit etnik dhe çfarë shpaloset si kërcënim mbi identitetin e saj. Një analizë e tillë është e rëndësishme ngaqë punimi nisat me objekt referues të grupet shoqërore që kanë një rol të rëndësishëm, nëse aktorët sigurizues i kuptojnë drejtë dinamikën e ndërveprimeve shoqërore dhe se si mund të bëhen kërcënues. Kjo mundëson edhe një qasje më gjithëpërfshirëse për reagimet dhe trajtimin e çështjes së shtruar, për një kutprim më adekuat për kërcënimet e perceptuara.

Nëpërmjet aktorit referues, në këtë rast komunitetit etnik në Maqedoni, ky studim synon të zbulojë dinamikën e shqetësimeve që ata ngritën në lidhje me kërcënimet ndaj mbijetesës së karakterit të saj brenda kufijve normalë për rigjenerimin e normave tradicionale të gjuhës, kulturës organizimit dhe identitetit. Kjo do të bëhet përmes një analize mbi ngjarjet që u paraqitën qysh prej pavarësisë së Maqedonisë e deri te një fazë më e tensionuar veprimesh brenda shtetit.

Paraqitja i këtyre ngjarjeve do të jetë nga një perspektive e përgjithshme që përfshin komunitetin etnik shqiptar në Maqedoni, dhe cilat ishin ato kërcënime që rrezikonin kushtet themelore të rigjenerimit. Rastet e prezantuara do të mbulojnë sfera të rëndësishme që janë të lidhura ngushtë me aspektin e ekzistencës dhe mbijetesës së komunitetit të mirëformuar. Kërcënimet lidhen me kulturën, gjuhën dhe organizimin e natyrshëm komunitar. Vlen të përmendet një shembull mbi zhvillimet kryesore politike që ka të bëjë me dilemat e sigurisë identitare për komunitetin shqiptar, duke iu referuar mundësisë së shkollimit apo vlerësimit kulturor.

Këtu duhet veçuar debati mbi influencën e identitetit mbi politikat institucionale të shtetit. Siç u përmend edhe më lart, nga një qasje konstruktiviste ndaj identitetit u vu re se përvoja dhe konteksti kulturor ndihmon në përcaktimin e përmbajtjes së interesave të një shteti dhe se si sillet ai në politikën ndërkombëtare apo edhe atë lokale. Kjo ka një rëndësi së veçantë duke u nisur nga fakti se punimi synon që nëpërmjet një analize të tillë të zbulojë arsyet e një sjelljeje që nuk përkon me një komunitet kur bëhet fjalë për qasjen që mund të ketë shteti në lidhje me gjuhën, kulturën apo identitetin a asaj shoqërie. Kështu dalin në pah edhe kërkesat e komunitetit shqiptar për një qasje adekuate ndaj postulateve kushtetuese ku theksohet karakteri i shtetit.

Siç u përmend në seksionin paraardhës, se aspektet kulturore të formulimit të politikave mundësojnë institucionalizimin e identitetit të shtetit, qeverisë dhe aktorëve të tjerë politikë, dhe rrjedhimisht kanë një rëndësi për rezultatet që mund të kenë në përpilimin e përparësive të sigurisë kombëtare. Kështu, normativat kulturore të institucioneve shtetërore jo domosdoshmërisht reflektojnë të gjitha perceptimet e komunitetit të tij në raste të veçanta, siç janë shtetet multietnike si Maqedonia dhe rrjedhimisht edhe aplikim masash të ndryshme.

Në veçanti kjo do shpërfaqë edhe dilemat mbi sigurinë shoqërore në punim, që si në rastin e konceptit tradicional mbi dilemën e sigurisë ka si referencë gjendjen kur dy shoqëri që veprojnë njëra pranë tjetrës krijojnë perceptime të gabuara ndaj çështjeve respektive, gjë që mund të shkaktojë artikulimin e frikës dhe pasigurinë nga komuniteti tjetër, e si pasojë gjeneron dobësimin ose forcimin e qëndrimeve të komunitetit tjetër si formë kundërreagimi.

Një rast i veçantë i dilemës së sigurisë shoqërore në Maqedoni mund të theksohet aktiviteti dhe zhvillimet mbi arsimin e komunitetit shqiptar, dhe dy reagime të ndryshme institucionale për të njëjtën çështje. Këto segmente janë të rëndësishëm në nxjerrjen e mësimëve kur bëhen analiza që kanë të bëjnë me sigurinë dhe se si përdoren mjetet siguruese në raste dhe ambiente të caktuara, që në rastin e qasjeve të zgjeruara të Shkollës së Kopenhagenit mbase një kohezion analitik i sektorëve të ndryshëm edhe do të nxirrte rekomandime adekuate për aktorët sigurizues apo për politikbërësit.

Më tej, me anë të kësaj teorie do synojmë të spikasim edhe ndikimin e këtyre çështjeve mbi impaktin dhe influencën e tyre në formësimin e identitetit institucional, dhe a u përgjigjet nevojave të grupeve shoqërore dhe sigurisë së tyre. A ndikon formësimi njëpërmasor i masave të rregullta të sigurisë në destabilitetin dhe dobësimin e shtetit dhe institucioneve të tij, dhe si reflektohen këto në pasigurinë e grupit apo grupeve etnike në Maqedoni?

Për më tepër, studimi synon të inkorporohen disa aspekte që në vetvete ndërthurin segmente që kanë të bëjnë me analizën e sigurisë së Maqedonisë në fusha e sektorë të ndryshëm, për të kuptuar qasjen që kanë grupet etnike në Maqedoni ndaj përpilimit të Politikave të Sigurisë Shtetërore. Me një qasje të tillë gjithpërfshirëse do të analizojmë efektin që kanë politikat e sigurisë shtetërore mbi grupet etnike, dhe a janë ato të justifikuara në arritjen e qëllimit? A ndikojnë ato në thellimin e ngërçeve politike apo thjesht shkaktojnë agravime? Si perceptohen dhe shpjegohen për audiencat përkatëse politikat që ndërmerren nga aktorët politikë dhe në çfarë mase përbëjnë kanosje për ekzistencën e komuniteteve?

KAPITULLI IV: KONTEKSTI HISTORIK DHE PAMVARËSIA

4.1 Zhvillimet historike dhe gjendja e ndryshueshme e sigurisë

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjen e Bllokut Ushtarak të Lindjes nisën të paraqiteshin kontekste të reja mbi sigurinë. Këto ndryshime sollën një diskurs të ri mbi studimet e sigurisë dhe kryesisht në lidhje me çështjen se çfarë përbën kërcnim për sigurinë. Ky diskurs i ri ishte rezlutat i ndryshimit të dinamikës së rreziqeve që vinin në forma të tjera ndaj shtetit si një objekt referues. Me procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë filloi një sfidë për konceptet mbi sigurinë, që ishte dominante për një kohë të gjatë, siç është rasti me qasjet tradicionale mbi sigurinë, të fokusuara mbi shtetin. Një zhvendosje e tillë nga qasjet tradicionale mbi sigurinë hapi një gamë të gjërë përvojash dhe sferash, që nuk ishin të ndjekura nga një optikë e tillë deri më sot. Konfliktet e brendshme tashmë në ish-Jugosllavi nxorën në pah problemet dhe sfidat që mund të kishin shtetet edhe nga brenda, si dhe kërcnime të tjera që nuk kanë formën e kërcnimeve ushtarake.

Studimet tradicionale megjithatë kanë lënë pas dore kryesisht përmasat brenda-shtetërore dhe etnike të ndryshimit të regjimit, ose edhe konsolidimin shtetëror në një mjedis multietnik. Në fakt, qasjet tradicionale e shohin aktorin shtet si objektin e vetëm referues kur kemi të bëjmë me sigurinë e shtetit, dhe kështu zgjidhja e problemeve të sigurisë në këtë kontekst nënkupton mbështetjen e masat ushtarake dhe të forca në arritjen e objektivit të eliminimit të rreziqeve. Paraqitja e rreziqeve për shtetet në masa të tilla analizohet nëpërmjet përmasës shtetërore në një univers ndërmjet shteteve. Çdo rrezik që

mund të merret në konsideratë në bazë të kësaj qasjeje ka të bëjë vetëm me kërcnimet ndaj shtetit, territorit të tij dhe rendit kushtetues. Një perceptim i këtyre rreziqeve mjafton për të nismuar masa ushtarake dhe forcën për asgjësimin tyre. Këto masa mbështeten te mbrojtja e shtetit në një sistem shtetesh ku në raste të caktuara masat aplikohen jo vetëm ndaj një shteti tjetër por edhe brenda vetë shtetit. (Collins, fv. 27-28)

Në rastin konkret, shkollat tradicionale e përqendrojnë analizën mbi sigurinë e tek aspekti i krijimit të kushteve të sigurisë për shtetin dhe mbi shtetin në relacion me shtetet e tjera. Një gjendje e tillë vazhdon të trajtohet në një masë të madhe nga shtete të ndryshme në përparësimin e politikave të sigurisë dhe të masave që ndërmarren në përmbushjen e këtij objekti. Një qasje e tillë nuk ndryshon kur vjen puna në pikën se si perceptohet rreziku nga jashtë apo edhe nga brenda, ku të njëjtën qasje aplikon edhe në politikat e sigurisë së brendshme në kuadër të territorit mbi të cilin ushtron autoritet. Përcaktimi i përparësive të politikës së sigurisë në këtë kontekst shqyrton mundësinë e maksimalizimit të fuqisë dhe ushtrimit të saj mbi territorin në fjalë, dhe kështu, në raste të caktuara nuk trajton tema bashkëkohore që paraqiten si kërcime në një kontekst të ndryshueshëm të sigurisë. (Rosamond, 2000)

Duke u ndalur te ndryshimet që u paraqitën në skenën ndërkombëtare pas Luftës së Ftohtë, u përmend se ndryshimet që solli përfundimi i kësaj lufte ngriti një sërë sfidash dhe pyetjesh që kanë të bëjnë me ekzistencën e shteteve. Shkolla e Kopenhagenit bazohet thellësisht mbi qasjet tradicionale kur bie fjala për aspektet ushtarake si përcaktues kryesorë të sigurisë së shtetit dhe mbi shtetin. Por ajo shkon më tej duke inkorporuar elemente shtesë që paraqiten si të një rëndësie të veçantë për shtetin, dhe në raste të caktuara përputhen me

një qasje më të zgjeruar konstruktiviste që ka të bëjë me natyrën e rralacioneve që ndërton shteti si brenda ashtu edhe jashtë dhe rethit të tij. (Collins, f. 215)

Pavarësisht shtigjeve të ndryshme të ndërtimit të shtetit dhe të shtet-formimit që kanë ndërmarrë në vitet në vazhdim pas Luftës së Ftohtë shtetet e sapokrijuara apo ato në tranzicion, ata përsëri kanë qenë të prirur për t'u angazhuar në një formë nacionalizmi, i cili ka kërkuar të ndryshojë gjendjen e grupit dominues etnik duke përdorur mekanizmat institucionalë të shtetit. Kjo prirje drejt privilegjimit etnik shpeshherë ka treguar një preferencë të dukshme për homogjenizimin dhe diskriminimin mbi procesin e shtet-formimit. Në të shumtën e rasteve kjo ka ndodhur në mënyrë të heshtur, duke miratuar politika diskriminuese ndaj grupeve më të vogla dhe duke çuar në fortifikimin e ngadaltë dhe në favorizimin e grupeve më të mëdha në hierarkinë strukturore të shtetit. (Brubaker, 1996)

Si rrjedhojë e gjithë kësaj janë prodhuar perceptime të ndryshme dhe mundësi për përplasje, ose edhe vetë konflikti ndëretnik, dukuri këto të cilat kanë zgjatur duke prodhuar dhunë dhe shkatërrim të gjërë. Kurse disa prej këtyre dukurive janë menaxhuar me sukses nga strategjitë e ndryshme të akomodimit, por edhe të ndërhyrjes. Përpjekja për të kapur elemente të tillë në diskursin e sigurisë së zgjeruar është rikonceptualizimi i propozuar nga Shkolla e Kopenhagenit dhe shtrirja e konceptit të sigurisë në mënyrë që të përfshijë një gamë shumë të gjerë shqetësimesh dhe çështjesh, që në veçanti theksuan lidhjen thelbësore midis sigurisë dhe identitetit.

Siguria pas Luftës së Ftohtë detyrohet nga kërcënimet e perceptuara për identitetin e komuniteteve të veçanta politike dhe nga kërkimi i vazhdueshëm i këtyre komuniteteve për mënyrat e ruajtjes dhe shprehjes së identitetit të tyre. Futja e sigurisë shoqërore si një objekt

i ri referent për të siguruar nga pikëpamja e studimeve të sigurisë, jep një mundësi analize dhe diskursi për identitetet e kërcënuara nga përdorimi i tepruar i forcës nga institucionet ose vetë shteti, në mënyrë që të gjejnë rrugëdalje që të mund të shprehin dhe të mbrojnë veten. (Agestam dhe Hyde-Price, 2006, f. 6)

Në rethana të këtilla gjeopolitike duhet edhe rasti i analizës së punimit, ngaqë ajo i nënshtrohet qasjes së zgjeruar në analizën e paradigmave të sigurisë së Maqedonisë. Në këtë drejtim paraqitet pasqyra e zhvillimeve historike të shtetformimit të Maqedonisë për të analizuar diskursin politik që u shfaq më vonë dhe se si këto zhvillime u shndërruan në sfida për vetë sigurinë e shtetit. Që të vijmë deri te një analizë më e detajuar për çështjet që përbëjnë rast sigurie për Maqedoninë, do hedhim një vështrim narrativ mbi zhvillimet kryesore që sollën pavarësinë. Cilët ishin instrumentet e formësimit të identitetit të këtij shteti dhe si artikuloheshin nga elita politike e kohës? Më tutje do përshkruhet forma e organizimit politik dhe cilat grupe etnike paraqitën interes në formësimin e identitetit politik të shtetit. Kështu do mund të shohim se si perceptime të caktuara të elitës politike maqedonase ndaj sigurisë së saj nga jashtë për aspekte të identitetit, kanë aplikuar politika të brendshme që më vonë kanë marginalizuar dhe me raste shtypur me forcë kërkesat e komuniteteve të tjera, konkretisht kërkesat e komunitetit shqiptar.

3.1 Zhvillimet deri te shpallja e pavarësisë

Për të pasur një kuptim më të qartë për sifdat e sigurisë së Maqedonisë është e domosdoshme një paraqitje e shkurtër e ngjarjeve me të rëndësishme të historikut të saj që nga fillimi e paraqitjes si çështje në sfondin rajonal e deri te konsolidimi si shtet i pavarur. Kjo është e rëndësishme për të kuptuar debatin mbi të cilën janë formuluar çështjet e

sigurisë së Maqedonisë dhe se si kanë reflektuar mbi perceptimet e sigurisë së saj. Cili është konteksti në të cilën janë hapur debatet gjatë periudhës së shtetformimit që nga momenti i shpalljes së pavarisë dhe si reflektonin këto debate jo vetëm nga pikëpamja e pavarësimit nga Federata Jugosllave, por edhe nga një sfond më i gjerë rajonal.

Normalisht që këto debate në përpjekje të pavarësisë reflektonin edhe në aspektin e brendshëm të diskursit të sigurisë dhe pjesëmarrjes adekuate të popullsisë dhe grupeve të ndryshme të interesuara në formulim të politikave për shtetformimin dhe përparësimin e çështjeve që përbëjnë kërcnim për shtetin. Një dinamikë e tillë zhvillimesh përgjatë historisë do të na japë mundësinë të kuptojmë më gjerë dhe në nivele të ndryshme aspektet e formulimit të politikave të sigurisë për periudhën që synon të analizojë ky studim.

Për të prezantuar historikun e Maqedonisë së pavarur në fillim duhet theksuar se ajo karakterizohet me çështje të debatueshme si në aspektin territorial ashtu dhe në atë identitar. Në gjenezë të kësajë qëndron fakti se në historinë bashkohore deri në pavarësinë e Republikës së Maqedonisë, ajo figuronë në raste si territor dhe identitet që gjendet dhe aludohet nga një shtet tjetër. Kjo paraqitje ka të bëjë me pretendimet për kontroll si të territorit të saj ashtu edhe të popullsisë që jetonte në të. Këto pretendime për kontroll kanë krijuar një ombrellë politike, sigurie dhe shoqërore rreth asaj që lidhet me çështjen e Maqedonisë në përgjithësi. (Danforth, 1995, f. 19)

Maqedonia si një çështje sigurie nuk ka qenë një element i spikatur në agjendat rajonale dhe as në ato ndërkombëtare. Gjatë Kongresit të Berlinit, i mbajtur në vitin 1878 nuk figuronte në agjendën e bisedimeve. Si e tillë ajo nuk figuronte as në agjendën e aktorëve rajonalë para dhe gjatë kësaj periudhe, ku mund të evidentohet ndonjë sekuencë e rëndësishme historike. Pas këtij kongresi ajo filloi të shtrohet si një çështje e interesit të

mundshëm kryesisht për aktorët rajonalë. Kjo u bë edhe më interesante për faktin se Perandoria Osmane filloi të dobësohej në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik, ku hapësira gjeografike e njohur si Maqedoni shtrihej pa ndonjë konfiguracion institucional qoftë edhe brenda shteteve ekzistuese në formën e ndonjë autonomie apo shprehjeje institucionale. Ndonëse ajo ekzistonte si nocion gjeografik, një ndër kushtet për trajtimin adekuat të asaj kohe ishte se ajo nuk përmbushte kriteret e shprehjes së ndonjë kërkesë për ushtrim të legjitimitetit. (International Crisis Group, 2001)

Megjithëse aspiratat e aktorëve rajonalë nuk ishin shfaqur haptas, aspirata për kontroll të mundshëm ishte mëse e pranishme, edhe pse territori nuk ishte i përcaktuar qartë dhe zona e influencës nuk mund të përcaktohej. Një qasje më e qartë territoriale e pretendentëve nisi të shfaqej para dhe gjatë luftimeve ballkanike, kur Perandoria Osmane filloi të largohej nga kontrolli i kësaj zone. Aktorët pretendentë për vendosjen e kontrollit filluan të shfaqin interesin e tyre të hapur – deri në përplasje – për influencë dhe kontroll mbi këtë zonë. Në sajë të këtyre zhvillimeve, si ngjarje që kulmuan në vazhdimësi, veç të tjerash kemi edhe përdormimin e forcës dhe përplasjeve që njihen si luftat ballkanike, në vitet 1912 dhe 1913. (Danforth, 1995)

Përfundimi i luftimeve ballkanike nxjerr për të parën herë formalizimin e një nocioni bashkëkohor për një Maqedoni gjeografike në sajë të aspiratave që shfaqën rishtazi shtetet pretendente për kontrollin e saj. Si rezultat i një marrëveshje të nënshkruar në Bukuresht në vitin 1913, që rezultoi me mbarimin e luftimeve ballkanike, kemi edhe ndarjen e territorit gjeografik të Maqedonisë mes Bullgarisë, Greqisë dhe Serbisë. (Danforth, 1995)

Vështirësitë për kontroll të plotë të këtij territori paraqiten për faktin se territoret e synuara për kontroll kishin një popullsi të përzier etnikisht dhe me ndikime të përziera.

Këtu duhet theksuar se gjatë periudhave të lartpërmendura kemi edhe ngjarje të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me organizime të popullsive lokale, që kishin si qëllim vetadministrimin dhe pavarësimin nga Perandoria Osmane. Për t'u theksuar është fakti se popullsitë lokale ndërmernin veprime organizative me qëllim përcaktimin e gjendjes në një reflektim tjetër nga synimet e shteteve të lartpërmendura. Nga këto nisma mund të veçojmë kryengritjen e organizatës VMRO më 1903, apo edhe futjen e trupave të armatosur shqiptarë në përpjekejen për çlirimin e Shkupit prej trupave osmane në gusht të vitit 1912. (Vlora, 1965, f. 279; International Crisis Group, 2001, f. 11)

Kjo gjendje vazhdoi edhe në periudhën mes dy luftrave të mëdha. Maqedonia gjeografike vazhdonte të ishte e ndarë jo vetëm në aspektin territorial bazuar në pretendimet e më shumë aktorëve, por edhe nga ana identitare dhe institucionale. Pjesë të pretenduara ngelën nën shtetin bullgar, ndërsa pjesë të tjera nën sovrenitetin grek dhe serb. Pak a shumë, kjo ndarje territoriale vazhdon të jetë edhe në ditët e sotme, përveç ndryshimit të pjesës që është e pavarur nga administrimi serb. Gjatë periudhës mes dy luftrave botërore vërehen të njëjtat konfigurime që synonin Maqedoninë si pjesë e zonës së influencës, por në rethana të caktuara duke ngritur pretendime përtej asaj që ekzistonte për periudhën e theksuar. Këto rethana e hapën edhe më shumë problemin jo vetëm të kontrollit të territorit, por për më tepër edhe të popullsisë që shtrihej në këtë zonë, duke aluduar se ajo i përkiste njërit apo tjetrit grup etnik. (Rossos, 1994)

Ajo që është e dukshme gjatë kësaj periudhe është se Maqedonia gjeografike konsiderohej në aspekte të ndryshme si zonë influence e hapur për administrim në bazë të mundësive oportuniste, por jo edhe si entitet politik. Në diskursin politik të aktorëve të atëhershëm ajo trajtohej herë si mundësi zgjerimi territorial, herë si mundësi influence

politike mbi popullatën që shtrihej në të. Ajo që njihet sot si Republika e Maqedonisë në përfundim të luftrave ballkanike dhe në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, njihet fillimisht si Serbia Jugore, dhe më pas si provinca e Vardarit. Ky lloj trajtimi hapi mundësi të manipulimit të mëtejshëm mbi çështjen Maqedoni që filloi të njihet më tepër në agjendat rajonale në periudhën që vjen si rrjedhojë e Luftës së Dytë Botërore. (Mazower, 2000)

Periudha në vijim dhe lëvizjet e ndryshueshme ideologjike kishin ndikim të rëndësishëm në krijimin dhe identifikimin e çështjes së Maqedonisë në agjendat politike të kohës. Si pasojë e Luftës së Dytë Botërore kemi ngirtjen e lëvizjeve politike komuniste, ku për qëllimet e punimit tonë mund të veçojmë atë të Partisë Komuniste Jugosllave. Pra ishte Partia Komuniste Jugosllave që e futi për herë të parë në fjalorin politik Maqedoninë si entitet politik, duke u njohur prej saj si pjesë përbërse e Federatës Jugosllave. Që në vitin 1945 Maqedonia veçohet si njësi përbërse e Federatës dhe kështu brenda saj fiton të drejtën e një lloj vetadministrimi që nuk ishte parë deri në atë kohë. Pra, nga kjo periudhë kemi një kalim të asaj që njihet vetëm si një term gjeografik të një identifikim më i qartë politik dhe administrativ, një kontribut ky i Partisë Komuniste Jugosllave. (Mazower, 2000)

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë ideologët komunistë, të vetëdijshëm për historikun e afërt të zhvillimeve në një prej hapësirave gjeografike të Maqedonisë, identifikuan krijimin e një njësie federale me të njëjtin emër. Këto qëndrime formuloheshin në atë mënyrë që t'u jepej e drejta e administrimit njërive federale. Nga gjashtë prej njërive federale, njëra syresh ishte ajo Maqedonisë, me të drejta të barabarta si të tjerat. Njësitë federale kishin një nivel vetadministrimi substancial në çështjet shoqërore, duke pasur të drejtën e përfaqësimit në mënyrë barabartë me republikat e tjera të federatës. Partia Komuniste në të njëjtën kohë bënte atë që ishte bërë më parë në këtë pjesë të territorit nga

pretendentët e mëparshëm për kontroll, vetëm se tashmë nga një kontroll territorial filloi edhe një masë kontrolli ideologjik, duke i mundësuar vetadminstrim pjesës që deri asokohe kishte qenë nën administrimin serb, (Lilly, 2001)

Ky qëndrim i PKJ-së mundësoi një formalizim territorial mbi atë që nuk kish ekzistuar qoftë edhe si njësi gjysëm e pavarur. Por, duhet theksuar se në vazhdimësinë e zhvillimeve politike brenda federatës kemi një gjendje të ndryshueshme të statusit të njësive. Ajo vazhdoi të riformatohej në vazhdimësi në varësi të konjunkturave politike të kohës. Duke qenë se natyra e federatës ishte e bazuar mbi parime që njihnin barazinë për të gjitha njësitë federtive, rrjedhimisht njësia federative e Maqedonisë pësoi një përparim të statusit të saj territorial. (Lilly, 2001)

Ndryshimet kushtetuese të viti 1974 njihnin të drejtën e vetvendosjes për të gjashta republikat federative. Kjo nënkuptonte që rast shpërbërjeje të Federatës së Jugosllavisë, Maqedonia si e tillë do të kishte mundësinë e pavarësimit në kuadër të territorit që ishte përcaktuar si njësi administrative brenda federatës, ose si trashëgimi e pjesës gjeografike që deri në këtë kohë qe administruar nga mbretëria serbe. Ndonëse rethanat e kohës nuk e parashikonin një mundësi të tillë, përsëri ky ishte një formalizim i mundësisë së krijimit të një shteti të pavarur brenda një territori tashmë më të përcaktuar. Këto ndryshime do shfaqen të rëndësishme sidomos në periudhën kur ideologët kryesorë komunistë të viteve të para pas luftës do të largoheshin një e nga një nga skena politike pas disa dekadash, qoftë për arsye të diferencimeve të ndryshme idologjike, qoftë nga largimet për shkaqe natyrore. (Hayden, 1999)

Nga ajo që thamë vihet re se vazhdimësia e krijimit të entitetit shtetëror territorial të Maqedonisë mund të haset te zhvillimet dhe ndryshimet e njëpasnjëshme të federatës

brenda një cikli kohor që zgjati për më shumë se katër dekada. Gjatë kësaj periudhe vërehet një cikël ndryshimesh ku përveç të tjerash Maqedonia fillon të paraqitet si një territor i mirëpërcaktuar në aspektin kushtetues brenda Federatës së Jugosllavisë. Natyra e formulimit kushtetues të federatës ishte e tillë që nënkuptonte një sovranitet të limituar dhe vetadministrim në çështje që nuk lidheshin ngushtë me aspektet e sigurisë. Por, si një rast i veçantë bazuar në historikun e afërt, për Maqedoninë kjo nënkuptonte hapat e parë drejt shtetësisë, sepse pjesa e saj territoriale përbënte një segment kushtetues brenda federatës në mënyrë të barabartë me ata që kishin një historik krejtësisht ndryshe, ku, si shembull ilustrues mund përmendim Sërbinë. (Gocevski, 2006)

Nga një status i tillë kushtetues, Maqedonia filloi të kishte për herë të parë një menaxhim dhe vetadministrim të çështjeve që kanë të bëjnë me unifikimin e sistemit mbrojtës të federatës, duke u futur në të si pjesë përbërse e saj. Ndonëse ajo nuk kishte një autonomi në aspektet e sistemit mbrojtës, këtu mund të veçohen masat për mobilizim dhe mbrojtje civile, administrimi i masave për mobilizim të përgjithshëm etj. Këto masa dhe shumë të tjera në sferën civile ishin në kuadër të administrimit lokal. Por, pavarësisht kësaj, përsëri fjala përfundimtare ishte gjithmonë te njësitet federale. (Gocevski, 2006)

Një situatë e tillë, po ashtu, paraqitet edhe në sferën e politikës së jashtme të Republikës, që në vetvete përfshin një mundësi vetorganizimi, por jo autonomi të plotë në bartjen e koncepteve përtej institucioneve federative. Ndonëse ndryshimet kushtetuese edhe në këtë drejtim i hapën rrugën një administrimi, ajo kryesisht ishte një zyrë e njësiteve federative. Për t'u theksuar është fakti se këto njësite në periudhat e mëvonshme kishin një mundësi më të qartë delegimi në institucionet federative, por, si të tilla, ato kishin

kapacitete të limituara për të artikuluar politika të pavarura nga ato që përkufizoheshin në administratën federale. (Nacev dhe Petreski, 2013)

Nga një paraqitje e shkurtër e zhvillimeve që u bënë shkak për organizimin administrativ dhe territorial, haset një formatizim i gjendjes fizike të shtetit, duke filluar që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Me gjithë aspiratat dhe synimet e aktorëve të ndryshëm në hapësirën gjeografike ku zhvillohet ky formatizim, kemi një gjendje diskursi të ndryshëm, që rrjedhimisht ka ndikuar për dilema të ndërsjella për sigurinë. Këto debate patën edhe veprime konkrete nga të gjithë aktorët e interesuar, ndonëse me intensitet të ndryshëm në varësi të potencialit posedues.

Zhvillime të tilla historike, posaçërisht ato pas Luftës së Dytë, hapën shtigjet e rrjedhave të mëvonshme që patën si rezultat shpalljen e pavarësisë së njësisë republikane të Maqedonisë nga Federata Jugosllave. Ato ishin rrjedhojë e një ndërveprimi më të gjerë gjeografik, që në njëfarë mënyre mund lidhen edhe me ndryshimet idologjike dhe gjeopolitike që ndodhën në nivel global. Kjo ngaqë Maqedonia deri atëherë nuk ishte pjesë e sistemit global të shteteve, e rrjedhimisht nuk ishte pjesëmarrëse në këto procese. Një rol minimal mund të ketë luajtur në rafshin rajonal si pjesë e federatës që kalonte në një fazë shpërbërjeje dhe riorganizimi.

Pavarësia e Maqedonisë në vorbullën e këtyre ndryshimeve nuk ndodhi nga ndonjë veprim apo nismë nga brenda, por më shumë ishte një ndodhi që për më tepër mund të përshkruhet në vazhden e ngjarjeve që çuan deri te shpërbërja e Jugosllavisë. Në shikim të parë shihet edhe si një veprim i domosdoshëm, ngaqë pjesë të tjera të federatës kishin shpallur largimin nga tërësia. Si e tillë, Maqedonia ndodhej para një sfide të menjëhershme:

ose i duhej të humbte atë lloj autonomie që kishte ndërtuar gjatë katër dekadave të sistemit socialist federativ, ose të ndërmernte veprime që do çonin drejt pavarësimit. (Vankovska B. , 2000)

Një zgjedhje në këtë mes nuk ishte edhe aq e lehtë, për Republika ishte e varur në të gjitha fushat nga Federata Jugosllave, qoftë në sektorin e sigurisë, qoftë në atë të ekonomisë. Për më tepër, Maqedonia në këtë kohë fillon të përballet me sfida të reja që kërkonin edhe rindërtimin e shtetit dhe krijimin e një identiteti me të cilin do prezantohej në skenën rajonale dhe atë globale. Të gjitha këto në vetvete bartnin sfida shumëpërmasore dhe reale në një ambient të tensionuar në kuadër të sigurisë në rajon. Por, ballafaqime të tilla kishin sfida si në aspektin e sigurisë rajonale, si në atë të sigurisë së brendshme. Dilema të tilla shfaqen posaçërisht në relacion me konceptet e shtetformimit dhe çfarë reflekton pavarësimi për grupet e tjera të popullsisë në Maqedoni. (Dreyzov, 1991)

4.2 Gjendja demografike dhe grupet etnike

Një ndër segmentet e rëndësishëm të gjendjes fizike të shtetit është edhe pupullsia. Si e tillë ajo luan një rol të rëndësishëm, posaçërisht në shtetet e reja që kërkojnë të vendosin një identitet tjetër nga ai që ka paraprirë si koncept mbisundues deri në ato momente. Në pjesën e mësipërme u pasqyruan zhvillimet historike për bazën territoriale që përbën nocionin gjografik të Maqedonisë, duke mos vënë në pah polemikat dhe synimet identitare dhe grupore rreth këtyre zhvillimeve. Por, një pjesë e rëndësishme e këtij mozaiku historik patjetër që është edhe identiteti dhe përbërja e popullsisë së kësaj hapësire.

Në rastin e Maqedonisë, demografia dhe mbështetja identitare e popullsisë ndahet në disa segmente që reflektojnë edhe zhvillimet historike të saj. Siç u përmend më lart, paraqitja e nocionit Maqedoni në rajon zbuloi edhe synimet e disa aktorëve fqinj. Në përpjeke për të arritur qëllimet e tij, secili kishte në sfond një kontroll territorial, por për më shumë edhe të popullsisë që jeton aty. Këto përpjekje më vonë rezultojnë si çështje të rëndësishme së veçantë për përpilimin e politikave të sigurisë së Maqedonisë jo vetëm në drejtim të faktorit tashmë të jashtëm që nga shpallja e pavarësisë, por edhe në drejtim të segmenteve të brendshme të grupeve shoqërore që jetojnë aty. Për sfidat ndaj identitetit të Maqedonisë nga jashtë do flasim më vonë, ndërsa tani do provojmë të veçojmë aspektin demografik dhe rëndësinë që ai paraqet për sigurinë e Maqedonisë.

Meqë në përkufizimin e përmendur më herët, në të cilën bazohet punimi, popullsia veçohet si një përbërës i rëndësishëm i qenies fizike të shtetit, atëherë përbërja etnike dhe grupore reflekton në drejtim të analizës së sigurisë së komuniteteve që përbëjnë shtetin dhe si plotësohen nevojat e tyre në kuadër të institucioneve shtetërore. Jo rastësisht debati mbi numrin e popullsisë dhe kush e përbën thelbin e shtetformimit në Maqedoni paraqiten si tema kyçe rreth përparësimit të politikave të saj shtetërore.

Regjistrimi i popullsisë në rastin e Maqedonisë ka zënë një vend të rëndësishëm në diskursin politik të Maqedonisë në të gjitha fazat e zhvillimit të shtetit. Kjo sepse në thelb numri i popullsisë dhe përbërja etnike luan një rol të rëndësishëm jo vetëm si operacion që paraqet realitetin shoqëror, por për më tepër luan një rol në vetkonstruksionin shoqëror. Nëpërmjet regjistrimit të popullsisë, shteti si i tillë projektton politikat dhe sfidat me të cilat do përballet në periudhën në vijim. Në bazë të asaj çfarë rezulton nga regjistrimi, ai paraqet një masë sensibilizuese dhe projektuese, që në vetvete mund të përmbajë edhe elemente të

pasigurisë apo edhe të artikulimit të fuqisë. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur kemi të bëjmë me shtete ku shoqëritë ndahen më tepër në bazë të përcaktimeve etnike, gjuhësore etj. (Arel dhe Kertzer, 2001, f. 6)

Sfidat e Maqedonisë në përpjekjet e saj për pavarësi janë të rëndësishme si në gjendjen territoriale, ashtu edhe në atë të popullsisë dhe kontrollit mbi të. Nga një këndvështrim historik ato paraqiten në shumë forma, sepse pikësynimet fillestare të shteteve që e rrethojnë, ndaj identitetit të shtetit kanë gjeneruar aspirata që kalojnë edhe tek identifikimi dhe përbërja e grupeve etnike në të. Për më tepër, shtetet me pretendime historike ndaj Maqedonisë shkonin deri në propozime se populli maqedonas nuk është një entitet më vete, dhe si i tillë i takon Bullgarisë. E njëjta gjë ndodhte kur ishte fjala për kishën autoqefale, që kontestoheshin nga pala serbe. Pra, në aspektin historik, pavarësia e Maqedonisë hapi një sërë dilemash që kishin të bënin me përcaktimet e popullsisë së saj dhe identitetin etnik, religjioz, gjuhësor dhe të gjitha atributet e tjera që lidhen me popullsinë dhe përbërjen e saj. Pavarësia e Maqedonisë, ndonëse erdhi në mënyrë spontane nga ngjarjet që po zhvilloheshin rreth saj, ajo filloi të përballej me sfida që kërkonin një qasje shumëpërmasore, si në aspektin e pjesëmarrjes së saj në institucionet relevante ndërkombëtare, ashtu edhe në drejtim të identitetit të popullsisë dhe përbërjes etnike të qytetarëve. (Dreyzov, 1991, f. 47)

Si rjedhojë, sifadat identitare paraqiteshin nga jashtë bazuar në synimet historike dhe nga frika që shfaqej tek elita politike e Maqedonisë për çështje që kontestoheshin për identitetin politik. Përbërja etnike e popullsisë për elitën politike në proces të vendimarrjeve paraqitet si e rëndësishme, sepse duke u bazuar në të do formësohet natyra dhe strukturat administrative të shtetit. Pra, në bazë të perceptimeve për kompozimin etnik të popullsisë

do rrjedhë edhe zhvillimi dhe shpërndarja e resurseve që dalin nga kontrolli i këtyre institucioneve. Në një masë të madhe kjo transformon procesin e regjistrimit dhe përbërjes së popullsisë, që të jetë një proces jo vetëm statistikor por i lidhur ngushtë me proceset e tjera të vendimarrjes politike, që me raste ndërthuren edhe me pasoja ndaj stabilitetit të institucioneve të sapokrijuara. Për më tepër, një gjendje siç nuk e dëshirojnë elitat politike, në momente të caktuara mund të ketë implikimeve në qasjet e vendimarrjes, dhe ato mund të aplikohen në politikat e sigurisë dhe ato të jashtme. (Simmons dhe Kelley, 2014, f. 5)

Maqedonia është një shtet multietnik dhe si rrjedhojë çështjet demografike kanë një rol të veçantë, sepse ka një komunitet substancial shqiptar. Bazuar në qëndrimet nga jashtë që u përmendën më lart drejt identitetit të shtetit, regjistrimi i popullsisë ka qenë një ndër temat e nxehta si në të kaluarën ashtu edhe në kohën tonë. Regjistrimi përbën një projektim të diskursit politik, ku ngriten tema me të cilat partitë e ndryshme marrin veprime dhe projektojnë politika. Gjithashtu kjo vendos edhe dinamikën e ndërveprimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme dhe se si e perceptojnë njëri-tjetrin këto komunitete. Në rastin konkret numrat kanë luajtur një rol duke ngritur debate negative që karakterizojnë më pas qëndrimet e aktorëve politikë mbi çështjen. (Arel dhe Kertzer, 2001, f. 19)

Dilema e regjistrimit të popullsisë në Maqedoni ka qenë aq e rëndësishme, saqë në faza të ndryshme të historikut të shkurtër të pavarësisë ka nxitur një mosbesim të thellë mes etnive më të mëdha në këtë hapësirë. Vlen të përmendet se në kontekstin e Maqedonisë është fakt se akuza të ndërsjella për numrin e komunitetit në këtë rast ka nga të dyja palët. Nga njëra anë qëndron frika e humbjes së fuqisë dhe përfitimeve nga njëri komunitet, pra ai maqedonas/sllav; dhe nga ana tjetër kërkesa për më shumë qasje tek institucionet e shteti nga komuniteti shqiptar. Frika e ngritur nga dy komunitetet ka hapur dyshime të

njëpasnjëshme për autenticitetin e dy regjistrimeve të bëra qysh nga pavarësia e Maqedonisë.

Dy regjistrimet e bëra në Maqedoni që nga pavarësia e saj prej Federatës Jugosllave është regjistrimi i zhvilluar në vitin 1994 dhe ai i vitit 2002. Gjatë këtyre regjistrimeve vihet re rëndësia e numrave dhe e kompozimit etnik të popullsisë për organizimin e shtetit. Regjistrimi i parë është kryer në një periudhë të stërzgjatur nga regjistrimi i mëparshëm, i cili që zhvilluar në kohën kur Maqedonia ishte pjesë e Federatës, dhe regjistrimi i dytë përsëri në një interval kohor të shkurtër nga ai paraardhës. Kjo për arsye që lidhen drejtpërdrejtë me politikat që ndërmerreshin nga elitat politike dhe në bazë të asaj se çfarë projektohej gjatë pavarësimit. (Courbage, 2003, f. 430)

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pjesën sllave të popullsisë, sepse projektimi i pavarësisë së saj erdhi si pasojë e trashëgimisë nga Federata Jugosllave. Numrat e popullsisë dhe përbërja etnike e Maqedonisë shndërrohet në një politikë, sepse tanimë ajo merr rolin jo vetëm të regjistrimit të popullsisë, por edhe të trajtimit të identitetit. Ata që qëndrojnë pas numrave kanë në dorë artikulin e identitetit të shtetit, duke krijuar frikë dhe dilema mbi ndryshimet që mund të sjellin dhe duke ndryshuar gjendjen dhe primatin e të drejtave të tyre në shtet. (Arel dhe Kertzer, 2001)

Shteti maqedonas, i dalë si trashëgimi e sistemit socialist jugosllav, i trajtonte maqedonasit sllavë si shumicë dhe si të vetmin popull konstituiv të asaj hapësire. Në sajë të këtij diskursi socialist, që pësonte edhe ndryshime gjatë periudhës katër-dekadëshe, u vendosën edhe kuptimet mbi shtetformimin e republikave dhe të drejtave që gëzonin popujt dhe si duhej të artikuloheshin ata në ndërtimin e institucioneve dhe të mirave që buronin syresh. Shqiptarët konsideroheshin si pakicë brenda Federatës, por për më tepër edhe

brenda Republikës. Ky dallim në identifikimin e pakicës dhe shumicës që legjitimoi sistemi socialist, duke i dhënë të drejtën e shtetformimit vetëm njërit grup etnik në bazë të nocionit shumicë, i vendosi në plan të dytë shqiptarët. Bartja e kësaj trashëgimie statistikore nuk pëlqej nga shqiptarët në një ambient të ri kur vendoseshin themelet e pavarësisë së Maqedonisë, duke i shprehur pakanaqësitë përmes protestave të ndryshme dhe diskursit politik në vitet e pavarësimit. (Jovic, 2001)

Regjistrimi i parë që nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë aludonte në faktin se ai ishte i çrregullt, dhe si i tillë kërkonte vëmendjen dhe praninë e vëzhguesve ndërkombëtarë. Edhe kësaj ai përsëri nuk arriti që t'i mbyllte përfundimisht çështjet e kontestueshme, që kryesisht lidhen me çështje që kanë të bëjnë me rregulloret e zyrës së regjistrimeve apo edhe me përkatësinë etnike të regjistruarëve. Këto çështje, në esencë tregojnë rëndësinë e përmbajtjes kombëtare dhe të krijimit identitar të shtetit, si dhe konsolidimin institucional të tij. Politizimi i këtyre elementeve çoi deri te bojkoti i regjistrimit të parë, i organizuar në vitin 1991, dhe organizimi i një regjistrimi të jashtëzakonshëm në vitin 1994. Kjo ndodhi në kohën kur pavarësia e Maqedonisë po merrte formën e saj dhe dy komunitet kryesore kishin krijuar një masë mosbesimi ndërmjet tyre, saqë çështja e regjistrimit të popullsisë shkaktoi një frymë armiqësie dhe përplasjeje. (Friedman, 2002, f. 5)

Bazuar në censusin e vitit 1994, Maqedonia kishte një popullsi prej 1 945 932, ku maqedonasit sllavë përbënin 66.6% të popullsisë, shqiptarët 22.7 % , turqit 4 %, komuniteti rom 2.2 %, ai serb 2.1% dhe të tjerë. (State Statistical Office) Partitë shqiptare nuk i pranuan rezultatet e këtij regjistrimi duke kundërshtuar si metodologjinë e grumbullimit të të dhënave, ashtu edhe kompozimin etnik të regjistruarëve, duke aluduar se numri i

shqiptarëve etnikë është ulur qëllimisht për të vijuar me qasjen e njëanshme të ngritjes së institucioneve shtetërore.

Pas këtij regjistrimi të kontestuar kemi edhe një regjistrim tjetër që u zhvillua nga data 1 deri më 15 nëntor të vitit 2002. Ky regjistrim u mbajt pas mbarimit të konfliktit të vitit 2001 dhe menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare. Bazuar në censusin e vitit 2002, Maqedonia kishte një popullsi prej 2 022 547, ku maqedonasit sllavë përbënin 64.2 % të popullsisë, shqiptarët 25.2 % , turqit 3.9 %, komuniteti rom 2.7 %, ai serb 1.8 % dhe të tjerë. (State Statistical Office) Ky census, bashkë me censusin para tij shoqërohej me një grup ndërkombëtarësh që monitoronte mbarëvajtjen e procesit, me 50 ekspertë europianë. Por, përsëri pati kundërshtime nga shumë grupe etnike bazuar në perceptimet e tyre për numrin që përbënin në popullsinë e përgjithshme. (Alagjovovski dhe Stavrova, 2003)

Nga numrat e paraqitur më lart vërehet një ndryshim kur bie fjala për dy komunitet më të mëdha që përbëjnë numrin e përgjithshëm të popullsisë. Debatet vazhduan edhe në të ardhmen pavarësisht faktit se kishte vëzhgime nga ekspertë ndërkombëtarë. Në sajë të këtyre polemikave duhet theksuar se regjistrimi i radhës, që duhej mbajtur në vitin 2011, nuk është zhvilluar akoma, pa ndonjë parashikim se kur mund të nisë. Arsyet e një shtyrjeje të tillë duket se janë po të njëjtat, duke nxjerrë në opinion qëndrime nga politikbërësit dhe aktorët e ndryshëm publikë.

Siç e theksuam edhe më parë, regjistrimi dhe gjendja demografike luan një rol të rëndësishëm në sfidat e Maqedonisë së pavarur, si në drejtim të stabilitetit të brendshëm ashtu edhe në përpilimin e politikave të jashtme. Duke qenë se Maqedonia si një shtet i ri që doli nga shpërbërja e Jugosllavisë trashëgoi jo vetëm të drejtën e vetvendosjes si shtet i

pavarur, por edhe ballafaqimin me sfida të tjera. Sfida të tilla ndonjëherë dalin si rezultat i reflektimeve historike, por ajo që është më me rëndësi është se në vetvete ato bartin implikime që në raste të caktuara reflektohen edhe te stabiliteti i shtetit. Regjistrimi dhe numërimi i popullsisë në rastin konkret qëndron në faktin se influencon dhe formatizon karakterin e shtetit dhe se si përpilohet ideja mbi të. Gjendja dhe madhësia e grupeve etnike shkakton të drejtat dhe përparësitë në qasjen që ndërmarrin institucionet shtetërore karshi çështjeve me interes për grupet. (Arel dhe Kertzer, 2001)

Duhet theksuar se numri dhe përbërja e popullsisë tashmë është bërë një kategori kushtetuese në Maqedoni. Për këtë do të flasim në kapitujt në vijim, duke theksuar rëndësinë dhe çështjet mbi të cilat regjistrimi i popullsisë, nga një operacion i grumbullimit të të dhënave kalon në një segment të diskursit politik. Por, sa për ilustrim duhet thënë se ndryshimet kushtetuese që ndodhën në vitin 2001 dhe 2002, si platformë mbështetëse mbi çështjen se kush dhe si duhet të garantohen të drejtat e komunitetit, bazohen në përqindjen e popullsisë. Për rrjedhojë, që grupet e ndryshme etnike të trajtohen në mënyrë të barabartë, duhet të përbjënë një përqindje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të popullsisë së shtetit, që të fitojnë edhe të drejtat e tyre politike, kulturore e kështu me radhë. Marrëveshja Kornizë e Ohrit përcaktoi një përqindje të popullsisë që është e nevojshme për një grup etnik në numrin e përgjithshëm të popullsisë, me të cilën vendoset rëndësia e garantimit të këtyre të drejtave dhe në cilën masë do të aplikohen ato. (Brunnbauer, 2004, f. 567)

Që këtë rrjedh edhe dimensionin e veprimit dhe ndërveprimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë. Ky ndërveprim është më i dukshëm ndërmjet dy komuniteteve më të mëdha etnike, që përbëjnë më shumë se 90 % të popullsisë së

përgjithshme. Nisur nga kjo kemi edhe perceptimet që krijojnë aktorët e komuniteteve dhe vetë komunitetet për njëri-tjetrit, dhe për më tepër edhe perceptimet ndaj shtetit.

Duhet theksuar se perceptimet ndaj shtetit dhe dinamika e numrave në rastin konkret nuk është i vetmi faktor që mund të ketë pasur një rol në dinamikën e perceptimeve të komuniteteve ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj shtetit. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka pasur edhe qasja se si janë vendosur parimet bazë të ndërtimit të pavarësisë së Maqedonisë dhe institucioneve të saj. Për të parë diskursin dhe rëndësinë që ka numri dhe përbërja e popullsisë është e rëndësishme të analizohen edhe premiset mbi të cilat artikulohej shtetformimi. Në veçanti në dhjetëvjeçarin e parë të pavarësisë, paraqitet si ekskluzive dhe jo inkluzive. (Rakipi, 2008, f. 42)

4.3 Identiteti dhe perceptimet ndaj shtetit

Në dy kapitujt e parë dytë theksuam veçoritë teorike që merren me qasjet e ndryshme të analizës së sigurisë. Ato trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me sigurinë bazuar në koncepte që japin shpjegime mbi fenomenet e rëndësishme mbi sigurinë. Studimet tradicionale mbi analizën e sigurisë paraqiten si koncepte të lidhura ngushtë me shtetin dhe për shtetin, dhe kulmuan me zhvillimet e pas Luftës së Dytë Botërore. Me mbarimin e Luftës së Ftohtë, qasjet tradicionale mbi analizën e sigurisë në njëfarë mënyre nuk arritën të japin shpjegime për paraqitjet dhe shqetësimet e reja që reflektoheshin me ndryshimet gjeopolitike, por edhe për zhvillimet e tjera, siç është rasti me ato teknologjike që shpien drejt rritjes së ndërveprimit global.

Shkolla tradicionale dhe në veçanti ajo realiste, në kornizën e saj analitike trajton akumulimin e fuqisë si synimi i vetëm i ambicieve të shteteve në një ambient anarkik

ndërkombëtar. Duke qenë se bazohet në konceptin e fuqisë, rrjedhimisht preokupimi kryesor i shtjellimit të analizës së sigurisë ka të bëjë me aspekte ushtarake, duke u përqendruar te parandalimi i konflikteve, ekuilibri i fuqisë ndërmjet shteteve, formimi i aleancave etj. Të gjitha këto kanë si referent kryesor shtetin, dhe përpjekjen e tij për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial nga kërcnimet e jashtme. Në mjedisin anarkik ndërkombëtar shteti është agjenti i vetëm politik i legjitimuar për të organizuar aktet e tij në relacion me shtetet e tjera, duke mos u fokusuar thujtë në asnjë mënyrë tek segmenti i brendshëm dhe se si organizohet ai në mënyrë që të artikulojë interesat e tij. Shteti si i tillë, nga kjo perspektivë konsiderohet gjithmonë i bazuar në konceptin tradicional si zgjatje dhe shprehje e kombit. (Cavelty dhe Mauer, 2010, f. 106)

Ndryshimet e shfaqura pas Luftës së Ftohtë nxorën në sipërfaqe problematika me të cilat shtetet nuk ishin ballafaquar më parë, dhe që e tejkalonin konceptin e shtetit si shprehje automatike e kombit. Në veçanti kjo vihet re në shtetet e Europës Lindore, ku çështje të përcaktimeve identitare çuan në përplasje të ndërsjella. Kjo erdhi si rrjedhojë e asaj se si ishin ndërtuar shtetet dhe çfarë kishin realisht në brendësi të tyre. Si e gjeneronin fuqinë përbrenda dhe çfarë të drejtash dhe detyrimesh kishin për të gjithë anëtarët? Shteti në brendësi të tij përbëhet nga një popullsi që në raste konkrete e identifikon veten me ndërveprimet shoqërore që krijojnë një kulturë të përbashkët, për të cilën edhe jetojnë në një territor të përbashkët. Por, ngjarjet historike tregojnë se jo rallëherë territori në të cilin organizohet shteti nuk nënkupton që të jetë me patjetër edhe zgjatje e entitetit kulturor. (Smouts, 2001, f. 90)

Shkolla konstruktiviste ka një qasje më ndryshe kur është fjala për analizën e sigurisë së shtetit nga brenda dhe si reflektohet mbi identitetin e tij. Kjo qasje veçon

ndërveprimet e shoqërisë si një konstrukt që ndërlidhet ngushtë me gjendjen e vetë shtetit dhe atë çfarë artikulon në politikat e tij institucionale. Konstruktivistët mendojnë se shteti sillet në një mënyrë të caktuar ngaqë ai influencohet nga ambienti përreth/ekzistues i sigurisë, dhe se një ambient i tillë sigurie reflekton në normativën kulturore dhe institucionale. Normat krijohen nga prania e ideve dhe idetë zhvillojnë ndërveprime sociale që japin mundësi zgjedhjeje për çfarë dhe si duhen ndërmarrë politikat në momente të caktuara. Pra, konstruktivistët shohin një dallim të qartë për mënyrën se si formulohen politikat, qofshin ato të brendshme apo të jashtme në bazë të përvojave historike. Sipas tyre haset një dallim se ku fokusohet lidhja ndërmjet sigurisë kombëtare dhe identitetit kombëtar. Për të arritur deri te shprehja e identitetit kombëtar duhet një përvojë e ndërlidhur historike ose kulturore në përcaktimin e përmbajtjes dhe përparësisë së interesave të një shteti dhe si do të sillet ai. Në një përmbledhje të asaj që thamë më lart, mund të pohojmë se identiteti shtetëror formohet nga normat shoqërore që reflektojnë në zgjedhjen e një sjelljeje të caktuar për të formuluar interesat kombëtare apo shtetërore. (Cho, 2009)

Kështu, në raste të veçanta, brenda një shteti paraqiten shumë identitete, që mund të garojnë me njëri-tjetrin në përpjekjen për të aplikuar kuptimin e tij mbi sjelljen e shtetit dhe institucioneve të tij. Në këtë drejtim perceptimet se cilit identitet i takon shteti mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndarjen e njërit komunitet nga tjetri. Siç shpjegon Buzan-i, në bazë të së kaluarës historike komunitetet formësojnë bindjet me të cilat formohen vlerat nga ku dhe nisen qëndrimet mbi të cilat formësojmë pozicionet. Në raste të tilla perceptimet krijohen në bazë të të dhënave që grumbullojmë për palën tjetër, ku krijojmë edhe bindje të

cilat na ndajnë nga të tjerët. Perceptime të tilla janë edhe elementi kryesor ku formësohet identiteti i veçantë dhe i dallueshëm nga tjetri. (Buzan B. , 1991, f. 226)

Një garë e tillë për perceptimin e identitetit dhe shtetit në Maqedoni u paraqit rishtazi që nga fillimet e përpjekjeve për kontroll mbi territorin e saj kohë më parë. Gara nis të intensifikohet me krijimin e institucioneve autonome dhe vazhdon edhe me shpalljen e pavarësisë. Një shumëllojshmëri e kësaj gare përgjigjet me një koncept të zgjeruar mbi analizën e sigurisë. Kjo ngaqë sfidat e sigurisë së Maqedonisë fillimisht janë ndaj një identiteti kulturor dhe më pas transferohen edhe në atë të kohezionit të brendshëm të saj.

Perceptimet e ndryshme të dy komuniteteve në Maqedoninë e pavarur për shtetin fillojnë të shfaqen që nga pavarësia e vitit 1991. Këto shfaqje japin një reflektim fillestar mbi atë se si e shohin dy komunitet krijimin e një shteti ku ato bëjnë pjesë gjeografikisht. Këto zhvillime normalisht reflektojnë në krijimin e ndjesisë së njëres palë dhe tjetres në marrëdhënie me institucionet e shtetit dhe kush ka të drejtën e ushtrimit të influencës mbi to.

Perceptime të tilla lidhen ngushtë me pikënisjet e zhvillimit të identitetit politik dhe shtetëror të Maqedonisë dhe zgjedhjen e rrugës së saj për të bërë më tej në çastet e ndryshimeve të mëdha ideologjike që ndodhën me përfundimin e Luftës së Ftohtë, e cila solli një shpërbërje të Federatës në të cilën ishte kalitur autonomia e saj. Këto zhvillime sadoqë mund të kenë qenë të parashikueshme, Maqedoninë e gjetën të papërgatitur në qasjet që ajo mund të ketë zgjedhur gjatë rrugëtimit drejt pavarësisë. Një kontribut të veçantë për këtë kishte trashëgimia si politike ashtu edhe ajo ideologjike e fundviteve tetëdhjetë, kur kriza identitare filloi të shfaqej dukshëm në Federatën Jugosllave. Qëndrimet e institucioneve shtetërore gjatë kësaj periudhe ishin të fokusuara drejt një shtypjeje të

komunitetit shqiptar që jetonte në Kosovë, por që nuk kursente as pjesën tjetër të Federatës ku jetonin shqiptarët. (Holliday, 2004, f. 141)

Deklarata e pavarësisë së Maqedonisë ishte akti i parë politik i institucioneve socialiste republikane me një rëndësi në krijimin e identitetit shtetëror të mëvetësimit të saj, dhe si i tillë reflektohet si pikënisja e një rëndësie historike e cila hap shtigjet e krijimit të institucioneve në vazhdim. Deklaratës së shpalljes së pavarësisë i paraprinë disa nisma të institucioneve të atëhershme republikane ndaj komunitetit shqiptar, që preknin identitetin e tij. Janë një sërë masash që radhiten në dhjetëvjeçarin e fundit të Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave që ndikuan në vendosjen e rrethanave dhe kushteve ku u shpall deklarata e pavarësisë.

Autoritet e asaj kohe, pas vdekjes së Titos adoptuan një politikë që nuk pasqyrohej në kushtetutën e vitit 1974, ku të drejtat e kombësive të tjera, siç quheshin asokohe, ishin të apostrofuara. Këto masa ishin edhe pikënisje e zhvillimit të ngjarjeve të mëvonshme për krijimin e një identiteti kombëtarë dhe shtetëror. Ato kryesisht drejtoheshin në forcimin e identitetit maqedonas sllav në kuriz të komunitetit shqiptar. Holliday përmend disa syresh, siç është përdorimi i gjuhës shqipe nëpër shkolla, distancimi i arsimtarëve shqiptarë nga puna, pengesat ndaj regjistrimit të emrave shqip të fëmijëve të porsalindur e deri te kufizimet për numrin e fëmijëve që mund të kishte një familje apo një çift shqiptar. (Holliday, 2004, f. 143)

Nisma të kësaj natyre për hegjemonizimin e Republikës kulmuan me ndryshimet kushtetuese që ndodhën në vitin 1989, kur kushtetuta e Republikës Federative Socialiste të Maqedonisë u ndryshua në mënyrë që në një kohë të shkurtër pas kësaj, kur u shpall edhe pavarësia, të ishte shteti kombëtar i popullit maqedonas, duke hequr në mënyrë të

drejtpërdrejtë referencën që ishte deri atë kohë edhe për nacionalitetin shqiptar. Kjo përforcoi ndjeshëm pozicionin e elitës politike të kohës për të projektuar dhe ideuar një lidhje simbolike mes popullatës maqedonase dhe identitetit shtetëror të saj. Ndonëse një identitet i tillë kishte filluar që në pikënisjen e autonomisë në vitin 1945, tashmë gjeti mundësinë që të bënte ndryshimet e nevojshme për të projektuar një identitet të bazuar jo më në bazën ideologjike socialiste, por duke aluduar në mbrojtjen e identitetit të sapokrijuar në sajë të ndryshimeve që po ndodhnin në rajon. Me këtë elita politike maqedonase nuk arriti të bënte një shpëputje nga trashëgimia e asaj kohe, sepse politikat e pavarësimit dhe krijimit të identiteti shtetëror i ndërtonte bazuar në zhvillimet e vrullshme që ndodhnin në pjesët e tjera të Federatës, dhe për pasojë në krijimin e perceptimeve të ndryshme nga komuniteti tjetër që jeton në të. (Holliday, 2004, f. 144)

Masat konkrete të ndërmara nga elitat politike maqedonase u shfaqën me prirje drejt lidhjes simbolike të identiteti të shtetit dhe popullit maqedonas, por jo në atë mënyrë që në të njëjtën kohë të krijonte veprime që do të çonin drejt afrimit me komunitetet e tjera, që përbënin një numër të rëndësishëm të popullsisë, por duke krijuar antagonizma, që si pasojë do të reflektonin në krijimin e perceptimeve të ndryshme nga komuniteti shqipëtar. Kjo qasje e politikës së Maqedonisë justifikoheshte në faktin se ajo ishte e kërcnuar nga jashtë, dhe kështu paraqitet domosdoshmëria e ruajtjes së integritetit territorial duke i përqendruar resurset kryesore në konsolidimin e identitetit kombëtar maqedonas. (Engstrom, 2002, f. 11)

Në këtë mënyrë kushtetuta e Maqedonisë shërbeu si shkas për pikënisjen e disa perceptimeve të ndryshme mbi shtetin dhe identitetin e tij. Përkundër zhvillimeve historike për të dy popujt shumicë në Maqedoni, ajo vendosi bazat e një diferencimi etnik duke

aluduar në përparësinë që institucionet shtetërore duhet të kenë për një grup etnik ndaj tjetrit. Si e tillë ajo përkufizon identitetin e shtetit si një shtet i pavarur i popullit maqedonas, dhe në bazë të kësaj mundëson përparësimin e politikave institucionale duke u mbështetur në premisat e kësaj preambule.

Kjo dinamikë zhvillimesh gjatë kësaj periudhe ndikoi ndjeshëm në perceptimet e palës shqiptare në periudhën kur u shpall pavarësia. Ata ndjenin se kushtetuta e pavarësisë nuk reflektonte realitetin dhe gjendjen faktike, dhe kështu shkaktoi shtypje si më parë. Komuniteti shqiptar i bojkoti të gjitha aktet e shpalljes së pavarësisë nëpërmjet aktorëve politikë të kohës, që kishin filluar të vepronin në vigjilje të shpalljes së pavarësisë. Për më tepër, ata e shprehën haptas mospëlqimin e tyre ndaj formulimeve kushtetuese dhe njëkohësisht nuk votuan për aprovimin e saj gjatë seancave parlamentare. Kjo krijoi një perceptim të komuniteti shqiptar se identiteti i shtetit formohet në premisa që nuk reflektojnë mbi realitetin etnik të tij, duke u mohuar atyre të drejtën e shtetformimit në mënyrë të barabartë me komunitetin maqedonas. Masa të tilla krijuan një dualitet perceptimesh për shtetin e ri duke inkadruar momente mosbesimi dhe frike nga të dyja palët. (Engstrom, 2002, f. 11)

Ndonëse Maqedonia arriti të ndahej nga Federata Jugosllave pa ndonjë problem, siç mund të ishte përdorimi i forcës, ishte evidente se ajo do të kishte mundësinë e krijimit dhe konsolidimit të institucioneve bazuar në qasjet pragmatike të rethanave të krijuara si pasojë e ndryshimeve që po ndodhnin përreth. Por, me sa duket, në ngut e sipër për të krijuar një identitet të ri shtetëror, elita politike maqedonase u bazua kryesisht në një qasje më tradicionale të ndërtimit të institucioneve të pavarura. Kjo mund të ketë qenë e influencuar edhe nga një ambient anarkik që e rrethonte, ngaqë paraqitja e saj në skenën rajonale hapi

dilema dhe skepticizëm të vazhdueshëm nga aktorët e tjerë rajonalë. Një gjendje e tillë rajonale influenoi – gjithmonë sipas aktorëve politikë maqedonas – përzgjedhjen e mënyrave të konsolidimit të brendshëm, duke aluduar se ishte e nevojshme si rezultat i aspiratave të aktorëve të tjerë rajonalë ndaj saj. (Engstrom, 2002, f. 11)

Masat e ndërmarra për konsolidimin e shteti përbrenda krijuan një dinamikë tjetër, ku sjellja e elitës politike mundësoi rishtazi një garë të brendshme mes dy komuniteteve. Këto komunitete filluan të ndërtonin e të krijonin perceptime për veten dhe tjetrin në bazë të ngjarjeve historike që ia behën rishtas, dhe në këtë mënyrë filluan të merrnin në konsideratë mundësinë e organizimit të tyre bazuar në vlerat që ato shihnin dhe dëgjonin asokohe. Rrjedhat historike i dhanë mundësi elitës politike të komunitetit maqedonas për të formuluar politika që do ndikonin në krijimin e identiteti të shtetit duke u bazuar në premisat etnocentrike. Por, në të njëjtën kohë komuniteti shqiptar ndjeu se elita politike maqedonase jo vetëm që nuk reflekton mbi nevojat e këtij komuniteti, por edhe i cenon ato. Një ndërveprim i tillë ndihmoi në forcimin dhe konsolidimin jo vetëm të identiteti të shtetit, por edhe të të dy komuniteteve që tashmë u vendosën në një garë të përhershme me njëri-tjetrin.

Zhvillimi i identiteteve politike në Maqedoni është pasojë e disa faktorëve historikë që ndërthuren ndjeshëm me njëri-tjetrin. Nga njëra anë është komuniteti etnik maqedonas, që në historikun e tij bart përvoja të cilat janë të lidhura ngushtë me simbole politike që e gjejnë zanafillën e shprehjes institucionale tek idetë dhe horizonti socialist jugosllav. Nga ana tjetër është identiteti politik i shqiptarëve të Maqedonisë, që në bazë të përvojave historike lidhet ngushtë me simbole dhe shprehje që lidhen me identitetin shqiptar në rajon. Por, si një entitet politik i organizuar filloi të shfaqej në rrjedhat e pavarësimit të

Maqedonisë duke u bazuar në diskursin që sundoi gjatë kësaj periudhe. Perceptimet e njërës dhe tjetrit komunitet ndaj shtetit dhe identitetit të tij nga sa u tha më lart, nuk përcaktohen nga fakti se ata jetojnë në një territor që politikisht është i njësuar, por nga ndërveprimet dhe diskursi i shpërndarë gjatë marrëdhënieve mes tyre.

Këto premisa paracaktuan edhe dinamikën e ndërtimit të institucioneve shtetërore dhe mënyrën se si veprojnë ato në raport me çështje të caktuara, si në ato që kanë të bëjnë me stabilitetin e brendshëm, ashtu edhe me projektimet dhe përpilimet e politikave rajonale dhe atyre të jashtme.

Në vazhdim të studimit do të analizojmë shprehjen institucionale të shteti duke nxjerrë një analizë më të zgjeruar mbi natyrën e organizimit të tij dhe se si ndikohet nga faktorët e dy identiteve.

4.4 Sistemi dhe organizimi politik

Maqedonia u bë shtet i pavaruar si rrjedhojë e ngjarjeve që rrethonin zhvillimet politike dhe të sigurisë në rajon dhe më gjërë. Për një periudhë që u paraprin këtyre ngjarjeve, ajo ishte një prej njësisë federative të Jugosllavisë. Si e tillë, ndonëse kishte institucionet e saj, shprehja ideologjike e tyre mbështetej te vija socialiste e kohës. Jashtë kësaj periudhe, siç vërehet nga sa kemi thënë, ka një zbrazëti në ndërtimin e institucioneve, madje ato nuk ekzistonin në kontekstin institucional shtetëror. Bazuar në ambientin e sigurisë rajonale të asaj periudhe, pjesë e të cilit ishte edhe Maqedonia, pavarësia nga Federata erdhi pa ndonjë përplasje me strukturat dhe forcat ushtarake të saj. Që këtë Maqedonia doli si e vetmja zonë në Jugosllavinë Socialiste që i shpëtoi konfliktit apo edhe përplasjeve etnike duke i shpëtuar vorbullës nacionaliste serbe që kishte kapluar rajonin.

Por, megjithëkëtë ajo nuk i rezistoi influencës ideologjike me të cilën frymonin institucionet e republikës në kuadër të Federatës. Si rrjedhojë, qasjet më të rëndësishme ideologjike në krijimin e frymës institucionale me shpalljen e pavarësisë ishin rezultat i asaj influence.

Duke u bazuar në ndryshimet e lartpërmendura dhe duke pasur parasysh një varg implikimesh që sollën këto ndryshime për shtetet, si në aspektin e jashtëm ashtu edhe në atë të brendshëm, në një ambient të tillë shtetet nuk veprojnë vetëm në një univers shtetesh dhe sfidash që dalin nga ky sistem ndërkombëtar, por hasin sfida që i tejkalojnë konceptet tradicionale mbi sigurinë. Për shtetin u shfaqën një varg problemesh nga më të ndryshmet, që deri atëherë ishin të panjohura, ku si segmente të reja paraqitet ndarja dhe dualiteti brenda shtetit, siç është ndarja etnike, kombëtare, religjioze, gjuhësore etj. Në shumtën e rasteve këto sfida paraqiten si mundësi për shtetin për një konsolidim të mëtejshëm, por në raste të tjera ato mund të sjellin mospërputhje edhe më të thella brenda shoqërisë. (Smith, 1995)

Duke qenë se në kohët bashkëkohore aktori kryesor politik paraqitet shteti, atëherë del në pah rëndësia e një analize mbi formën e organizimit shtetëror, dhe si e shpreh frymën e shtetit nëpërmjet institucioneve të tij. Rreziqet për sigurinë mund të jenë te vetë forma organizative apo edhe identiteti ideologjik dhe format e tjera që e karakterizojnë shprehjen institucionale. Sfidat ndaj sigurisë së sistemit politiko-ideologjik të shtetit mund të paraqiten nga brenda dhe jashtë. Sfidat e jashtme kanë formën e njohjes së sovrenitetit, por ato mund të paraqiten edhe në njohjen e legjitimitetit ideologjik të shtetit. Kurse nga brenda, rreziqet ndaj sigurisë dhe sistemit politik mund të jenë po ashtu ideologjike, por edhe

çështje të tjera me rëndësi që përbëjnë shtetin, siç janë insitucionet e tij dhe forma e regullimit organizativ të institucioneve. (Buzan, Waever, dhe Wilde,1998, f. 143)

Shtetet që kryesisht u kapën nga vala e këtyre ndryshimeve ideologjike në skenën globale gjeopolitike filluan të aplikojnë në institucionet e tyre shprehje institucionale që ngjanin më tepër me formën demokratiko-pluraliste. Por, nga ana tjetër, duke mos qenë të afta të largohen nga influencat e mëhershme, ato shpesh bien pre e ideologjive të tjera, që i stimulojnë edhe më shumë ndarjet që ekzistojnë brenda tyre. Kjo ndodh për arsye të trashëgimisë institucionale që ato kishin në të kaluarën, por në të shumtën e rasteve me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen nga kërcnimet e mundshme. Cilësia demokratike në këto raste nuk reflektohet në masat e mirënjohura demokratike: barazia civile, toleranca politike etj., por fokusohet te kontrolli i vazhdueshëm i institucioneve shtetërore. Nga një këndvështrim i tillë është e domosdoshme një analizë e aspekteve ideologjike dhe nismave me të cilat shtetet ndërtojnë dhe artikulojnë vlerat e tyre institucionale gjatë dhe pas kësaj periudhe tranzicioni. (Smootha, 2001, f. 11)

Në bazë të koncepteve të zgjeruara të sigurisë na paraqiten disa forma të organizimit politik, që më e njohura në sistemin ndërkombëtar është shteti territorial. Por, në bazë të sfidave dhe ndryshimeve të tjera që përmendëm më lart, në formën e orgnizmave politikë mundë të jenë organizatat rajonale, si BE-ja apo edhe grupe shoqërore dhe kombëtare/entike pa një territor të mirëpërcaktuar. Të gjitha këto struktura nuk janë të formalizuara qartë nëpërmjet sistemit ekzistues ndërkombëtar, që të konsiderohen si objekt referues sigurie, por, nga ana tjetër, është e rëndësishme që këto organizma politikë – ndonëse joformalë – posedojnë një bazë ndjekësish nga ku buron një lloj legjitimiteti për ta. Ata janë në një stad të mirorganizuar politik, ku mund të shprehin vullnetin e tyre

ideologjik dhe atë politik. Duke u bazuar te kjo, ata janë në gjendje të akumulojnë fuqi të mjaftueshme për të ngjitur një çështje në nivel sigurie, dhe si e tillë çështja bëhet e rëndësishme në ambientin përkatës. (Buzan, Waever, dhe Wilde, 1998, f. 146)

Duke u nisur nga fakti se shteti përbëhet nga segmentë kryesorë, siç është ideja e tij, shprehja fizike dhe institucionet, mënyra se si ato ndërtohen paraqitet e rëndësishme në bazë të asaj që kemi trajtuar. Ideologjia e ndërtimit të institucioneve mund të ketë pasoja për një shtet, posaçërisht kur brenda tij ka elemente të mundshme ndërtimi që përvijohen në disa forma të ndryshme organizative. Kjo arrihet më lehtë në shtete me popullsi multietnike, ku veç të tjerash, tentativa për influencime të njëanshme bëhet e papranueshme nga një palë tjetër. Institucinet apo edhe qeveria është zëri legjitim i shtetit, dhe nëse institucionet e shtetit janë të influencuara nga një segment i caktuar shoqëror, atëherë një segment tjetër, me automatizimin e kërkesave të tij përbën kanosje për sigurinë dhe stabilitetin e institucioneve.

Në përpjeke për ndërtimin e institucioneve në kushte tranzicioni, çështjet etnike paraqiten si probleme parësore në përpjekejen për të përcaktuar se cila është rruga që aprovohet në ndërtimin e institucioneve të shtetit. Etniciteti shfaqet si një mbulesë e mungesës ideologjike në shumicën e këtyre shteteve, si pasojë e tranzicionit të sistemit politik nga ai komunist në një tjetër. Çështjet institucionale dhe të ndërtimit të shtetit lidhen më shumë me përkatësinë etnike dhe kryesisht i takojnë grupit dominues etnik. Një nacionalizëm i tillë shfaqet me prirje të fuqishme për të asimiluar sistemin politik shtetëror në një pardigmë kyçe për ekzistencën e kombit, duke e paraqitur shtetin dhe institucionet e tij si agjentët kryesorë dhe legjitimë të hegjemonisë politiko-shoqërore të etnisë dominuese si bartëse kryesore e shtetit-komb. (Brubaker, 1996, f. 66-67)

Ndërmarrja e këtyre hapave vjen si rezultat i perceptimeve për mbrojtje të sistemit të vlerave, që në njëfarë mënyre ndjehet i kanosur nga mjete joushtarake. Në një bazë tradicionale, siguria politike ka të bëjë me mbrojtjen e legjitimitetit dhe me institucionalizimin e rregullave dhe stabilizimin e autoritetit institucional nëpërmjet formës politike. Në rastin konkret, përqendrimi është te aktorët strukturorë, proceset që ndërtojnë dhe institucionet që shprehin frymën politike. (Buzan, Waever, dhe Wilde, 1998, f. 144)

Pavarësisht prirjes për të bartur praktika nga sistemi i kaluar në Republikën e Maqedonisë, dhe duke u nisur nga një sistem kushtetues ku vërehet një diferencim në qasje – që shteti duhet të ketë ndaj popullsisë që e përbëjnë – mund të themi se edhe ideologjia institucionale dhe qeveritare që ndërtohej ishte ajo e shprehjes monoetnike. Së këndejmi, që në fillim, shteti deklarohet si shtet i popullit maqedonas dhe i popujve të tjerë që jetojnë brenda tij. Përgjashtimi që bëhej duke theksuar shtetin maqedonas, rrjedhimisht dha një dritë jeshile për ngritjen e institucioneve në baza ku ideologjia e tij do të jetë etnocentrike.

Në një gjendje të tillë, dilema se kush e zotëron shtetin rrjedh nga fakti që dallimet e brendshme politike dhe ndërtimi i sistemit institucional të diferencimit shumicë-pakicë legjitimohet me preambulën kushtetuese, e cila bën dallime mes një komuniteti dhe një tjetri. Ndonëse në njëfarë mënyre shpreh barazinë, fakti se thirrja kryesore e saj mbështetet në themelimin e shtetit kombëtar të popullit maqedonas, krijon a priori një identitet bartës dhe jep të kuptohet një radhitje të popujve me ekskluzivitet, duke ia dedikuar pronësinë mbi shtetin popullit maqedonas. Kështu pjesa shqiptare ndjehej e diskriminuar, duke kërkuar mënyra për të inkuadruar identitetin shqiptar në preambulën kushtetuese si një mënyrë për të pasur qasje më adekuate në institucionet shtetërore dhe krijimin e politikave të sajë. (Daskalovski, 2002, f. 15)

Sistemi politik në Maqedoni në periudhën pas pavarësisë bazohej në një sistem liberal, me themele në sundimin e shumicës, dhe kështu zgjodhi rrugën e ndërtimit të institucioneve duke promovuar një bazë etnike në përmbushjen e kriterëve të përfaqësimit institucional. Një sistem i tillë i sundimit të shumicës përmes zgjedheve parlamentare, duke i dhënë një theks etnocentrik ndërtimit institucional, rrezikon mundësinë e humbjes së besimit të ndërsjellë mes komuniteteve nëse shteti që synon shtetformim përbëhet nga disa grupe etnike. Ky proces i pozicionon anëtarët e grupit më të vogël në një situatë ku ata kërkojnë të drejtën e përfaqësimit si gjuhësor ashtu edhe kulturor, si çështje të një rëndësie të veçantë për ekzistencën e tyre si komunitet brenda shtetit, duke u mundësuar kushte të njëjta për ekzistencë. (Daskalovski, 2002, f. 9)

Qasja e ndërtimit të shtetit në një paradigmë të tillë shkaktoi pasoja në procesin e legjitimitimit të institucioneve të krijuara. Një qasje e tillë shkakton formalizimin e autoritetit etnokratik, që kur kushtetuta si e tillë, në rastin e adoptimit të saj gjatë procesit të pavarësisë atribuon një eskuzivitet në mbrojtjen e etnisë maqedonase, që për pasojë krijon perceptime për rreziqe dhe armiqësi në baza idologjike për sistemin e shtetit, nëse komunitetet e tjera me një sfond të organizuar politik dhe kulturor – siç është komuniteti shqiptar – kërkojnë të drejtat e tyre po ashtu të garantuara në mënyrë institucionale. Kjo situatë ka qenë burim jostabiliteti për shtetin, duke ngritur tensionet mes dy komuniteteve më të mëdha etnike. Një gjendje e tillë e regullimit të shtetit dhe relacioneve të komuniteteve kishte një rol të rëndësishëm në krijimin e perceptimeve për stabilitetin dhe sigurinë e shtetit në përgjithësi.

4.6 Konkluzione

Në këtë kapitull analiza zhvillohet në një kontekst historik në nivel të shtetit. Nëpërmjet aplikimit dhe përmasave teorike tradicionale, shqyrtohen dimensione të sigurisë së Maqedonisë si në aspektin historik ashtu edhe në atë të themelimit të saj dhe shprehjes që ajo artikuloi në këtë proces. Literatura e koncepteve tradicionale të analizës së sigurisë, e përqendron njësinë kryesore tek aktori shtet dhe kushtet që i nevojiten atij në marrëdhënie me shtetet e tjera dhe masat që ato ndërmarin në një ambient anarkik. Një qasje e tillë përfshin segmente që kanë të bëjnë me ushtrimin e legjitimitetit të plotë të autoriteteve shtetërore në një territor të caktuar dhe mbi një popullsi që ndodhet brenda tij me kushte ushtrimi dhe përqendrimi të fuqisë në aplikimin e këtyre masave.

Por, në një kontekst të ri sigurie u paraqitën një sërë elementesh shtesë që në periudhën e një tranzicioni për arsye ndryshimesh si ideologjike ashtu edhe gjeopolitike shtetet hapën një numër çështjes që kishin të bënin si me performancën e tyre në arritjen e objektivave të sigurisë ashtu edhe me sigurimin e ekzistencës së tyre. Qasja e zgjeruar e analizës së sigurisë thellohet rreth çështjeve dhe paradigmave që kanë të bëjnë me sigurinë e shtetit, duke veçuar çështje shtesë që sot shfaqen të rëndësishme e që kanë të bëjnë me kushtet që posedon shteti brenda territorit të tij, ashtu edhe ato në fqinjësinë e tij. Një thellim i tillë i analizës së sigurisë synon të japë shpjegime për problemet që lidhen me shtete që kanë një përbërje të përzier popullsie, duke aluduar në natyrën e organizimit të shtetit dhe si menaxhon dhe ofron siguri për të gjithë komunitetet përmes institucioneve legjitime.

Si pasojë e zgjedhjeve që aplikon shteti në ndërtimin e shprehjes institucionale të tij gjenerohen edhe perceptime që mund të ndajnë vetë përbërjen e shtetit, duke sjellë pasoja

nga më të ndryshmet, siç është dendësia e shtrirjes së legjitimitetit të institucioneve të tij në territorin përkatës apo edhe dukuria e përplasjeve të ndryshme. Në kushte të tilla kemi edhe paraqitjen e një analize të zgjeruar nga Shkolla e Kopenhagenit, ku veçohet siguria për identitetin e komuniteteve të veçanta brenda shtetit si pasojë e zhvillimeve të brendshme dhe ngjarjeve që krijojnë pereceptime për shtetin, dhe se si i trajton ai subjektet. Kemi edhe analizën e një qasjeje të zgjeruar të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë dhe çfarë prezantojnë ato për stabilitetin e brendshëm të saj në kontekstin e zhvillimeve historike dhe komunitetit shqiptar në Maqedoni. Në këtë drejtim analizohen kushtet historike që sollën pavarësinë e Maqedonisë, diskursi politik gjatë dhe pas shpalljes së pavarësisë dhe çështjet që paraqiten si të rëndësishme në diskursin mes dy komuniteteve kryesore për natyrën e organizimit të shtetit dhe paraqitjen e tij.

KAPITULLI V: KONTEKSTI DHE ZHILLIMET RAJONALE

5.1 Maqedonia dhe kompleksi i sigurisë rajonale (nënrajonale)

Rajoni i Europës Juglindore, historikisht ka qenë një arterie e rëndësishme rajonale në një kontekst më të gjerë rajonal europian. Ngarjet në periudha të ndryshme historike kanë kontribuar në formulimin e karakterit të rajonit dhe zhvillimeve që janë përhapur në periudha të ndryshme. Në kohë të ndryshme ka shërbyer edhe si një pikënisje e përplasjeve me përmasa të ndryshme dhe në të njëjtën kohë duke tërhequr intersin e opinionit dhe politikbërësve europianë dhe botërorë. Këto ngjarje kanë pasur efekte të ndryshme për krijimin dhe formulimin e politikave të sigurisë jo vetëm në aspektin më të gjerë ideologjik, por edhe për sa i takon shteteve që janë pjesë e këtij rajoni. Normalisht që një kontekst i tillë historik ka luajtur një rol të rëndësishëm në kulturën politike dhe formulimin e karaktereve të shteteve, në bazë të të cilit ato kanë vepruar rishtazi.

Ngaqë rajoni në pjesën më të madhe të historisë ka qenë pjesë e një perandorie dhe për arsye se rajoni nuk ka pasur një shtet me një fuqi që të mund të projektonte politika jashtë tij, doemos që përfshirja e fuqive të mëdha ka qenë e lidhur me zhvillimet e tjera në një rrafsh më të gjerë. Duke qenë se rajoni për një periudhë të gjatë kohore ishte kufiri i dy perandorive që kishin një rol të madh, ajo Habsburge dhe Osmane, normalisht që edhe zhvillimet e kombeve dhe tradita e tyre e shtetformuese lidhet ngushtë me fatin dhe përvojën e këtyre perandorive.

Historia e zhvillimit të shtetit në rajon daton me fillimin e tërheqjes graduale të Perandorisë Osmane. Përvoja e shteteve që përbëjnë rajonin, shtetformimin e tyre e bazuan kryesisht te zhvillimet që ndërmorën në sajë të kësaj dinamike. Disa nga shtetet kishin

përvojën e kryengritjeve të nëpasnjëshme, që kishin si synim pavarësinë nga Perandoria Osmane. Disa shtete të tjera hasën zhvillime historike që ndërthuren me krijimin e identiteteve kombëtare në rajon. Këto zhvillime ishin më të vonshme, për arsye të shumta, por që lidhen me kapacitetet dhe përvojën institucionale të kombeve të ndryshëm në arritjen e pavarësisë dhe rrugët nëpërmjet të cilave shkuan deri te pavarësia.

Shfaqjet e para të aktorëve rajonalë në skenën e politikës së lartë të shteteve të mëdha e vëmë re gjatë Konferencës së Berlinit, ku shtete si Bullgaria, Greqia, Serbia dhe Rumania kishin një rol të rëndësishëm në krijimin e strukturës së re ballkanike. Kjo paraqitet edhe si periudha fillestare e krijimit të akteve të interesave të artikuluar përmes aktorëve të mësipërm. Normalisht që çdo shtet kishte edhe aleancat e tij, me të cilat mbështeste aspiratat për zgjerim apo për konsolidim. Krijimi i dinamikës së intereseve të shteteve në rajon vazhdoi për një periudhë të caktuar bazuar në përvojën europiane të shtetit, duke u mbështetur në përpjekeje për zgjerim territorial në pjesën osmane të rajonit. Gjatë kësaj periudhe, aktorët e rajonit zhvilluan edhe ideologjinë bartëse, të articular me mbështetje në ngjarje historike të veçanta nga njëra-tjetra. Kjo ideologji kulmoi me luftrat ballkanike të vitit 1912-13, si rezultat i aspiratave të ndërthurura ndërmjet aktorëve kryesorë në rajon. (Danforth, 1995)

Në vazhden e dy luftrave botërore kemi një ndryshim të rëndësishëm në konstelacionet e rajonit dhe zhvillimeve në të. Krijimi i Jugosllavisë dhe ndarja e Europës në baza ideologjike kishte një impakt të rëndësishëm në riartikulimin e intereseve të shteteve dhe aktorëve kryesorë në rajon. Shtete si Serbia ishin pjesë e federatës në të cilën bënin pjesë të paktën pesë entitete të tjera. Si rrjedhojë, artikulimi i politikave të sigurisë dhe atyre të jashtme bëhej përmes institucioneve federative. Këto institucione kishin një

frymë ideologjike me të cilën vepronin në arenën ndërkombëtare. Greqia dhe Bullgaria bënë pjesë në tabore të ndryshme ideologjike, dhe si të tilla kaluan në një fazë tjetër të ndërtimit dhe shprehjes institucionale.

Dekadat e fundit të zhvillimeve në rajon lidhen kryesisht me ndryshimet ideologjike në rafshin global, që përfshin edhe rajonin e Europës Juglindore. Këto dekada qenë shenja më e rëndësishme për zhvillimet në rajon. Në aspektin e sigurisë së rajonit kemi shpërbërjen e Jugosllavisë dhe luftrat etnike që e mbërthyen atë. Ndryshimet ideologjike që përfshinë Europën Lindore, ndodhën pothuajse të gjitha pa ndonjë gjakderdhje të përmasave të mëdha, dhe në të shumtën e rasteve edhe pa ndonjë konflikt që duhet veçuar. Rasti i shpërbërjes së Jugosllavisë ishte një zhvillim krejt ndryshe, si rezultat i nacionalizmit agresiv, ku si pasojë luftrat e përgjakëshme që ndodhën në territorin e saj kulmuan me vrasje dhe zhvendosje masive në emër të formimit të shtetit-komb.

Në një ambient të tillë ndryshimesh kemi edhe shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë. Ndonëse shpallja e pavarësisë nuk u shoqërua me ndonjë konflikt me pjesë të tjera të Federatës apo edhe shteteve fqinje, zhvillime të tilla kishin efekte të rëndësishme në krijimin e politikave të sigurisë dhe shtetndërtimit të saj. Këto ndryshime të rëndësishme e gjetën Maqedoninë në një situatë ku sfidat në procesin e krijimit të paavarësisë ishin si të brendshme ashtu edhe të jashtme, bazuar në zhvillimet rajonale të kohës.

Për të pasur një kuptim më të qartë të ndikimit të sigurisë rajonale mbi sigurinë shtetërore është e rëndësishme analiza e një niveli tjetër për sigurinë. Më lart theksuam se Shkolla e Kopenhagenit kishte një qasje të zgjeruar analitike, por edhe të thelluar, duke e vijuar atë edhe në nivel rajonal. Kjo paraqitet e rëndësishme për nevojat e punimit ngaqë krahas analizës së sfidave të sigurisë së sistemit, – si në kapitullin e kaluar – shfaqet e një

rëndësie të veçantë edhe për një kuptim më të gjerë të influencave të zhvillimeve rajonale në sigurinë e Maqedonisë, dhe se si ndikojnë ato te konceptet e shtetformimit. Kjo është më shumë e rëndësishme për arsye se kompleksi i sigurisë rajonale – i paraqitur nga Buzan-i – parashikon një analizë si vertikale ashtu edhe horizontale të marrëdhënieve mes shteteve. Një analizë e tillë e nivelit do të na japë një kuptim mbi sfidat dhe kërcnimet që paraqiten në rajon në kohë dhe formë të ndryshme, me një sfond të veçantë gjeografik, ku ndërveprimet shtetërore kanë si karakteristikë hapësirën ku kufizohen shtetet.

Duke u nisur nga premisat historike që theksuam më lart, vihet re nevoja për një analizë rajonale mbi sigurinë, si në nivel horizontal ashtu edhe në atë vertikal. Kjo bëhet mëse e mundshme me një qasje nga Shkolla e Kopenhagenit, që e thekson Buzan-i në orvatjet për zjerimin dhe thellimin e studimeve të sigurisë si të rëndësishme për arsye të natyrës së marrëdhënieve mes shteteve. Një zgjerim i tillë shënjohej me faktin se analiza mbi sigurinë përfshin “faktorë objektivë dhe subjektivë”, sepse sistemi ndërkombëtar i sigurisë përbëhet nga sfida të cilat shfaqen në formë dhe çaste të ndryshme në zona gjeografike po të ndryshme. (Buzan, 1991, f. 105)

Nga një fokus i tillë, në vijim do pasqyrojmë transformimet që ka pësuar Maqedonia në kontekstin e sigurisë rajonale, dhe se si janë shndërruar këto transformime në mundësi bashkëpunimi dhe konsolidimi shtetëror. Kjo ka shumë rëndësi pasi sfidat dhe gjendja e rajonit në përgjithësi ka qenë e tillë që perceptimet nga jashtë janë artikuluar edhe brenda, sepse këto dy segmente kanë pasur mundësinë e destabilizimit të vendit. Për më tepër, nga elita politike janë shndërruar në pjesë të diskursit politik, dhe janë transformuar në elemente që duhen siguruar. Çdonjëri prej këtyre transformimeve sfidues përbënte mundësi strategjike dhe themelore, që e kanë çuar Maqedoninë në prag të anëtarësimit në NATO

dhe në Bashkimin Europian, dhe përmes këtyre anëtarësimeve të rëndësishme për të siguruar një ombrellë të madhe për sfidat e sigurisë.

Në vazhdim do paraqesim disa nga çështjet me të cilat është perceptuar dhe ndërtuar në relacion me shtetet fqinje çështja e sigurisë së Maqedonisë. Duke qenë se të gjitha shtetet në rajon kanë kaluar në një lloj tranzicioni, për arsye të ndryshme ata kanë marrë rrugët e tyre të zgjidhjes së çështjeve të sigurisë, por thuajse të gjithë kanë zgjedhur një diskurs të kontekstit rajonal, nëpërmjet projektit europian apo qoftë edhe përmes atij të NATO-s. Sigurimi dhe desigurimi i çështjeve të sigurisë në rajon përsillet siç paraqitet nga Buzan dhe Waever, në disa sektorë, siç është ai i identitetit kombëtar, i sigurisë shoqërore apo dhe ai religjioz. Për më tepër, në lidhje me lëvizjet negative rajoni identifikohet me çështje të cilat kanë të bëjnë me apekte territoriale, siç është Bosnja apo edhe Kosova. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 384)

Në shpejgimet që jepen për çështjet e sigurisë rajonale, Maqedonia prezantohet si një ndër rajonet me interes nga shtetet që e rethojnë, madje dhe palë. Si çështje me rëndësi si për shtetet ashtu edhe për vetë Maqedoninë, paraqiten çështjet e identitetit nga pala greke apo ato territoriale nga ajo serbe dhe bullgare, duke krijuar një sërë fenomenesh dhe aktorësh të interesuar. Nisur nga kjo mund të vihet re se dinamika e armiqësisë në EJT-të e tjera sillet edhe te rasti Maqedoni, dhe kështu kjo kërkon një analizë që bazohet te pikënisja e konstelacionit konfliktual dhe te çështjet për të cilat duken se ndërveprimet e njërit nuk mund të zgjidhen pa tjetrin. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 382)

5.2 Federata Jugosllave dhe Serbia

Periudha e ndërtimit të shtetit të pavarur të Maqedonisë është relativisht e re. Ajo daton që nga viti 1945 si rrjedhojë e ngjarjeve pas Luftës së Dytë Botërore. Asokohe Maqedonia karakterizohej në një masë të madhe nga një relacion me pjesët qendrore dhe më të fuqishme bazuar në konstelacionet e pushtetit brenda Federatës. Më sipër thamë që ajo ka një histori të paqartë, deri edhe joekzistuese të institucioneve shtetërore. Pjesa që njohim sot si e pavarur, në një periudhë kohore mes dy luftimeve ishte pjesë territoriale në përbërje të Serbisë Jugore. Më pas nisi një historik i vetadministrimit lokal, por përsëri si pjesë e Federatës Jugosllave dhe ideologjisë komuniste të kohës së Titos. Duke qenë një ndër republikat më të pazhvilluara, ajo kishte një influencë të madhe që ushtrohej mbi të nga pjesët e tjera federative. Fillimisht kjo influencë shtrihej bazuar në afërsinë gjeografike, por edhe në atë ideologjike dhe identitare. Nga këtu u lidhën edhe marrëdhëniet e Maqedonisë së pavarur me Serbinë, dhe për njëfarë kohe edhe me pjesën e ngelur federative. (Mazower, 2000)

Një situatë e tillë e relacioneve të Maqedonisë me Federatën pati si pasojë hezitimet e para për largim nga Federata, edhe pse ngjarjet dhe turbullirat si politike ashtu edhe ato të sigurisë kishin marrë një kahje në disa pjesë të Federatës. Varësia dhe mbështetja që kishte Maqedonia në ushtrinë federale dhe çështje të tjera, e detyruan presidentin e asaj kohe që bashkë me anëtarin tjetër të Federatës nga Bosnja të propozojnë vazhdimësinë e Federatës në një formë tjetër organizative dhe politike. Serbia ishte pjesa më e fuqishme e Federatës dhe normalisht që këtë thirrje të presidentit të Maqedonisë e shihte si dobësi për të organizuar një shtet të pavarur, duke besuar se siguria e saj është detyrimisht e lidhur me pjesët e ushtrisë jugosllave, primatin e së cilës e mbante ajo. Nga ana tjetër, duke njohur

realisht situatën e brendshme dhe mundësitë mbrojtëse të Maqedonisë në një ambient të tillë konfliktual, lidershpi i Serbisë së atëhershme kishte bindjen se Maqedonia në këto kushte kishte nevojë për një aleancë me të. (Vankovska, 2000, f. 10)

Shpallja e pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991, ndonëse jo e papritur nga lidershpi i atëhershëm serb, që në diskursin politik kishte një sfond të theksuar nacionalist, u prit me hezitime, bile në disa raste edhe me kërcënime, duke vënë në duk të kaluarën historike të Maqedonisë si pjesë e Serbisë. Një diskurs i tillë nga qarqe të ndryshme serbe përqendrohej kryesisht në aspekte identitare që kishin të bënin me popullin maqedonas dhe shtetin si të tillë. Këto çështje, të ngritura në diskursin e elitave politike serbe, natyrisht që reflektonin në qasjet që ndërmernte elita politike e Maqedonisë në atë kohë për ndërtimin e shtetit, dhe si të tillë ata jepnin të kuptohej se Maqedonia, në të vërtetë, është në një aleancë të ngushtë idologjike me Serbinë, duke kamufluar politika që kishin të bënin kryesisht me shqiptarët e që reflektonin deri diku edhe qasjen e politikave serbe ndaj tyre. (Pettifer, 2001)

Me shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë, një ndër çështjet që e prekte drejtpërdrejt sigurinë e Maqedonisë ishte prezenca e ushtrisë jugosllave në kazemat brenda territorit të Maqedonisë. Duke qenë se drejtimi i ushtrisë atëbotë ishte nën ombrellën e shtetit serb, si subjekti dominues që kishte mbetur nga shpërbërja e Jugosllavisë, sjellja dhe veprimet e mundshme të tij do të shkaktonin një problem të rëndë për zgjedhjet në Maqedoni. Por, në sajë të bisedimeve që kishte presidenti i atëhershëm me lidërshpin serb të kohës, ushtria federative, që ishte dukshëm nën kontrollin serb, ra dakord që të largohej me gjithë pajisjet dhe personelin që kishte. (Ackermann, 1999)

Në një gjendje të tillë të mbrojtës së sigurisë pas largimit të ushtrisë federative, duhet përmendur prania e forcave ndërkombëtare të kombeve të bashkuara, që në bazë të

mandatit të tyre nga këshilli i sigurimit menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, kishin si detyrë – veç të tjerash – mbrojtjen dhe kontrollin e kufirit në pjesën me Federatën, përkatësisht Serbinë. Mandati i kësaj force u zgjerua me kohën, por ajo që duhet veçuar është se ajo kishte një observim të duhur dhe raportim për gjendjen përreth kufirit të Serbisë, që shërbente si parandalues ndaj ndonjë shpërthimi të mundshëm të situatës nga kufijtë veriorë me Serbinë. (Ackermann, 1999)

Njohja e pavarësisë së Maqedonisë nga ana e Serbisë nuk erdhi menjëherë, por në një periudhë të mëvonshme, në vitin 1996. Për këtë periudhë kohore, në varësi të zhvillimit të ngjarjeve në pjesët e tjera të rajonit, të tilla qenë pritshmëritë për zhvillimet e ngjarjeve mes këtyre dy shteteve. Nga ky moment kemi edhe njohjen e shteti të Maqedonisë, që rrjedhimisht është edhe njohja e kufijve të tij, që erdhi në një periudhë të mëvonshme me demarkacionin e vitit 2000. Që atëherë kemi një zhvillim të normalizuar të marrëdhënieve mes dy shteteve, por që efektet dhe ndërveprimet e njërit në raport me tjetrin përsëri lidhen në atë mënyrë që veprimet e njërit nuk zgjidhen ose prekin edhe tjetrin. Këtu duhen spikatur në veçanti sanksionet ekonomike ndaj Serbisë në vitet '90, që detyrimisht reflektojnë edhe në ekonominë e Maqedonisë.

Një qasje ndryshe në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve vërehet posaçërisht me ndryshimet politike që ndodhën në Serbi dhe me heqjen e sistemit autoritar nacionalist. Kështu qasja e Serbisë ndaj Maqedonisë dhe temat që pikasen në relacionet ndërmjet dy vendeve kanë të bëjnë me sigurinë rajonale në një kontekst ombrellë të sigurisë europiane, si orientim i përbashkët i dy shteteve, ndonëse ato përsëri mund të përqendrohen te diskursi lokal, si në rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe njohjes së saj nga ana e Maqedonisë.

5.3 Marrëdhëniet me Bullgarinë

Relacionet e Maqedonisë me Bullgarinë janë të lidhura pas një konteksti më të gjerë, bazuar në afërsinë gjeografike që kishte shteti bullgar nga fillimi i krjimit me territorin e Maqedonisë. Fërkimet e saj me territorin maqedonas datojnë diku para kongresit të Berlinit, ose ndryshe me marrëveshjen e Shën Stefanit, ku parashikohej që shumica e territorit gjeografik të Maqedonisë së atëhershme të ishte nën Bullgarinë. Ndonëse rishikimi i kësaj marrëveshjeje ndodhi shpejt, pikërisht në Kongresin e Berlinit, elita intelektuale dhe të tjerë i referohen shpesh në terma që reflektojnë po atë pozicion. (Roudometof, 2002, f. 40)

Duke u bazuar te njëjarjet historike, që nga ajo kohë Bullgaria ka pasur një qasje të ndryshueshme ndaj territorit gjeografik të Maqedonisë, në varësi të rrjedhave dhe situatave të çastit, duke pasur zgjerime dhe tkurrje të territorit të saj në këtë pjesë. Kjo ka ndodhur gjithnjë nën një garë të përhershme me aktorë të interesuar rajonalë, siç është Serbia apo edhe Greqia. Një rrjedhojë e tillë historike dhe fakti se një pjesë gjeografike e Maqedonisë është nën integritetin territorial të Bullgarisë, diskursi nationalist se ku qëndron ka vazhduar nga të dyja anët kohë pas kohe. Që nga pavarësia e Maqedonisë, aspekti territorial i debatit ndërmjet dy vendeve pothuajse nuk shfaqet, dhe Bullgaria, duke qenë gati si një shtet i etabluar tashmë, që ndër vendet e para që e njohu pavarësinë e Maqedonisë, me një interes të veçantë në zhvillimet politike në të. (Roudometof, 2002, f. 39)

Megjithëse njohja e pavarësisë erdhi që në momentet e para të shpalljes së saj, Bullgaria ka një qëndrim ndryshe kur vjen puna te gjuha maqedonishte, duke aluduar se ajo është identike apo edhe pjesë dialektore e bullgarishtes, duke qenë se ndan një afërsi të madhe me të dhe dallime të mëdha me gjuhët e tjera sllave të rajonit. Një gjendje e tillë pati

përshkallëzimin e vet, saqë zgjati për një periudhë të caktuar pa ndonjë qartësim pozicionesh, në veçanti nga pala bullgare. Qartësimet e para në lidhje me çështjen e gjuhës maqedone erdhën si pasojë e një marrëveshjeje ndërqeveritare, ku thuhet se gjuha maqedone flitet dhe shkruhet bazuar në kushtetutën maqedone dhe anasjelltas, duke iu referuar po ashtu kushtetutës për gjuhën bullgare. Kjo ishte një zgjidhje praktike që mundësoi shkëmbimin e dokumenteve në gjuhën maqedone, që ishte gjuha zyrtare, pa pasur nevojë që pala bullgare ta njohë atë si gjuhën e vet. (Engstrom, 2002)

Përvoja historike dhe afërsia gjeografike ka hapur një debat të rëndësishëm mes dy palëve, i përqendruar te kultura dhe identiteti i Maqedonisë. Pjesa bullgare evokon historikun e përbashkët, duke theksuar se populli maqedonas ka qenë pjesë përbërëse e popullit bullgar në rrjedhat historike, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimet për pavarësi të Bullgarisë nga Perandoria Osmane. Në raste të veçanta vihen re deklarata të zyrtarëve të lartë duke aluduar te historia, gjuha, kultura apo edhe te kisha e përbashkët, dhe kështu vijohet me qëndrimin se nuk ka se si të ndahen dy popuj që kanë këto attribute të përbashkëta. (Roudometof, 2002, f. 40)

Pozicione të tilla hasen që në ditët e para të ngritjes së çështjes së Maqedonisë në fund të shekullit XVIII, kur lëvizjet e ndryshme të kohës synonin ta fusnin Maqedoninë nën ombrellën e tyre të influencës. Një prej këtyre lëvizjeve që ka pasur një aktivitet të gjerë është edhe organizata e brendshme revolucionare maqedonase, e cila me kalimin e kohës u nda në disa segmente, dhe si e tillë pozicionohet me atë bullgare, dhe më tutje si maqedone. Por, ajo që vërehet është se kjo organizatë edhe sot e kësaj dite ka aktivitete në të dy shtetet, dhe kështu nuk reflekton mbi influencat e aktorëve të tjerë me interes për zonën, por vetëm për Bullgarinë (pas pavarësimit të Maqedonisë në pjesën e saj). (Roudometof, 2002, f. 41)

Një lëvizje e tillë karakterizohet nga fakti se kishte një veprimtari që shtrihej në një territor gjeografik që në kohët bashkëkohore përbën tre shtete të pavarura. Si e tillë ajo kishte një ideologji që përfshinte veprimtari në pjesë që sot përbëjnë entitete të ndryshme. Por, duke qenë se sot ajo funksionon me të njëjtin emër në dy shtete, duke evokuar të kaluarën historike të saj, hap çështje që ngjallin kërkime për institucionet e këtyre vendeve. Si në ndarjen historike të saj ashtu edhe në kushte bashkëkohore, ideja bazë e saj është bashkimi i njërës anë me tjetrën, në varësi të faktit se ku flitet për këtë bashkim, apo edhe thirrja për njësimin identitar. Por, ngaqë kjo lëvizje është themeluar në Greqi dhe për një kohë të gjatë në historikun e saj ka vepruar në territorin e këtij shteti, veprimtaria dhe thirrjet në këtë kohë tërheqin vëmendjen edhe të këtij entiteti shtetëror, duke ngjitur pyetje për gjendjen territoriale të tij. (Vankovska, 2000, f. 3)

Një tjetër çështje që i prek këto dy palë, si rrjedhojë e asaj që thamë më sipër, është edhe njohja reciproke e ekzistencës së pakicave të këtyre dy popujve në shtetet përkatës. Edhe kjo çështje lidhet me atë që ka të bëjë me trashëgiminë linguistike, kulturore, shoqërore etj., duke mohuar ekzistencën e të shprehurit nga ana e individit, pasi kjo do të çonte në njohjen reciproke të palëve. Kështu, edhe disa grupe të organizuara maqedonase që bëjnë thirrje identitare në Bullgari nuk lejohen që të artikulojnë qëndrimet e tyre. E njëjta situatë paraqitet edhe në Maqedoni. Në historikun pas pavarësisë kemi disa raste kur shprehje të tilla në publik kanë sjellë kërcënime si nga njëra palë ashtu edhe nga tjetra. (Roudometof, 2002, f. 41)

Pra, nga një këndvështrim i tillë mund të vëmë re se çështjet që prekin marrëdhëniet mes dy vendeve kanë në vetvete një rrjedhojë historike që lidhet me gjendjen e pjesëve gjeografike, por ndërveprimi shkon edhe më tutje, duke përfshirë edhe çështjen e identitetit

kulturator. Duhet theksuar se marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve nuk kanë ndonjë pengesë, ndonëse çështjet e lartëpërmendura paraqiten në sfondin e marrëdhënieve institucionale. Por, karakteri i marrëdhënieve në dekadën e fundit lidhet kryesisht me qasjet që kanë dy shtetet në lidhje me integrimet e mëtejshëm në Bashkimin Europian.

5.4 Marrëdhëniet me Greqinë

Një tjetër çështje e rëndësishme që e karakterizon Maqedoninë në lidhje me marrëdhëniet e saj me fqinjët, por që në njëfarë mënyre ka tejkaluar periferinë imediate të saj, duke u bërë si çështje e një shkalle më të gjerë ndërkombëtare, është kundërshtia për emrin. Marrëdhëniet me Greqinë, që nga momenti i pavarësisë janë karakterizuar jo vetëm me emrin e shtetit, por janë zgjeruar në disa tema, duke përfshirë edhe simbolet që ka përdorur fillimisht Maqedonia. Këto probleme, po ashtu, nuk janë të reja në kronologjinë e marrëdhënieve mes dy vendeve, por vazhdimësi historike që nga fundi i shekullit XIX. Kur Maqedonia shpalli pavarësinë e saj dhe aplikoi për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, problemi është rishfaqur duke pasur kundërshtime rreth anëtarësimit të saj në këto organizata.

Mosmarrëveshja mbi përdorimin e emrit Maqedoni ka qenë një ndër temat më të nxehta të politikës së jashtme të Greqisë në 20 vitet e fundit, duke lënë në hije marrëdhëniet mes dy vendeve për një numër çështjesh të tjera. Problemi është intensifikuar veçanërisht kur Maqedonia ishte e vendosur për të fituar pavarësinë gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë në vitin 1991. Por, duhet theksuar se në agjendën e dy shteteve ka qenë e debatuar në një përmasë tjetër, kryesisht nëpërmjet institucioneve federative, siç ndodhi pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, kur Partia Komuniste Greke vepronte në pjesën

veriore. Për më tepër, kemi disa raste kur çështja është lënë pezull gjatë kësaj kohe, pasi në agjendat përkatëse kishin çështje të një tjetër karakteri. (Craven, 1995, f. 206)

Dallimi për çështjen e emrit me Greqinë ka qenë pengesa kryesore e veprimtarisë së politikës së jashtme të Maqedonisë pas shaplljes së pavarësisë, sepse në marrëdhëniet me shtetet e tjera ajo haste pikërisht këtë çështje. Për anëtarësimin e plotë të saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, çështja kyçe është emri i saj. Më fund, anëtarësimi u bë i mundur në vitin 1994 nën emrin e përkohshëm të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Kjo nuk ndodhi si rezultat i njohjes së pavarësisë së saj nga ana e komunitetit të gjerë ndërkombëtar, por si rezultat i marrëveshjes së përkohshme të nënshkruar mes dy shteteve në vitin 1993. Marrëveshja e përkohshme solli një zgjidhje me afat të caktuar kohor mes dy palëve, ku rezultati kryesor që hapja e rrugës për Maqedoninë për t'u bërë anëtare e OKB-së nën emrin e përkohshëm të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, deri në një marrëveshje tjetër për një zgjidhje të përhershme mbi dallimet rreth emrit të shtetit me Greqinë. (Janev, 1999)

Pavarësisht fakteve të çështjes së emërimit të vendit, si një nga çështjet kryesore me Greqinë qenë edhe veprime të tjera që në prag të pavarësisë u këndërshtuan nga ana e saj, që kishin të bënin me simbolet e përdorura dhe veprime të tjera që lidhen me to, që ngritën një sërë shqetësimesh te pala greke. Në fakt, kur Maqedonia shaplli pavarësinë, nën flamurin e saj kishte edhe diellin gjashtëmbëdhjetë cepësh, që konsiderohet si simbol grek; ose simboli i Selanikut, i shfaqur në një monedhë përkujtimore në Maqedoni, që i rriti tej mase kundërshtimet greke ndaj paraqitjes identitare dhe simboleve prezantuese të Maqedonisë. Ky kundërshtim kulmoi me një sërë aktiviteteve të diplomacisë greke në vigjilje të shpalljes së pavarësisë, që patën si rezultat mosnjohjen e saj të menjëhershme nga

shtete të ndryshme dhe dështimin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, deri në marrëveshjen e përkohshme mes dy palëve. (Zachiriadis, 1994, f. 10)

Këto veprime të palës maqedone janë perceptuar si provokim ndaj identitetit kulturor helen, duke e detyruar Greqinë të vërë në funksion mekanizma të ndryshëm të politikës së jashtme. Kundërshtimi grek bazohet kryesisht në fakte historike, duke aluduar se përdorimi i tyre masiv shpreh edhe pretendime territoriale ndaj saj, siç mund të jetë pretendimi për provincën veriore, e emëruar me të njëjtin emër – Maqedoni. Kështu, duke shprehur këto shqetësime, në të njëjtën kohë ajo ngre dilema mbi sigurinë teritoriale të saj, si dhe ndaj çështjes së identitetit, dhe kështu aludon për mbrojtjen e interesave kombëtare dhe integritetin kulturor. Emri i shtetit është shprehje e qëndrimeve nacionaliste dhe një manifestim i pretendimeve territoriale të Maqedonisë ndaj krahinës veriore të Greqisë, e cila po ashtu quhet Maqedoni. (Zachiriadis, 1994, f. 11)

Një situatë shumë të rëndësishme hasim te çështja e formulimit të kushtetutës së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991, ku në artikullin 3 dhe 49, shprehimisht pala Greke shihte pretendime të qarta teritoriale. Në këta artikuj thuhet se kufijtë e “Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohen në përputhje me kushtetutën”, dhe duke vazhduar më tutje, ku, po në këtë kushtetutë, artikulli tjetër thekson dhe e lejon shtetin të ndërmarrë hapa për “kujdesin dhe të drejtat e maqedonasve që jetojnë në shtetet fqinje”. (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, art. 3-49)

Këto elemente konsideroheshin si pikënisje e perceptimeve për aspirata territoriale ndaj Greqisë, dhe si të tilla u panë edhe nga Komisioni European, dhe një vit më vonë ata u ndryshuan duke shprehur qartazi mosndërhyrjen në punët e brendshme të shteteve të tjera,

duke thënë se Maqedonia nuk ka pretendime territoriale, dhe ndryshimet e kufijve do bëhen në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

Dallimet për atë që përbën një provokim mbeten akoma në agjendat e politikave të brendshme, si dhe të politikave të jashtme të të dy vendeve. Gjenerimi i politikave të brendshme të të dy shteteve ka ndikuar shumë se si perceptohet politika e jashtme e shtetit tjetër, bazuar në diskurset e tyre të brendshme mbi synimet e tjetrit. Në këtë drejtim mund të veçohet se në të shumtën e rasteve çështja e emrit është përdorur si gjenerator mbështetës për elitat politike, duke krijuar një diskurs për ngritjen e nevojës për të ndërmarrë masa të veçanta jashtë procedurave ekzistuese. Kjo normalisht ka shkaktuar edhe gjenerimin e politikave të brendshme, që më pas janë transformuar në agjenda të politikave të jashtme, duke aluduar te kërcnimet që vijnë nga jashtë. (Stefanovski, 2009, f. 41)

Nënshkrimi i marrëveshjes së përkohshme ndikoi në normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve, duke rënë dakord të dyja palët që të përmbahen nga provokimet dhe veprimet që ngjallin pasiguri ndërmjet tyre. Simbolet e lartpërmendura u ndryshuan duke ndërruar flamurin dhe përmbajtjet kushtetuese. Si pasojë kjo filloi të reflektonte edhe në shkëmbimin e marrëdhënieve në fusha të tjera, që deri në ato momente pothuajse nuk ekzistonin. Duhet përmendur se në vazhden e këtyre ngjarjeve Greqia kishte vendosur një embargo ekonomike, që pasqyrohej dukshëm në ekonominë e Maqedonisë, që në rrethanat e kohës përkeqësohej edhe më shumë. Me nënshkrimin e marrëveshjes së përkohshme palët ranë dakord edhe për heqjen e embargos. (Zachiriadis, 1994, f. 13)

Por, pas një periudhe ku relacionet e dy shteteve shënuan një ngritje në shkëmbime, kryesisht në ato ekonomike, por edhe politike, siç ishte agjenda e Selanikut në vitin 2003, ku shtet e rajonit duke përfshirë edhe Maqedoninë hapën një kapitull drejt integritimeve

europiane, ku bënte pjesë edhe Greqia. Në Maqedoni ndodhi një ndryshim në drejtimin e qeverisë dhe në vitin 2006, qeveria e re, e udhëhequr nga VMRO (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase), papritmas mori disa vendime që Greqia i konsideroi provokuese. Qeveria filloi një sërë nismash me të cilat preknin përsëri marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, siç qe emërtimi i objekteve publike: aeroporti i Shkupit u bë Aeroporti Aleksandri i Madh, ose stadiumi i qytetit që u pagëzua Filipi II. (Stefanovski, 2009, f. 42)

Si rrjedhojë, aktet e lartpërmendura i ngritën edhe më shumë alarmet në Greqi, që në vitin 2008 lloboi për të fituar mbështetje mes anëtarëve të NATO-s për shtyrjen e anëtarësimit të Maqedonisë në këtë organizatë, derisa të zgjidhet çështja e emrit. Të njëjtat rekomandime janë vënë në dukje në lidhje me aspiratat e Bashkimit Europian në Maqedoni, nëpërmjet raportit të Komisionit Europian për përparimin e Maqedonisë, i lëshuar në vitin 2008. Ndër të tjera raporti tregoi se shqetësimi kryesor i Bashkimit Europian mbetej marrëdhënia për një fqinjësi të mirë, ku çështja kyçe ishte ajo e emrit të shtetit. (European Commission, 2011)

Në këto rrethana, gjendja dhe marrëdhëniet mes dy palëve kanë ngecur në periudhën e fundit, duke shënuar një aktivitet nga të dyja palët nëpërmjet negociatorit të caktuar prej Kombeve të Bashkuara lidhur me emrin. Përveç kësaj, të dyja palët kanë një dinamikë të ngritur të politikës së jashtme të tyre në komunitetin global lidhur me qëndrimet respektive. Maqedonia vijon të kërkojë njohje nga komuniteti ndërkombëtar me emrin e saj kushtetues, duke afimuar argumentet e saj në marrëdhëniet dypalëshe dhe në ato shumëpalëshe, ndërsa Greqia artikulon të sajat në të njëjtën mënyrë.

Marrëdhëniet mes dy shteteve dhe çështja që diskutohet mes tyre është e asaj natyre që i ngre raportet në një drejtim negativ, si, për shembull, kur bie fjala te mobilizimi i brendshëm lidhur me problematikën ashtu edhe me politikat e tyre të jashtme. Ndryshimet mes tyre janë identitare, por edhe të natyrës së kërcnimeve territoriale. Duke pasur parasyshë prirjen e përfshirjes së palëve të tjera dhe rëndësinë që ato mund të kenë në vendimet e njëres palë apo tjetres, kjo ndikon edhe te dinamikat e kompleksit të sigurisë dhe ndërtimit të saj.

5.5 Shqipëria

Marrëdhëniet e Maqedonisë me Shqipërinë karakterizohen nga një sjellje e ndryshme krahasuar me aktorët e tjerë fqinj. Kjo mund të jetë më tepër një pasqyrim i rrjedhave historike për të dy shtetet. Ajo karakterizohet me një agjendë që kryesisht artikullohet nëpërmjet nismave rajonale dhe më gjerë, dhe në sfond ka shqetësime të natyrës tjetër, që përkojnë me qëndrimet e palëve ndaj popullsisë shqiptare që është në Maqedoni.

Shpallja e pavarësisë së Maqedonisë e gjeti Shqipërinë në një situatë agonie, duke kaluar një tranzicion të thellë nga sistemi që ishte në këmbë deri në atë kohë. Por, pavarësisht kësaj, Shqipëria e njohu shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë që në çastet e para, pa ndonjë kushtëzim që do të cenonte integritetin e saj si shtet. Të dy shtetet kanë një preokupim në politikën e jashtme që është i orientuar drejt integriteteve europiane, dhe si të tillë kanë bashkëpunuar për nisma që mbështesin praktikën e fqinjësisë së mirë. Në këtë drejtim, Maqedonia dhe Shqipëria, së bashku me Kroacinë ishin iniciatore të nismës së Kartës së Adriatikut, ku nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmerrnin politika që kishin të bënin me integrimin e tyre në NATO.

Shqetësimet kryesore që ka artikuluar rishtazi shteti shqiptar kanë të bëjnë me gjendjen e popullsisë shqiptare që banon në Republikën e Maqedonisë. Këto shqetësime janë ngritur në momente të rëndësishme për marrëdhëniet e popullsisë shqiptare në Maqedoni dhe për zhvillime të brendshme të rëndësishme që nga pavarësia e Maqedonisë. Kjo ka ndodhur gjatë fazës së parë të shpalljes së saj, kur kishte shqetësime lidhur me gjendjen dhe prirjet e elitës politike në Maqedoni për krijimin e një shteti etnocentrik në një ambient multietnik, por edhe në raste konkrete, si gjatë përpjekjeve për të themeluar arsimin e lartë në gjuhën shqipe e kështu me radhë. (Pettifer, 2001)

5.6 Prania e strukturave ndërkombëtare dhe rajonale

Duke qenë se ngjarjet në rajonin e Europës Juglindore kishin një zhvillim të natyrës që përfshinin dinamika të krijuara në brendësi, mund të themi se ka elemente të një kompleksi sigurie.

Është evidente se në rajon ka një përvojë rrjedhash historike që në vetvete krijojnë veprime të ndërsjella me kushte ndërvarësie, por edhe marrëdhënie për të shprehur konsideratë për veprimet e tjetrit, dhe se si do perceptohet e gjithë kjo nga aktorët e tjerë dhe me çfarë implikimesh. Këto ndërveprime, në faza të ndryshme kohore kanë prodhuar segmente sigurie të veçanta për rajonin, që në varësi të interesave të shteteve është ndërtuar edhe debati në lidhje me çështjet. Kjo tregon se dinamika e këtyre segmenteve të sigurisë në njëfarë mase është e përzier, saqë me kohën ka efekte negative, ose në raste të caktuara edhe pozitive. Duke qenë se ka një përzierje të tilla, është e vështirë të përkufizohet qartë si një kompleks rajonal. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 386)

Duke pasur parasysh këto, më tej mund të vihet re se çështjet e sigurisë në rajon, jo vetëm që kanë prodhuar një masë ndërvarësie, por kanë krijuar edhe parakushte për përfshirje të atyre aktorëve që gjeografikisht nuk janë pjesë e Europës Juglindore. Përfshirja e këtyre forcave ka qenë e ndryshme, por në thelb ka rrjedhur në drejtimin e saj të brendshëm, duke kontribuar për një zgjidhje me impakte që variojnë në kohë. Segmentet e depërtimit të faktorëve nga jashtë kanë qenë nga më të ndryshmit, dhe këtu mund të theksojmë si ata të lidhur me identitetin shtetëror, stabilitetin politik dhe zhvillimin institucional, por edhe në fusha të tjera, si ato të zhvillimit ekonomik apo emigrimit. Një ndër arsytet e përfshirjes së këtyre aktorëve ka të bëjë me afërsinë gjeografike të rajonit, që lidhet me zhvillimet politike/ideologjike, por edhe me praninë e aktorëve të organizuar, siç është Bashkimi Europian apo NATO-ja. Doemos që përfshirja e këtyre faktorëve ka krijuar një dinamikë të caktuar për shtjellimin e çështjeve të sigurisë në rajon, duke u mbështetur te fakti se tanimë ata përbëjnë një institucionalizim, dhe kështu edhe platforma shtesë për trajtimin e atyre çështjeve që prekin aktorët rajonalë. (Buzan dhe Waever, 2003, f. 56-387)

Këto ndryshime, që mund të ndikojnë në gjendjen dhe formulimin e rajonit apo nënrajonit, kanë të bëjnë me ndryshimet që ndodhin në të e që mund të jenë të bazuara në shprehinë strukturore apo edhe atë ideologjike. Në raste të tilla, një rajon mund të zgjerohet ose tkurret në bazë të parametrave që zhvillon, duke ndryshuar edhe përbërjen e njësive të tij apo duke e shkrirë rajonin në një rajon tjetër. Në rastin e Europës Juglindore, gjatë periudhës së fundit vërehet fillimisht një tkurrje, sepse njësi që kanë qenë në territorin e saj, për arsye të ndryshme largohen nga ky nënkompleksi i sigurisë. Një rast i tillë është Sllovenia, e cila iu bashkua rajonit europian më herët. Politikat integruese në Bashkimin

European tregojnë një dinamikë të tillë edhe për shtetet e tjera të rajonit, por për nevojat e këtij studimi do ndalemi te rasti i Maqedonisë. (Buzan dhe Waeber, 2003, f. 53)

Në bazë të këtyre parametrave ndryshimesh dhe evoluimesh, kemi mundësinë të evidentojmë karakteristikat që e përkufizojnë rajonin. Meqë politikat integruese të rajonit janë të drejtuara drejt integrimeve europiane, atëherë është e rëndësishme të saktësohet se cili është lloji i kompleksit të sigurisë ku ai bën pjesë. Por, ngaqë kemi të bëjmë edhe me aspiratat e shteteve për integrim, atëherë edhe një kuptim mbi integrimin mund të shpalosë natyrën e marrëdhënieve mes shteteve pretendente dhe atyre që tashmë janë anëtarë të Bashkimit European.

Në këtë drejtim mund të theksohet se Bashkimi European, duke qenë se ka institucione të cilat merren me sigurinë deri në njëfarë mase, atëherë mund të themi se ai i takon asaj që në disa teori quhet edhe si Komuniteti i Sigurisë, sepse përbëhet nga disa shtete që krijojnë mekanizma të përbashkët veprimi, duke pasur si themel elementet e formësimit strukturor të shtetit. Kjo nënkupton se shtetet që bashkohen ndajnë së bashku norma, vlera dhe, në njëfarë mënyre marrin identitetin e tyre të veçantë duke verpuar bashkërisht në forma institucionale dhe duke u lidhur me njëri-tjetrin në fusha të panumërta, duke futur këtu edhe sigurinë aty ku ndajnë interesa të përbashkëta. (Deutch, 1957)

Komunitetet e Sigurisë mund të jenë gjithëpërfshirëse në çdo aspekt gjatë veprimit, me synimin për të arritur ndryshim përmes mjeteve jo të dhunshme, që në momente të caktuara mund të paraqiten si komunitet sigurie ndërshtetërore, duke krijuar aleanca të ndryshme, që me raste marrin formën strukturore nëpërmjet institucioneve që krijojnë. Normalisht shtetet duhet të ndërmarrin hapa konkretë ndërmjet tyre në krijimin dhe

institucionalizimin e procedurave ku mund të artikulohen interesat e tyre. Institucionalizimi në këtë rast shihet si një metodë ku frika dhe kanosja eliminohen nëpërmjet komunikimit, dhe krijohen mundësi për shmangien e përdorimit të forces. Në fakt, kjo qasje kërkon një analizë të detajuar të aspekteve integruese dhe teorive mbi integrimin, në mënyrë që ta kuptojmë qartë shmangien e dhunës në arritjen e sigurisë së përbashkët. (Vayrynen, 2000)

Disa nga teoritë që shtjellojnë proceset e integrameve janë të bazuara në një fokus që debaton rreth çështjeve që kanë të bëjnë me institucionalizimin, pasi ky i fundit shpjegon ndikimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në themelimin dhe krijimin e normave, të drejtave dhe detyrimeve të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, duke promovuar nevojën për të zgjidhur problemet dhe mosmarrëveshjet përmes institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare ose rajonale. Në këtë drejtim vëmendja e teorive të integritit është e përqendruar te analiza e institucionalizimit historik, pasi aktualisht shpjegon thelbin e integritit rajonal, siç është edhe rasti i integritit të BE-së dhe shteteve që aspirojnë integrimin në të. Për më tepër, kjo siguron një bazë për të kuptuar më mirë procesin e futjes së institucioneve kombëtare në ato të institucioneve zyrtare, për shtete të caktuara që kanë marrë drejtimin e bashkimit në një organizim të përbashkët. (Chryssochoou, 2001)

Një ndër çështjet që duhet theksuar kur flitet për teoritë që analizojnë integrimin është se kjo duhet parë nga një këndvështrim krahasues, duke e vendosur atë në dy drejtime, që në thelb reflektojnë mbi evoluimet, si të brendshme ashtu edhe ato të jashtme. Kjo nënkupton se një analizë e thukhtë e politikës së brendshme dhe të jashtme të shteteve aspirante dhe atyre që tashmë janë në këtë kompleks, është e nevojshme për t'i kuptuar drejtë forcat dhe mekanizmat e ndryshimit për shtetet aspirante dhe ato brenda. Zgjerimi si

koncept paraqet jo vetëm aspektin gjeografik, por edhe ndikimin dhe transformimin institucional të atij vendi që aspiron integrimin, në këtë rast në BE, duke aplikuar ndryshime cilësore jo vetëm në regullimin e institucioneve, por edhe duke ndarë vlera dhe norma të njëjta për të vepruar politkisht në kuadër të institucioneve të përbashkëta. (Faber, 2009)

5.7 Konteksti i sigurisë së Maqedonisë nga këndvështrimi i pranisë ndërkombëtare/rajonale

Duke pasur parasysh historikun e afërt të Maqedonisë dhe zhvillimet në rajon, është e dukshme që sfidat me të cilat ajo ballafaqohej ishin shumëpërmasore dhe kishin herë karakterin e kërcënimeve nga jashtë (si pasojë e zhvillimeve në rajon), herë atë të sfidave për stabilitetin e brendshëm të saj. Duke qenë se ajo e shpalli pavarësinë në një kohë kur vrullet rajonale mund të ndikonin në stabilitetin e saj, mbështetja parësore ishte prania e instrumenteve ndërkombëtare për të siguruar një tranzicion si politik ashtu edhe ideologjik. Kjo prani, në rastin e Maqedonisë ka pasur karakter të ndryshëm, duke filluar nga ajo e Kombeve të Bashkuara dhe duke vazhduar me një prani të NATO-s dhe BE-së. Në njëfarë mënyre ato kanë shërbyer për ta pajisur Maqedoninë me një ombrellë mbrojtëse nga kërcnimet e ndryshme, por në të njëjtën kohë kanë shërbyer edhe si një mekanizëm tranzicioni për institucionet e brishta të saj.

Përfshirja e komunitetit ndërkombëtar në Maqedoni, në të shumtën e rasteve ka qenë në rolin e një pale të tretë në akord me problemet kryesisht të natyrës së sigurisë, por duke mos anashkaluar edhe ato të sferave të tjera, si ato ekonomike etj. Duke qenë se pas luftrave etnike në ish-Jugosllavi filloi t'i orientonte politikat e saj në drejtim të integritimit

europian, për rrjedhojë edhe marrëdhëniet e tyre dalin si përparësore kur bëhet fjalë për ndërvlerësinë e raporteve me faktorë të jashtëm. Në këtë kuptim kemi edhe analizën e marrëdhënieve të Maqedonisë me Bashkimin Europian, por normalisht duke theksuar që një rol të rëndësishëm në formulimin e politikave të saj në marrëdhëniet me jashtë në fusha të ndryshme kanë edhe shtete dhe aktorë të tjerë.

Duke qenë se në këtë fazë studimi përqendrohet te sfidat dhe mundësitë rajonale, detyrimisht që marrëdhëniet e saj me BE-në si një organizatë rajonale dhe aktor i rëndësishëm, edhe segmente kyçe të analizës fokusohen te marrëdhëniet me të. Gjatë analizës së përfshirjes së saj shquhen aspekte të ndryshme, duke filluar me praninë e saj me forca ushtarake dhe duke vazhduar me asistencën ekonomike dhe reformat strukturore institucionale. Kjo është e rëndësishme për t'i kuptuar më qartë përballjet dhe sfidat që tejkaloi Maqedonia në rrugëtimin e saj qysh prej pavarësisë, si në plan të jashtëm ashtu edhe në atë të brendshëm.

Maqedonia ka pësuar dy transformime të mëdha historike që nga pavarësia e saj: konsolidimi i shtetit nga brenda dhe sfidat rajonale, që në vazhdimësi kanë pasur mundësinë e destabilizimit të mundshëm të vendit. Secili prej këtyre transformimeve sfidues përbënin një mundësi strategjike dhe themelore që e ka çuar Maqedoninë në prag të anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Europian. Këto arritje kanë ulur dilemën e aftësisë së saj, jo vetëm për të formuar një demokraci të duhur funksionale, por edhe përmes këtyre anëtarësimeve të rëndësishme për të siguruar një ombrellë të madhe për sfidat e sigurisë dhe performancës ekonomike. Këto dy procese mund të konsiderohen si kërcënim, nëse institucionet shtetërore nuk kanë qenë në gjendje për t'iu përgjigjur, por

edhe mundësi nëse institucionet shtetërore dhe elita politike kanë gjetur guximin – në kornizën e dhënë – për t’u bërë anëtarë në organizatat e lartpërmendura.

Marrëdhëniet e Maqedonisë me Bashkimin European kanë filluar në vitin 1992 me Komunitetin European (KE) të atëhershëm, në forma të ndryshme, por që spikasin më tepër ato ekonomike, duke mos anashkaluar edhe ato politike. Kulmi i marrëdhënieve u arrit në vitin 2005, kur Maqedonia, në sajë të progresit të reformave dhe implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, fitoi statusin e vendit kandidat për aderim në Bashkimin European. Këto marrëdhënie kanë qenë thelbësore në çështjet që kishin rëndësi të veçantë për Maqedonin gjatë themelimit dhe ngritjes së institucioneve të saj, por njëkohësisht duke shërbyer si një platformë për ndërtimin e marrëdhënieve të saj me shtetet fqinj dhe vendet e tjera në rajon dhe më gjerë. (Risteska, 2007)

Në vllugun e turbullirave dhe procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, kur Maqedonia synonte pavarësimin e saj, përfshirja më e drejtpërdrejtë e Komunitetit European erdhi përmes Komisionit të Badenterit, që ishte një trup i specializuar në trajtimin e kriterëve të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe formimin e republikave të reja. Komisioni ishte themeluar si një trup i ligjshëm që këshillonte KE-në se cilat republika të Federatës Jugosllave i plotësojnë kriteret për t’u pavarësuar. Rekomandimi i Komisionit të Badenterit për Maqedoninë ishte në favor të pavarësisë së saj, por ajo hasi pengesa që në njëfarë mënyre shfaqin edhe brishtësinë dhe sfidat me të cilat përballej rajoni. Sidoqoftë raporti i komisionit ishte një paralajmërues dhe një sinjal se pavarësia e Maqedonisë do të pranohej me përmirësimet dhe adoptimet që kërkoheshin si nga Maqedonia ashtu edhe nga aktorët e tjerë. (Ilievski, 2007, f. 13)

Rekomadimet e Komisionit të Badenterit kishin në vetvete disa mesazhe për Maqedoninë, duke implikuar rëndësinë me synimet me të cilat do përballet në një periudhë të menjëhershme pas referendumit të saj për pavarësi. Në njërin anë këshillimet e komisionit bartnin në vetvete rekomandime për marrëdhëniet e jashtme, duke futur këtu raportin e saj me fqinjët dhe, nga ana tjetër, duke njohur plotësimet e kushteve për pavarësi hapi rrugët për zhvillimet e mëtejshme të saj drejt arritjes së këtij qëllimi. Këshilli European i pranoi rekomandimet e komisionit të lartëpërmendur duke përmendur hapa të mëtejshëm që duheshin ndërmarrë në plotësimin e kushteve që i kishte vendosur. Këto kushte shihen edhe si një udhërefyes për marrëdhëniet e saj me fqinjët në gjendje pavarësie. (Ramcharan, 1997, f. 1270)

Në kushte të tilla debati i jashtëm për pavarësimin e Maqedonisë u zhvendos në kufij më të gjerë, duke u transferuar te Kombet e Bashkuara pothuajse me të njëjtat çështje që diskutoheshin në aspektin rajonal. Emërimi i saj dhe për pasojë edhe aspiratat e saj ndaj fqinjëve, si në aspektin identitar ashtu edhe në atë territorial ngelën në krye të debatit, duke nxjerrë edhe rekomandime me një qasje të njëjtë si ato të mëparshmet nga ana e Komisionit të Badenterit. Çështja arriti edhe te Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke sjellë përfundime, siç qe rezoluta 817 e vitit 1993, me të cilën Maqedonisë i njihej e drejta për pavarësi, por me një emër të përkohshëm: Ish-Republika e Federatës Jugosllave. Kjo rezolutë ishte pasojë e kundërshtimit grek ndaj çështjeve të identitetit dhe emrit të saj, nga ku kemi edhe rezolutën e mëvonshme po nga Këshilli i Sigurimit, në të cilën të dyja palët rekomandohen të vazhdojnë përpjekjet e tyre për një kompromis nën mbikëqyrjen e skeretarit të përgjithshëm të organizatës. (Janev, 1999, f. 156)

Në bazë të këtyre rrjedhave, KB-ja vazhdon të jetë e përfshirë në çështjen Maqedoni, por me një prani më të drejtpërdrejtë, ku futen edhe trupa paqëruajtëse. Ndonëse trupat në Maqedoni ishin një zgjerim i mandatit të atyre në Bosnje, – UNPREDEP (United Nations Preventive Deployment Force) – ato ishin me një mandat të përcaktuar për të monitoruar zonat kufitare në verilindje të Maqedonisë, për të dhënë ndihmë në forcimin e sigurisë në vend dhe për të zbuluar zhvillimet që mund të cenojnë qëndrueshmërinë e Maqedonisë. Kjo forcë e ftuar nga ana e presidentit të atëhershëm Kiro Gligorov, ishte autorizuar nëpërmjet një rezolute të Këshilit të Sigurimit, numër 795, e vitit 1992, dhe vazhdoi të ishte në vend me mandat dhe kompetenca të zgjeruara kur Maqedonia fitoi anëtarësinë e saj në KB. (Cierco, 2006, f. 4)

Prania e UNPREDEP-it ishte e rëndësishme si në aspektin rajonal të sigurisë ashtu edhe në atë të brendshëm. Në veçanti merrte rëndësinë e vet në drejtim të përfshirjes dhe bashkëpunimit me organizmat rajonalë për sigurinë. Një rast i tillë që vlen të kujtohet është bashkëpunimi me OSBE-në dhe publikimi i një raporti rreth një parajlamërimi të hershëm, duke i informuar palët e përfshira për çështjet që mund të ishin sfiduese për sigurinë e Maqedonisë. Zgjerimi i mandatit të UNPREDEP-it dhe më tej bashkëpunimi me OSBE-në vijoi me negociata të natyrës që lidheshin me sfidat e brendshme për Maqedoninë, siç ishte marrëveshja e arritur përmes komisionerit për pakicat pranë OSBE-së lidhur me problemin e arsimit në gjuhën shqipe, për themelimin e universitetit të Europës Juglindore me seli në Tetovë. Misionit i përfundoi mandati në vitin 1999 për arsye të një vetoje në Këshilin e Sigurimit nga ana e anëtarit të saj të përhershëm të Republikës Popullore të Kinës, si reagim ndaj vendosjes së marrëdhënieve diplomatike nga ana e Maqedonisë me Tajvanin. (Koinova, 2011, f. 8)

Bashkimi European, si një organizatë më e strukturuar, gjatë periudhës në fjalë ka pasur një marrëdhënie që karakterizohej nga dy segmente në angazhimet e tij në Maqedoni. Në njërën anë kanë qenë masat e parashikuara dhe mbështetja afatgjate për reformën strukturore të Maqedonisë, e drejtuar nga forcimi i zhvillimit ekonomik; dhe, në anën tjetër ishin angazhimet për respektim të parimeve dhe normave demokratike dhe sundimit të ligjit. Kjo mbështetje ka ardhur nëpërmjet programeve të tilla si PHARE dhe CARDS, programe këto që ndihmojnë shtetet që aspirojnë anëtarësimin në BE për të transformuar strukturën e tyre të funksionimit të brendshëm konform normave ekzistuese në BE. Maqedonia përfitoi nga Bashkimi European fonde të destinuara për reforma të nevojshme strukturore për të kryer transformimet dhe konsolidimin jo vetëm të sektorit ekonomik dhe financiar, por edhe në drejtim të kohezionit shoqëror, që në këtë periudhë ishte shumë i rëndësishëm. Qëndrueshmëria dhe kohezioni i brendshëm shoqërorë ishin pika të ndjeshme të Maqedonisë gjatë kësaj kohe, për shkak të një trashëgimie që binte ndesh me sfidat e kësaj periudhe dhe mënyra se si ballafaqohej Maqedonia me këto sfida. (Schneckener, 2002, f. 26)

Aspekte të rëndësishme të marrëdhënieve mes BE-së dhe Maqedonisë shënohen në vitin 2001, kur Maqedonia u përball me një konflikt që kishte potencialin e përsëritjes si në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Në vigjilje të një situatë të tendosur mes dy entiteteve më të mëdha në shtet, ai shqiptar dhe maqedon, arriti të nënshkruante një marrëveshje stabilizim-asociimi me BE-në, që i ndihmoi për përparësinë e politikave të nevojshme në transformimin e saj kushtetues, shoqëror dhe ekonomik. Marrëveshja e stabilizim-asociimit është një mjet i dhënë enkas për shtetet e Europës Juglindore për të negociuar kushtet dhe platformat e anëtarësimit në Bashkimin European. Si vendi i parë që pat nënshkruar këtë

marrëveshje, Maqedonai fitoi një perspektivë të qartë të anëtarësimit në BE, për më tepër ndihmë të rregullt ekonomike, përmirësim të marrëdhënieve tregtare dhe një dialog të avancuar politik me BE-në dhe shtetet anëtare të saj. (Cierco, 2006, f. 2)

Megjithëse në krahasim me disa nga vendet e rajonit Maqedonia ishte relativisht më e qëndrueshme në nivel shoqëror, duke pasur një shkallë ndërveprimi shoqëror që artikulonte një pjesëmarrje të përfaqësuesve politikë shqiptarë në qeverisje, ajo nuk bazohej te ndikimet dhe nveojat e komunitetit shqiptar, por në një nivel komunikimi me elemente korruptivë. Si një vend që aspirojnë të bëhet anëtare e Bashkimit European ajo merrte udhëzimet e përmbushjeve të detyrimeve, siç ishin kriteret e Kopenhagenit, që kërkojnë nga vendi të vendosë një demokraci funksionale. Kjo ishte një nxitje për të ndërmarrë hapa konkretë drejt reformave të nevojshme, si strukturore dhe institucionale, që do të çonin drejt një koherence shoqërore dhe etnike. Kështu, duke pasur marrëdhënie të afërta me BE-në, në një fazë të rëndësishme të historikut të saj ajo hapi rrugën për ndryshimet kushtetuese nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, për një kohezion shoqëror, por edhe për ndryshime institucionale përmes ndihmës që i ofronte marrëveshja e stabilizim-asociimit. Marrëveshja kornizë e Ohrit dhe përparimi që Maqedonia bënte në zbatimin e saj u bë një pikë referuese e rëndësishme në raportet e njëpasnjëshme të progresit vjetor të lëshuara nga Komisioni European. (Schneckener, 2002)

Për më tepër, në sajë të përshkallëzimit të mundshëm të konfliktit në Maqedoni, dy platforma të rëndësishme të politikës së jashtme dhe sigurisë së Bashkimit European morën formë në çështjet e sigurisë së Maqedonisë. Duke qenë se komisioneri i lartë në atë kohë ishte edhe përgjegjës i politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, ai luajti një rol të posaçëm për lehtësimin e dialogut politik të palës shqiptare dhe asaj maqedonase. Ndonëse

një diplomaci e tillë nuk arriti rezultatet e duhura për arsye të ndryshme, ajo vazhdoi përfshirjen e saj përmes një të dërguari special dhe misionit monitorues në vendet e përfshira në konflikt. Kjo i shërbeu shumë Maqedonisë që të gjente një rrugëzgjidhje që do të sillte masa stabilizuese dhe ndërtimin e mirëbesimit mes palëve. (Schneckener, 2002)

Në periudhën që vijoi BE-ja dërgoi në Maqedoni misionin e saj të parë ushtarak për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të stabilizimit dhe mbështetjen për implementimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit. Ky mision, ndonëse trashëgoi atë të NATO-s, kishte si qëllim patrullimin në zonat ku ishin zhvilluar përplasjet. Ashtu si misioni paraprak, edhe ky ishte me ftesë të autoriteteve maqedonase, i mbështetur me një rezolutë të Këshillit të Sigurimit, me nr. 1371. Rëndësia e këtyre ngjarjeve për Maqedoninë është se ajo kishte një koordinim mes disa organizatave rajonale të sigurisë, siç është ajo me NATO-n dhe OSBE-në, që i ofronin asaj një ombrellë sigurie kundër përshkallëzimit të situatës. (Lynch dhe Missiroli)

Maqedonia ishte në gjendje t'i arrinte këto transformime përmes një përfshirjeje aktive të komunitetit ndërkombëtar, konkretisht të BE-së dhe ndihmës që ofroi në këtë proces si një palë e tretë për të arritur reformat e nevojshme afatgjata. Ndihma ishte në shumë drejtime dhe u pranua nga elita politike e Maqedonisë si një mjet për të përmbushur aspiratën e opinionit publik për t'u bërë antare e BE-së. Një perceptim i tillë i brendshëm u dha mundësi institucioneve europiane për të marrë pjesë aktive në afrimin e Maqedonisë me BE-në, duke kontribuar me burimet e duhura për të plotësuar transformimin e nevojshëm.

5.8 Konkluzione

Ky kapitull pasqyroj disa nga segmentet që karakterizojnë marrëdhëniet e Maqedonisë me fqinjët e saj dhe trajtoi disa nga agjendat në diskursin e raporteve të tyre, duke spikatur edhe një kontekst më të gjerë, që kalon nga niveli nënrajonal deri tek ai rajonal. Nga një kontekst historik, rajoni i Europës Juglindore ka qenë një arterie e rëndësishme fërkimesh që kanë influencuar ngjarje të ndryshme në një kontekst më të gjerë. Nisur nga kjo, konteksti historik ka pasur një rol të rëndësishëm jo vetëm për përkufizimin ideologjik, por edhe për ndërveprimet e shteteve, duke krijuar një dinamikë ndërveprimi që ka pasur segmente autoktone rajonale. Për pasojë, çështjet e njëres palë prekin palën tjetër, dhe përfshijnë shumë më tepër aktorë. Duke ndërlidhur veprimet e njëres palë detyrimisht inkuadrojnë një palë tjetër, dhe zgjidhja apo ngritja e problematikës nuk merr kahjen e duhur pa prekur shqetësimin e tjetrit.

Çështja Maqedoni në këtë kontekst paraqitet si një kornizë ku interesi i palëve që e rrethojnë shpreh shqetësime apo edhe kërcënime bazuar në problematikën për të cilën bisedohet. Ndërveprimet e palëve kanë të bëjnë si me çështjen identitare ashtu edhe me atë territoriale dhe kulturore. Dinamika e veprimeve në rajon ndërthuret aq shumë brenda saj, sa që mund të themi se ajo përbën një kompleks sigurie. Por, duke qenë se në të njëjtën kohë ajo përthith tema që vijnë edhe nga jashtë, sipas përkufizimit të Buzan-it ngelet një nënkompleks që varet edhe nga dinamika të tjera jashtë rajonit. Shtetet e rajonit të Europës Juglindore kanë kaluar në një lloj tranzicioni të dinamikës së sigurisë duke krijuar fushën e veprimit të tyre për çështjet e sigurisë, por në të njëjtën kohë diskursi i sigurisë zgjerohet duke e fokusuar drejtimin e diskursit të konteksti rajonal nëpërmjet projektit europian apo edhe NATO-s.

Duke prezantuar çështjet e sigurisë së Maqedonisë nga pikënisja e relacioneve dhe problematikave me shtetet fqinj, vërehet një diskurs që shqyrton ndërvarësi të sigurisë në një dimension negativ, duke shprehur qartazi segmente të një mosbesimi dhe perceptimi të keq. Aty pikaset se çështjet e emërimit të shtetit prekin Maqedoninë dhe Greqinë, diskursi i të cilave nxjerr në sipërfaqe qëndrime që drejtojnë kah një zhvillim negativ i marrëdhënieve. Po një dinamikë e tillë lidhur me marrëdhëniet e Maqedonisë me Bullgarinë, duket në fillet e saj, që me raste vijon të mbajë të përqendruar opinionin e palëve të përfshira. Nisur nga kjo dinamikë ndërveprimesh ndërmjet fqinjësisë së afërt kemi një transformim të kursit, nga ai negativ drejt atij më pozitiv, me një përfshirje të konceptit integruar të pothuajse të gjithë aktorëve, duke i trajtuar çështjet në forma të tjera, ku zgjidhjet shihen nga koncepti i një sigurie të përbashkët.

Në vazhden e këtyre transformimeve u pasqyruan transformimet e çështjeve të sigurisë nga një ndërveprim i kontekstit nënrajonal, dhe se si ato, në kuadër të projektit dhe kompleksit të gjerë evropian, u shndërruan në mundësi bashkëpunimi dhe konsolidimi shtetëror. Ky transformim i sfidave të rajonit ndodhi për shkak të një zhvendosjeje të perceptimeve për çështjet nga jashtë, në këtë rast nga ato europiane tek ato të brendshme. Kjo kapi shumicën e vendeve të rajonit duke përfshirë edhe Maqedoninë. Ky transformim përbën një mundësi për Maqedoninë dhe vendet e rajonit, që të sigurojnë një platformë nga ku do të shtjellohen çështjet e sigurisë që lidhen me më shumë aktorë në një diskurs institucional përmes nismave integruar të çdo shteti në një komunitet sigurie.

KAPITULLI VI: KONTEKSTI I SIGURISË SË BRENDSHME

6.1 Dilemat dhe arsyet e përshkallëzimit (sigurimit) të brendshëm

Në sajë të ndryshimeve të mëdha gjeopolitike që ndodhën me mbarimin e Luftës së Ftohtë dhe zhvendosjes së qasjes për sigurinë, duke evoluuar nga një bazë tradicionale ku analiza përqendrohej te fuqia, akumulimi dhe aplikimi i saj nga shteti në një sistem anarkik dhe zgjerimi i saj si në nivele ashtu edhe në fushat e analizës, jep mundësinë e një qasjeje më ndryshe ndaj sigurisë. Për më tepër, me rritjen e sfidave dhe intensifikimin e ndërveprimeve që filluan të shfaqen, u paraqit nevoja e një zgjerimi dhe thellimi të analizës mbi sigurinë. Zgjerimi i niveleve të analizës nënkupton shtimin e objekteve referues që kanë të bëjnë me sigurinë si në qasjet tradicionale, por tashmë me një fokus të zgjeruar duke inkurporuar edhe njësi shtesë që analizohen.

Duke u nisur nga kjo pikë, mënyra e shpjegimit të analizës së nivelit e zhvendos përqendrimin fizik duke shpjeguar fenomenet dhe relatat shoqërore nga një pozicion gjeografik ku ndodhin ndërveprimet, dhe si të tilla mund të japin shpjegime për shkaqet dhe rezultatet e këtyre ndërveprimeve. Në të shumtën e rasteve këto analiza lidhen me njëra-tjetrën duke zgjeruar nivelin e implikimit të ndërveprimeve, dhe më tej duke hapur mundësinë për nevojën e një analize dhe diskursi mbi këto fenomene. Shkolla e Kopenhagenit ka ofruar një kornizë teorike të aspekteve të analizës mikro dhe makro bazuar në këto premisa, duke zgjeruar mundësinë si për një analizë të gjerë fushash ndërveprimi ashtu edhe për nivele analize që mundësojnë dhe mund të japin shpjegime për një kuptim më të lehtë të sfidave të sigurisë për aktorët në një kontekst të ndryshueshëm të sigurisë globale.

Ndonëse shteti dhe sovraniteti i tij kanë qenë objekti kryesor ku janë përqendruar debatet mbi sigurinë, me zgjerimin dhe thellimin e analizës së saj, siguria shoqërore filloi të analizohet si një objekt referues krahas asaj shtetërore. Kjo duke u nisur nga fakti se territori në të cilën bazohet ajo dhe sistemi politik që legjitimon institucionet shtetërore mund të shfaqë segmente që dalin jashtë kontrollit dhe përfshirjes së këtyre institucioneve, për arsye të ndryshme, por që në thelb paraqesin një pavazhdimësi të shtrirjes së legjitimitetit të saj të plotë. Për qëllimet e këtij studimi, siguria shoqërore në këtë rast ka të bëjë me përzierjen e përkatësisë etnike në një shtet, ose e thënë ndryshe me diferencat se çfarë lloj legjitimiteti paraqet shteti për entitetet e ndryshme, dhe që për rrjedhojë perceptimet e ndryshme mund të paraqesin çarje në kohezionin e brendshëm të tij. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, f. 191)

Qasja e Shkollës së Kopenhagenit ka një segment neorealist në këtë drejtim, sepse ajo e bazon objektin e saj referues në shkallë/nivele njësishe, por në të njëjtën kohë e pozicionon shoqërinë në objekt referues jo në shkallën e individit, por të një komunitet të organizuar deri në masën që të artikulojë qëndrime për kanosjet që i paraqiten identitetit të saj. Njëkohësisht është në një nivel organizativ që të ndërmarrë masa dhe të mobilizojë veprime në mbrojtje të saj. Nisur nga kjo duhet theksuar se me zgjerimin e analizës së sigurisë duke inkorporuar sektorin e sigurisë shoqërore veçohet lidhja e rëndësishme mes saj dhe identitetit. Nëse shteti kujdeset për kërcënimet ndaj sovranitetit, atëherë komunitetet shoqërore, kërcënimet ndaj mbijetesës i heqin nga identiteti i komunitetit, që është i organizuar politikisht dhe për pasojë paraqitet nevoja e ndërmarrjes së masave për të gjetur mënyra mbrojtjeje për identitetin nga kërcënimet e perceptuara. Pra, për të analizuar sigurinë shoqërore së pari duhet të kemi një grup të organizuar mirë, me shenja

identitare të spikatura, i cili është në gjendje të garojë për mbrojtjen e këtij komuniteti dhe të sigurojë kushtet e nevojshme të mbijetesës brenda kornizave normative të kulturës, identitetit kombëtar, gjuhës dhe normave të tjera me të cilat identifikohet. Ky komunitet, në varësi të sistemit dhe organizimit të shtetit mund të mos përputhet me agjendën e shtetformimit, dhe në kushte të tilla mund të ndjejë kërcënim ndaj identitetit të tij, dhe kështu të ndërmarrë masa për t'u mbrojtur. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, f. 120)

Duhet theksuar që në fillim se qasja e Shkollës së Kopenhagenit jep mundësinë që nëpërmjet nivelit të analizës të zbardhë marrëdhëniet që kanë të bëjnë me shoqërinë si një komunitet me identitet të formësuar dhe me kapacitete të mjaftueshme për të marrë masa të jashtëzakonshme në mbrojtje të identitetit. Duke pasur si objekt referues një grup shoqëror duhet të shkojmë drejt një analize sigurimzimi, në mënyrë që të analizojmë aktin e fjalimit që referohet ndaj një komuniteti etnik dhe që shpaloset si kërcënim ndaj identitetit të tij. Pra, një kërcënim paraqitet në rastet kur aktivitetet të cilat ndërmerren nga aktorët kalojnë në një fazë që janë jashtë normave normale të funksioimit politik, duke u shpalosur si një problem urgjent me nevojë për zgjidhje të përshpejtuar nën masa të jashtëzakonshme. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, f. 23)

Ky proces sigurimi shfaq argumentet për karakterin ekzistues të kërcënimit, dhe si i tillë kërkon mbrojtje duke ndërmarrë hapa jashtë normave, për të mbrojtur kështu çështjen për të cilën ka kërcënim. Që procesi i sigurimzimit të jetë i plotë, duhet që kërcënimi të jetë i pranishëm, pra të jetë real, dhe kjo mund të jetë në formë të shprehur ose me veprime të tjera që japin të kuptohet se kërcënimi ekziston, dhe në këtë mënyrë lind nevoja e një trajtimi urgjent nën masa të jashtëzakonshme; dhe për më tepër, veprimet e mëtijshme mes aktorëve të përfshirë të prodhojnë efekte që prekin palët në fjalë. Një analizë e tillë

është e rëndësishme ngaqë punimi ka si objekt referues ato grupe shoqërore që kanë një rol të rëndësishëm – nëse aktorët siguroes i kuptojnë drejtë dinamikat e ndërveprimeve shoqërore dhe se si mund të paraqiten kërcnuese. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, f. 24-25)

Nëpërmjet aktorit referues, në këtë rast komuniteti etnik në Maqedoni, kapitulli synon të zbulojë dinamikën e shqetësimeve që u ngritën në lidhje me kërcënimet ndaj mbijetesës së karakterit të tij brenda kufijve normalë për ripërtëritjen e normave tradicionale të gjuhës, kulturës, organizimit dhe identitet. Në kapitujt e mësipërm u paraqitën pikëpamjet e ndërtimit të shtetit në një kontekst historik, për të vijuar nga një pikëpamje mbi dinamikën e zhvillimeve në rajon te perceptimet përmes një analize të ngjarjeve më të rëndësishme që u paraqitën që nga pavarësia e Maqedonisë e deri te një fazë më e tensionuar veprimesh brenda shtetit. Prezantimi i këtyre ngjarjeve do të bëhet nga një perspektivë e përgjithshme që përfshin komunitetin etnik shqiptar në Maqedoni, dhe cilat ishin ato kërcënime që rrezikonin kushtet themelore të ripërtëritjes. Rastet e prezantuara, që kanë të bëjnë me kërcënime kulturore, linguistike dhe organizimin komunitar, do të mbulojnë sfera të rëndësishme që janë të lidhura ngushtë me aspektin e ekzistencës dhe mbijetesës së komunitetit të mirëformuar.

Rëndësia e shpalosjes së dinamikës së këtyre ngjarjeve qëndron jo vetëm te arsyet që çuan deri te këto ngjarje, por edhe me heqjen e pengesave strukturore që u shfaqën rishtas duke e tensionuar situatën mes dy komuniteteve më të mëdha në vend, atij shqiptar dhe maqedonas. Disa nga faktorët strukturorë që shkaktuan një tensionim të tillë mes dy komuniteteve dhe që vlejné të përmenden, janë ato të diskriminimit politik duke vazhduar me ato të fushës ekonomike, shoqërore, kulturore etj. Duke u nisur nga perspektiva

historike që veçuam në kapitujt e mësipërm, vihet re se çështjet e brendshme mund të jenë influencuar nga jashtë, dhe si të tilla nuk pikasen, deri në çastet e shfaqjes së tyre; ose edhe disa zhvillime që i paraprinë si rrjedhojë e ndryshimve të rajonit në përgjithësi.

Ashtu si shtetet e tjera të rajonit, Maqedonia përballej me sfida që kishin një karakter shumëpërmasor, e që ishin artikuluese të gjendjes së rrethanave. Si një shtet me një popullsi multietnike, Maqedonia, përkrah problemeve ekonomike që ishin të rrënjosura thellë, kishte edhe probleme të natyrës etnike. Problemet etnike ishin më të spikaturat, sepse ato përbënin disa segmente që artikuloheshin drejtpërdrejtë edhe në natyrën strukturore të shtetit. Ndonëse shteti trashëgonte një sistem të mëparshëm dhe ndiqte hapat e tij të pavarësimit në të njëjtën formë, kushtet me të cilat ajo shpalli pavarësinë ofronin mundësi ndoshta për një hapërim ndryshe. Por, siç e thamë më lart, edhe ajo vezulloi me format e shtetndërtimit, që i jepnin përparësi një projekti nacionalizimi monoetnik, duke spikatur kulturën, gjuhën dhe legjitimitimin e vetëm një grup etnik.

Popullata shqiptare në Maqedoni, që përbënte një komunitet të rëndësishëm, filloi të artikulonte haptas dhe qartazi objektivat e veta, duke kërkuar një qasje më adekuate ndaj politikave të shtetndërtimit që në fazën e parë të shpalljes. Të organizuar rreth partive politike me formacion shqiptar, fillimisht bojkotuan referendumin për pavarësi dhe më pas organizuan një të tyrin për të shprehur jo vetëm mospajtimet e tyre me format artikuluese të shtetit nëpërmjet kushtetutës, por edhe për të treguar një organizim politik që kishte një vizion ndryshe për shtetin.

Në premisat në të cilat ndërtohej shteti, komuniteti shqiptar shihte kërcënime si për identitetin e tij ashtu edhe për normat dhe vlerat që e përbënin atë si komunitet, dhe si rrjedhojë reflektonte duke zbehur legjitimitetin e shtetit ndaj popullsisë shqiptare. Nga kjo

pikëpamje, sistemin politik me të cilën ndërtohej shteti, shqiptarët e shihnin si një konstrukt që favorizonte ndërtimin e shtetit-komb për maqedonasit, dhe kjo në një sistem pluralist ku përbërja e popullsisë ishte multietnike. Kështu u hapën një mori çështjesh për të cilat dy komunitet krijuan një mosbesim të ndërsjellë, duke arritur pikën kulmore me një konflikt të armatosur mes forcave të armatosura të shtetit dhe revoltës së armatosur shqiptare.

6.2 Dilemat e sigurisë dhe agjendat politike

Duke pasur pasur parasysh dinamikat e zhvillimeve rajonale të kohës, elita politike, që ishte trashëgimtare e partisë komuniste të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, në vllugun që ndërmorën hapat e shtetndërtimit nuk morën parasysh faktin se një e treta e popullsisë së vendit u përjashtua për të marrë pjesë aktive në ndërtimin e institucioneve shtetërore, dhe rrjedhmisht edhe në drejtim të politikave të sigurisë, aq të nevojshme për një komunitet të gjerë bazuar në preferencat e tyre kulturore. Kur Maqedonia shpalli pavarësinë ajo kontrollohej dhe udhëhiqej ekskluzivisht nga elita politike e grupit etnik maqedonas, për shkak të trashëgimisë politike jugosllave, që përmbante politika segregacioni, të artikuluar qartazi drejt entitetit shqiptar gjatë viteve '80. Një arsye që paraqitej shpesh nga politikëbërësit maqedonas të kohës ishte se Maqedonia ishte e kërcënuar në ekzistencën e saj nga jashtë, dhe kështu i duhej të mbronte identitetin etnik të popullit maqedonas, duke e artikuluar si shprehje e identitetit shtetëror.

Një qasje e tillë nuk u pranua nga pala shqiptare, sepse pavarësisht aktiviteteve konstruktive të partive politike të kohës, komuniteti shqiptar nuk radhitej në përbërjen e popujve shtetformues, dhe si i tillë i mohohej vazhdimësia historike e ekzistencës së tij në

këto territore. Së bashku me përjashtimin e tij nga statusi shtetformues, ai humbte rishtazi edhe përfitime të tjera që vinin nga një formulim i tillë, duke i mohuar të drejtën e përdormit zyrtar të gjuhës dhe manifestimeve të tjera identitare që karakterizonin popullin shqiptar. Këto elemente segregimi vazhduan me një sfond strukturor duke u paraqitur thuajse në të gjitha fushat e jetës së organizuar, deri në një centralizim të skajshëm të pushtetit vendor. Për më tepër, gjatë riorganizimit të sistemit politik dhe politikave të segregacionit në vitet e fundit të Federatës, pjesëmarrja e shqiptarëve ishte pothuajse zero në institucionet shtetërore dhe ato të sigurisë. Ndonëse me aplikimin e sistemit pluralist politik disa nga funksionet publike drejtoheshin nga shqiptarë, ata nuk mund të bënin gjë për nevojat e komunitetit të tyre, ngaqë kushtet e funksionimit të sistemit kishin një dozë të stërngarkuar korruptive.

Nga një gjendje e tillë kemi reagimet dhe kundërreagimet e njëpasnjëshme në njërën anë të komunitetit shqiptar dhe në anën tjetër të insitucioneve shtetërore. Kjo dinamikë ndërveprimi, siç e thamë më sipër, u vendos që në fillimet pavarësisë dhe shtetndërtimit, dhe si e tillë artikulonte interesa që ishin në kundërshtim me interesat e një segmenti të popullsisë. Për shtetin tani shtrohej dilema e mbrojtjes së identitetit dhe karakterit maqedonas të tij, duke i pozicionuar shqiptarët me automatizëm në një gjendje armiqësore karshi institucioneve të ndryshme të shtetit. Si pasojë, çdo tentativë dhe kërkesë nga ana e shqiptarëve për të siguruar kushte mbijetese për normat e identitetit të tyre brenda Maqedonisë konsiderohej automatikisht si atakim ndaj shtetit dhe insitucioneve të tij. Në këto rrethana u vendosën institucionet e trashëgurara shtetërore të ish- Jugosllavisë edhe në Maqedoni, që Brubaker-i e quan projekti nacionalist ku elitat mbizotëruese imponojnë dhe “promovojnë kulturën, gjuhën, pozitën demografike, zhvillimin ekonomik dhe

hegemoninë politike të kombit bartës të shtetit dhe institucioneve të tij”. (Brubaker, 1996, f. 57)

Diskursi politik në këto rethana zhvillohej kryesisht rreth të drejtave kushtetuese dhe nominimit të mbajtjes së primatit shtetëror. Kur u aprovua kushtetuta në vitin 1991, nuk u votua dhe nuk pranua nga pala shqiptare, duke kontestuar natyrën dhe preambulën e saj që shprehte një ndryshim sistemi, nga ai komunist në atë pluralist, por duke nominuar pupullin maqedonas si shtetformues, dhe shtetin si të popullit maqedonas. Në pjesën hyrëse të sajë ajo evokon “trashëgiminë historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore të popullit maqedonas... konstituohet si shtet kombëtar i popullit maqedonas... ku sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë”. (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991)

Nisur nga këto, shqiptarët ndjenin se ishin të anashkaluar nga postulati kryesor i kushtetutës, duke i vendosur ata në një pozicion dytësor në krahasim me maqedonasit. Në këtë kontekst, trashëgimia historike dhe kulturore evokonte premisa që konfirmonin hapur primatin shtetëror të popullit maqedonas, dhe në përputhje me ngajrjet e kohës ata shiheshin si trashëgimi e drejtpërdrejtë e sistemit të instaluar komunist. Në perceptimet e elitës politike shqiptare të kohës ishte një pozicion kundërthënës dhe dregradues, edhe me kushtetutën e vitit 1974, ku Maqedonia si shtet përkufizohej si shtet i popullit maqedonas dhe shtet i popullsisë shqiptare. Nisur nga ky fakt, shqiptarët zgjodhën të mos e votonin, duke e bojkotuar referendumin e shpalljes së pavarësisë, duke aluduar se populli maqedonas po tenton ta krijojë shtetin si një trashëgimi e kohës kur politikën e Federatës ishin të orinetura kundër shqiptarëve në një gjendje primati etnik në një shtet multietnik,

dhe duke ndarë kujdesin dhe të mirat që burojnë prej tij në kategori parësore dhe dytësore. (Ilievski, 2007, f. 17)

Kushtetuta dhe preambula e saj, në disa raste u paraqit si një segment justifikimi i elitës politike maqedonase për të ndërmarrë një numër veprimtarish që do të vulosnin themelimin e shtetit në baza etnocentrike në vitet '90. Kryesisht kjo është bërë duke ndërmarrë veprime shtypëse ndaj kërkesave politike të popullatës shqiptare, që shfaqnin edhe shqetësime rrënjësore në lidhje me kushtet e ekzistencës së tyre. Në një cikël të menjëhershëm pas shpalljes së pavarësisë kemi disa veprime të forcave policore të orientuara kryesisht drejt popullatës shqiptare, ose edhe veprimtari që lidheshin me to. Duhet veçuar rasti i Ladorishtës, apo ai në Shkup fill pas shpalljes së pamvarsisë , ku ndjillej frikë ndaj masës shqiptare në përgjithësi. (Rexhepi, 2005, f. 69)

Tashmë këto çështje nuk kishin të bënin vetëm me faktin se si duket Maqedonia dhe çfarë rruge duhet të ndjekë ajo në procesin e shtetndërtimit, por ato kalonin në tensione të karakterit strukturor. Një rast i tillë që ia vlen të përmendet është riorganizimi territorial dhe kompetencat që gëzonin ata. Me kushtetutën e vitit 1991, centralizimi i pushtetit nga njësitet vendore u fuqizua. Por, pavarësisht kësaj, si në zgjedhjet lokale të vitit 1992, bashkësitë që kishin shumicë shqiptare – dhe si të tilla një këshill dhe një kryebashkiak shqiptar – nuk arritën që të merrnin drejtimin e bashkive. Rasti me Tetovën dhe Gostivarin janë disa nga shembujt e një centralizimi të tillë, por për më tepër edhe të një segregimi të vazhdueshëm. Ndonëse në gjendje të tensionuar dhe pa të drejtë ushtrimi të detyrës së kryetarit të bashkisë së dalë nga zgjedhet vendore, ligji për qeversijen vendore u ndryshua në vitin 1995, duke hapur një sërë problemesh të tjera, që në thelb kishin të bënin me

shtrirjen etnike të bashkive, por edhe me autorizimet dhe përgjegjësitë që kishin në ushtrimin e detyrave. (Holliday, 2004, f. 145)

Çështja e simboleve dhe elementeve të identifikimit grupor ishte më e ndjeshmja për institucionet shtetërore. Përdorimi i gjuhës dhe flamurit në këtë periudhë, si një pikënisje e problemeve strukturore që ndonëse zanafillën e kishin te kushtetuta, tani nisën të shfaqen në mënyrë të strukturuar, sepse në vetvete përfshinin të drejta si shkollimi. Pas rishikimit të ligjit të pushtetit vendor, përdorimi i flamurit nga ana e drejtuesve të bashkisë së Tetovës dhe Gostivarit pati një përshkallëzim në dhunë dhe burgosje ndaj organizatorëve të këtyre ngjarjeve. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim kishte sërish gjykata kushtetuese, që me anë të një vendimi të saj shpalli se aktet e vendosjes së flamujve pranë godinave të bashkive ishin shkelje kushtetuese. Vendimi i gjykatës kushtetuese vijoi me një ligj të aprovuar me shpejtësi në parlamentin e Maqedonisë, i cili regullonte ose edhe ndalonte përdorimin e këtij flamuri. (Holliday, 2004, f. 146)

Këto masa të ndërmarra me shpejtësi tregojnë se gjendja politike është e stërngarkuar, deri në atë masë sa të autorizohet klasa vendimarrëse për përdorimin e masave të jashtëzakonshme për arritjen e qëllimeve për sigurinë e shtetit, në këtë rast mbrojtjen e sovranitetit të tij. Një justifikim i tillë erdhi pas një diskursi politik nga të dyja palët, duke paraqitur qëndrimet e njërës apo palës tjetër mbi ato çështje që kanë të bëjnë me përdorimin e simboleve dhe çështje të tjera të lidhura me paraqitjen identitare. Pala shqiptare ishte e qëndrimit se përdorimi i simboleve është i lidhur ngushtë me identitetin e tyre, dhe si i tillë i garantuar edhe me kushtetutën e vitit 1974, – në vijimësinë e shtetformuese të Maqedonisë – por e abroguar me procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë më 1989. Këto masa të jashtëzakonshme sollën aktivizimin e shumë forcave policore dhe

arrestimin e një numri të madh aktivistësh. Vazhdimi i këtyre masave arriti deri te përdorimi i skajshëm i forcës, që kishte si pasojë edhe të vrarë. Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, pati edhe procese gjyqësore ku u burgosën udhëheqës të bashkësive të lartpërmendura (Rexhepi, 2005, f. 127)

Një politikë e tillë, që në diskursin e Maqedonisë mori përmasa të rëndësishme, është edhe ajo e gjuhës shqipe dhe përdorimit të saj. Diskursi rreth kësaj çështje hapi edhe çështjen e shkollimit në gjuhën amtare. Shkollimi fillor dhe ai dytësor që i mundur të bëhej në gjuhën shqipe, por problemi ishte te arsimi i lartë. Institucionet shtetërore, te çështja e gjuhës – që ishte e artikuluar qartë në kushtetutën e vitit 1991 si gjuhë zyrtare, në nenin 7, ku thuhet se “gjuha zyrtare i institucioneve të shtetit është gjuha maqedone dhe alfabeti i saj cirilik”, shihinin nevojën e mbrojtjes së kushtetueshmërisë dhe vepronin në kohezion karshi paraqitjeve të përdorimit të gjuhës shqipe, qoftë në nivel qendror qoftë në atë vendor. (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991)

Por, problemi me arsimin nisi të merrte trajta jashtëinstitucionale, kur shqiptarët parashtuan kërkesën dhe themeluan universitetin e tyre në Tetovë në vitin 1994. Institucionet shtetërore vendosën masa për heqjen çështjes duke përdorur mjete policore në përgjigje të vendimeve të marra për themelimin e një universiteti të tillë. Problemet po shfaqeshin ndryshe krahasuar me të mëparshmet, sepse vendimi ishte mbështetur nga kuvendet bashkiake me shumicë shqiptare, duke artikuluar kështu nevojën e tyre për një arsim të lartë konform kërkesave dhe nevojave të popullsisë, dhe duke u mbështetur institucionalisht nga këto bashki. Veprimet e institucioneve shtetërore ishin përpjekje për ndalimin e këtyre nismave, duke pasur si pasojë të burgosur dhe të vdekur në procesin e implemtimit të vendimeve qeveritare. (Ostreni, 2014, f. 151)

Një ngjarje tjetër që mund të veçohet në përshkallëzimin e situatës është edhe rasti i grumbullimit të armëve, ose siç njihet ndryshe në fjalorin politik, “afëra e armëve”. Ngjarja ishte disapërmasore, ngaqë u implikuan segmente si zyrtare ashtu edhe jozyrtare. Në marrëveshjen e presidentit të Maqedonisë me ushtrinë jugosllave parashikohej një periudhë tërheqjeje e ushtrisë jugosllave, dhe në bazë të këtyre parametrave riorganizimi i mbrojtjes territoriale vazhdonte. Por, krahas kësaj paraqiten edhe prirje për organizimin e faktorit shqiptar, dhe me përfundimin e tërheqjes së ushtrisë jugosllave shpërtheu afëra e lartpërmendur, duke implikuar disa figura të larta të partive politike shqiptare që vepronin në Maqedoni, dhe njëkohësisht edhe burgosjen e tyre. Kjo ndikoi në ngritjen e një retorike dhe diskursi radikal mes palëve, që i jepte legjitimitet veprimeve të jashtëzakonshme. (Rexhepi, 2005, f. 72)

Këto janë disa nga shembujt që mund të jenë të mjaftueshëm për nevojat e punimit, për të paraqitur dinamikën e veprimit dhe kundërveprimit mes dy komuniteteve më të mëdha në shtet. Ndonëse ajo përbëhet nga një dilemë perceptimesh për një potencial kërcënues ndaj ekzistencës së njërës, në të njëjtën masë ajo aktivizon veprime që në të vërtetë shpalosin veprime të tjera që shihen si kërcënuese karshi komunitetit tjetër. Ky cikël ndërveprimesh u artikulua duke u mbështetur në postulatet themelore të dokumentit kushtetues si bazë e themelimit të shtetësisë së Maqedonisë. Në këtë periudhë institucionet ndoqën veprime që akumuluan ndjesi frike dhe kërcënimi të komuniteti tjetër, saqë gradualisht filluan përpjekjet për ndërmarrjen e veprimeve mbrojtëse.

Duke u nisur nga një paraqitje e tillë mund të theksohet se kemi të bëjmë me një politizim të çështjeve që kanë të bëjnë me përparësinë e theksimit të mbrojtjes së një pyetjeje nga ana e elitës politike të kohës. Kushtetuta si e tillë paraqitet si rregull me të

cilin vendosen premisat e veprimit të insitucioneve shtetërore, që përkufizojnë rrjedhën e ngjarjeve për një kohë të caktuar. Vendimi i sjelljes së kushtetutës është një vendim politik i palës maqedonase, duke u bazuar te nocionet tradicionale të përparësisë së politikave shtetërore. Vendodhja e vendosur në rastin konkret është ajo e shtetit, duke pozicionuar popullin maqedonas si objekt referues për të, dhe vijimisht i autorizon institucionet e shtetit të aplikojë masa mbrojtëse, në raste të caktuara edhe me anë të forcës, duke u përqendruar te shpjegimi i burimit të nevojave të tij te kushtetuta. Veprimet e insitucioneve të shtetit e përkufizojnë qartë rrezikun si në rastet e lartpërmendura, duke u vënë në mbrojtje të gjuhës apo edhe simboleve maqedonase, në atë formë që ndalon elementet e simboleve apo edhe të gjuhës së komunitetit shqiptar.

Duke u nisur nga fakti se ndërveprime të tilla mund të gjenerojnë veprime edhe nga një subjekt tjetër, siç është rasti me shtetet që kanë në vetvete më tepër grupe dhe identitete të organizuara, niveli i analizës mund të paraqitet edhe te komunitetet e organizuara që mund të shprehin nevojat e tyre në bazë të organizimit politik. Në rastin e Maqedonisë, duke qenë se është një shtet multietnik burimi i shqetësimeve është jo vetëm si shpjegim institucional, por edhe një mori shqetësimesh që kanë të bëjnë me grupet që e përbëjnë shtetin. Komuniteti shqiptar është gjetur para një vendimi politik lidhur me formulimin e kushtetutës, dhe zgjodhi që të mos e aprovojë atë si artikuluese e mbrojtjes së nevojave të tij. Në këtë mënyrë burimi i shpjegimit të nevojave të tij erdhi përmes organizimeve të ndryshme që reflektonin te perceptimet dhe veprimet e insitucioneve ndaj saj.

Në bazë të përkufizimit që bëmë më lart, sugria shoqërore trajtohet si një përpjekje e grupit apo e komunitetit për të “jetuar në një ambient të ndryshueshëm nga kërcënimet e

perceptuara apo reale... në kronizat normale të zhvillimit të gjuhës, kulturës, të drejtës së asocimit dhe identitetit kombëtar”. Në këtë drejtim siguria shoqërore paraqitet si një segment i vazhdimësisë së normave tradicionale të një grupi, dhe kështu ai merr masa për mobilizimin e masave që do t’i asgjësonin këto shqetësime për sigurinë e grupit, duke ndërmarrë masa të jashtëzakonshme dhe veprime të menjëhershme, përfshirë këtu edhe përdorimin e forcës. (Buzan, 1991, f. 432)

Në thelb, trajtimi ka të bëjë me aprovimin e masave të jashtëzakonshme nga sektorë shtetërorë, duke synuar ndalimin e veprimeve të komunitetit shqiptar. Një gjendje e tillë kërcënuese për institucionet e shtetit nuk ekzistonte, por aktorët e paraqitën si të tillë dhe rishtazi krijuan perceptime që kërkonin ndërmarrjen e masave të menjëhershme me anë të formulimeve kushtetuese. Në këtë gjendje, kur perceptimet e ndryshme krijohen rishtazi, ato shkaktojnë një dilemë për çështjet e sigurisë, dhe në këtë mënyrë krijohet një sistem anarkik edhe brenda shtetit, duke i vendosur komunitetet në një garë të përherëshme. Në këtë rast mund të themi se siguri paraqitet si një mundësi për zgjidhje, duke i atribuar shkaqeve edhe efekte politike me prezantimin e kërcënimit si emergjent, në mënyrë që të miratohen masa të jashtëzakonshme. (Buzan, Waever dhe Wilde, 1998, 25)

Duke u fokusuar te zhvillimet që u apostrofuan më lart, kemi një situatë ku komuniteti që ndjehet i kërcënuar, pra ai shqipëtar, ndërmerr masa për të anuluar rreziqet që i praqiten. Në fillim ato kanë një trajtim politik, dhe kështu paraqitet nevoja e trajtimit nga elitat politike apo edhe nga ana e institucioneve. Por, me zhvillimin e ngjarjeve ato marrin edhe forma të tjera, duke pasur efekte si strukturore ashtu edhe shoqërore, sepse krijojnë një gjendje anarkike brenda vetë shtetit. Në vazhden e krijimit të dinamikës së ndërveprimit rezulton një zhvillim ngjarjesh ku dalin edhe përplasje të formave të

organizuara, siç ishte edhe konflikti i vitit 2001. Përplasje të kësaj natyre erdhën si rrjedhojë e zhvillimeve ndaj perceptimeve për gjendjen e sigurisë së identitetit dhe normave të komunitetit shqiptar në Maqedoni. Kjo përplasje solli edhe një riorganizim mbi të cilin trajtoheshin çështjet e rëndësishme të komunitetit shqiptar, gjë që solli një marrëveshje mes dy komuniteteve më të mëdha në vend. Marrëveshja kishte për qëllim trajtimin e çështjeve të kontstueshme dhe eliminimin e perceptimeve që ishin krijuar rishtazi, duke siguruar masa institucionale për shqetësimet që kishte paraqitur pala shqiptare.

Përshkallëzimi i konfliktit në vitin 2001 ishte kulmi i perceptimeve ndryshe se si duhet të duket shteti dhe çfarë përbën siguri për aktorët e përfshirë. Hap pas hapi, perceptimet e ndryshme u zhvilluan në qëndrime që reflektonin edhe për vetë sistemin dhe institucionet e shtetit, duke u përqendruar te nevoja për ndryshime strukturore. Marrëveshja e Ohrit hapi një sërë mundësish për një ekuilibrim mes fuqive të akumuluar brenda, si dhe një rimodelim të aspekteve politiko-strukturore që shkaktuan përplasjen. Marrëveshja e Ohrit arriti që të ndalonte luftimet mes palëve dhe të rifokusonte zhvillimet e mëtejshme në një spektër politik, duke u hapur rrugë reformave dhe përmirësimit të të drejtave që kërkonin shqiptarët. Këto reforma kapën çështje që kishin të bënin me aspektet kushtetuese të Maqedonisë me promovimin e konceptit të barazisë, të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore, përfaqësim adekuat dhe një sistem politik që reflektonte mbi përbërjen dhe nevojat e popullsisë.

6.3 Marrëveshja e Ohrit

Duke u nisur nga përshkrimet e mëparshme të ngjarjeve në Maqedoni gjatë periudhës pas pavarësisë, mund të vërhet një dinamikë ndërveprimi nga elitat politike, duke i ngritur çështjet deri te nevoja e marrjes së masave të jashtëzakonshme për të mbrojtur qëndrimet e artikuluarat përmes dokumenteve zyrtare, siç është kushtetuta. Në këtë rast kemi shqetësimet që u ngritën nga pala shqiptare për cenimin e identitetit të tyre, dhe më tej përpjekjet e tyre për t'i ngritur këto shqetësime në forma të ndryshme. Në këtë rast ata nxirrnin kërcënimet që vinin nga institucionet shtetërore, duke u mohuar mundësinë e artikulimit të çështjeve të identitetit të tyre në mënyrë institucionale, dhe në këtë mënyrë u krijua një ndjenjë pasigurie për komunitetin dhe vlerat e tij. Dinamika e ndërveprimeve nuk u mjaftua me kaq, por u zhvillua deri në një masë organizimi dhe përplasjeje mes komunitetit shqiptar dhe institucioneve të shtetit. Institucionet e shtetit, të dominuara nga grupi etnik maqedonas, jo vetëm që nuk e trajtonin sigurinë e identitetit të komunitetit shqiptar, por në raste të caktuara edhe e cenonin atë duke i shtypur me forcë përpjekjet e tij.

Ndonëse mundësia e përshkallëzimit të konfliktit ishte e pranishme që me shpalljen e pavarësisë, nuk pati një konflikt të hapur. Një ndër faktorët e shmangies së konfliktit të brendshëm ishte fakti se elita politike shqiptare tentonte që çështjet e interesit të saj t'i artikulonte nëpërmjet rrugëve institucionale, siç ishte parlamenti apo edhe pjesëmarrja e ndonjë partie në qeveritë konsektive. Prania e partive politike në qeveri dhe në parlament nuk ishte kuptimplote, sepse nuk kishte mundësinë e trajtimit të këtyre çështjeve që përkonin me realitetin e elektoratit të tyre shqiptar. Konsensusi politik gjatë kësaj periudhe ishte gati i papranishëm, dhe partitë politike që merrnin pjesë në qeveri me programet e

tyre, pas një periudhe të caktuar do të dëgjonin zërin e tyre të zbehur. Kjo nënkuptonte se problemet akute për të cilat ishin zgjedhur nuk mund t'i zgjidhnin, dhe kështu ishin të destinuar të dështonin jo vetëm me platformat partiake, por edhe me çështje që rëndonin mbi sigurinë e shtetit. (Hislope, 2004, f. 5)

Duke u nisur nga fakti se Maqedonia ishte në pikënisje të shtetndërtimit në premisa etnocentrike, kërkesat institucionale të përfaqësuesve politikë shqiptarë i trajtonte duke i anuluar ose me raste duke i shtypur, siç e thamë më sipër. Mekanizmat e shtetit përdorshin në mënyra të ndryshme për zgjatjen e pushtetit mbi një sektor të caktuar shoqëror, që në rastin konkret ishte shqiptar. Në këtë formë, legjitimiteti i të zgjedhurve shqipëtarë humbte edhe rëndësinë e tij legjitime, dhe autoriteti i tyre jo vetëm që nuk ishte adekuat, por filloi të humbiste edhe në aspektin legjitim, sepse nuk po sillte ndonjë rezultat. Pas njëfarë kohe u bë më se e qartë që sistemi politik që ishte në funksion nuk u përgjigjej nevojave të të gjitha shoqërive. Megjithëse shteti në këtë rast është një faktor i rëndësishëm, ai nuk ishte i mjaftueshëm që me legjitimitetin e tij të arrinte në të gjithë territorin. Kjo erdhi më tepër edhe si shprehje e një ligjshmërie të dobësuar të përfaqësuesve shqiptarë në kërkesat dhe plotësimin e nevojave të komunitetit përmes institucioneve shtetërore. Nisur nga këtu kemi edhe përhapjen e një shteti të dobët dhe një komuniteti që fillon ta organizojë veten, pavarësisht qasjes së institucioneve. (Saleh, 2010 f. 236)

Pra, sistemi politik që ishte i instaluar në Maqedoni, ndonëse ishte ai i përfaqësimit të drejtpërdrejtë, në rastin në fjalë doli si një model joadekuat, sepse përpos pengesave të shumta nga pikënisja kushtetuese, tani hasnin edhe në një segment të zgjeruar, ngaqë nuk arrinte të artikulonte dhe të legjitimonte pjesëmarrjen nëpërmjet institucioneve.

Përfaqësuesit shqiptarë në qeveri, përveçse nuk kishin burimet e nevojshme njerëzore për të implementuar politika që ishin në platformat e tyre, ato kishin edhe një mbivotim të vazhdueshëm kur ishte fjala për legjislacione që kishin të bënin me shqiptarët. Pengesat e ndryshme administrative luanin rolin e tyre duke stërzgatur ndonjë implementim të akordësuar më parë; por, për më tepër, edhe në raste kur legjislacione të ndryshme apo edhe nisma arrinin në parlament, ato thjesht mbivotoheshin. (Hislope, 2004, f. 2)

Formimi i qeverive, po ashtu, kishte dimensionin e vet multietnik, duke pasur në ekzekutiv parti dhe individë shqiptarë. Prania e tyre në qeverisje nuk sillte ndonjë relaksim të komunikimit ndërkomunitar – përkundrazi, ajo shihej si një stërzgjatje e pushtetit në forma të tjera. Përfaqësuesit shqiptarë në ekzekutiv jo vetëm që nuk arritën të zgjidhin çështjet më akute që kërkoheshin nga pala shqiptare, si arsimi i lartë apo e pushteti vendor, por në raste të caktuara as nuk i merrnin parasysh shqetësimet që ngriheshin në rrugë institucionale. Nisur nga kjo mund të vërhehet se sistemi i një demokracie shumicë, siç ishte në Maqedoninë multietnike, nuk u përgjigjej nevojave, sepse ajo sillte shqetësime dhe lëvizje drejt një sistemi autoritar ndaj një numri prapseprapë të konsiderueshëm të popullsisë në shtet. (Maleska, 2005)

Marrëveshja paqësore e Ohrit që u nënshkrua më 13 gusht 2001, paraqitet si një hap drejt një perceptimi ndryshe ndaj problemeve të apostrofuara më parë. Duke qenë se u nënshkrua dhe negociua në gjendje të konfliktit të hapur mes ushtrisë çlirimtare kombëtare dhe forcave të armatosura të Maqedonisë, ajo shihet edhe si një instrument politik i ndalimit të mëtejshëm të përshkallëzimit të situatës në terren. Incidentet e armatosura kishin filluar që më herët dhe pikënisjet e një konfrontimi të armatosur viheshin re duke shënuar sulme të armatosura të stacioneve policore, por edhe të masava jashtëzakonisht të

rrepta të forcave policore në disa lokalitete të banuara me shqiptarë, edhe para se përplasjet të merrnin formën e konfrontimit të hapur në vitin paraardhës. Përplasjet mes dy forcave, me kalimin e kohës merrnin një dinamikë të ngritjes së intensitetit të veprimeve konfrontuese, dhe ndonëse ata shprehnin gatishmëri për një ujdi mes dy palëve, qëndrimet ishin diametrisht të kundërta në këndvështrimet se si e shihnin zgjidhjen e problemeve.

Nënshkrimi i marrëveshjes solli një varg implikimesh në fushën e sigurisë dhe ndalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të përplasjeve, por edhe në qasjen dhe trajtimin e çështjeve kontestuese mes palëve. Përveçse ia doli të ndalonte përshkallëzimin, marrëveshja kishte edhe implikime të natyrës organizative të sistemit politik dhe kushtetutën e kontestuar deri më tani në një fushë të re ku shqetësimet e faktorit shqiptar trajtohen nga një këndvështrim tjetër. Formulimi i marrëveshjes ishte i tillë që të garantonte për komunitetin shqiptar të drejtat e tij për të artikuluar lirshëm dhe duke kërkuar masa që mbrojnë identitetin politik, kulturor dhe komunitar në kuadër të shtetit. Pak a shumë marrëveshja transformoi shtetin etnocentrik të Maqedonisë, duke instaluar një sistem si administrativ ashtu edhe legjislativ ku kërkesat e komuniteteve të tjera, veçanërisht ai shqiptar, do të kishin të drejtën e ndarjes së ushtrimit të kompetencave ekzekutive dhe legjislative në mënyrë që të mos anashkalohen nga komuniteti tjetër. (Bieber, 2008, f. 8)

Sistemi i drejtanishëm politik, që i mbante komunitetet e tjera në Maqedoni dhe veçanërisht atë shqiptar nën kontrollin e masave të jashtëzakonshme, tani pësoi ndryshime duke u shpërqendruar nga një sistem etnokratik në një sistem të ndarjeve të përgjegjësisë në një veprim konsensual. Të drejtat e komuniteteve, veçanërisht ata që përbënin më tepër se njëzet përqind të popullsisë së përgjithshme, shfaqen në një kontekst strukturor

institucional, ku mbrohen nga një mbivotim i drejtpërdrejtë. Kjo mbrojtje nga maxhorizimi paraqitet e qartë në disa fusha të interesit të komunitetit shqiptar përmes mekanizmave legjislativë, por edhe të pushtetit ekzekutiv në një masë të caktuar.

Qëllimi i ndarjes së përgjegjësiave do të mundësonte aplikimin e politikave për të gjithë komunitetet, jo vetëm nominalisht, por edhe praktikisht, duke u hapur mundësinë e veprimit brenda institucioneve. Aplikimi i masave të regullta brenda kushtetutës dhe akteve të tjera normative do t'i mundësonte komunitetit shqiptar artikulin dhe mbrojtjen e identitetit të tij, duke i mundur aplikimin e atyre masave që referohen te mbrojtja nga mbivotimi politik dhe ndërmarrja e masave nga institucionet shtetërore kundër kërkesave dhe shqetësimeve të komunitetit shqiptar. Masat konkrete të përgjegjësiave të dyfishta kishin të bënin me ligjet dhe interpretimin e tyre në aspektet kulturore, gjuhësore dhe identitare të komunitetit shqiptar, por edhe të komuniteteve të tjera, duke hequr nga përdorimi nocionet fillestare të shprehjes së shtetit si ekskluzivitet i popullit maqedonas. (Reka, 2008, f. 59)

Një qasje e tillë e MKO-së përkonte me nevojën e menjëhershme të parandalimit të përshkallëzimit të përplasjeve që kishin filluar, dhe si e tillë ngërthen një segment të rëndësishëm të sigurisë për Maqedoninë. Kjo u arrit në gjendje konflikti, por duke adresuar një sërë çështjesh që me kalimin e kohës kishin akumuluar mjaftueshëm masa politike dhe herë-herë kalonin në përdorimin e forcës si përgjigje për perceptimet politike që artikulonin shtetëndërtimi i Maqedonisë që nga pavarësia. Që nga pavarësia, institucionet e shtetit legjitimuan një sistem politik që mbështetej te kushtetuta, duke paradhënë segmentet e legjitimitetit politik dhe në mënyrë më të tërthore duke përshkruar kërcënimet ndaj këtij legjitimiteti. Por, duke qenë se nuk pranohej nga një segment i rëndësishëm i

popullsisë, masat të cilat u zgjodhën për aplikimin dhe shtrirjen e këtij legjitimiteti politik ishin ato të ushtrimit të forcës në arritjen e objektivit. Në këtë mënyrë ndodhi një deligjitimim i politikave shtetërore dhe aplikimit të sistemit në të gjithë hapësirat e shtetit. Dhe në një gjendje të tillë, marrëveshja kornizë e Ohrit tentonte të jepte një qasje ku përgjegjësit dhe ushtrimi i fuqisë nga institucionet e shtetit të ndalonte. Ky sistem politik i ndarjes së pushtetit në mënyrë proporcionale njihet në përmasa, por në Maqedoni aplikohet si i veçnatë, duke iu përgjigjur karakteristikave të vendit.

Ndarja e pushtetit aplikohet në disa vende të ndryshme dhe të gjitha kanë veçoritë e tyre duke aprovuar masa legislative dhe strukturore që u përgjigjen rrethanave të tyre. Sistemi politik që aplikoi në vazhdim Maqedonia është një ndërthurje e disa teorive që nuk e specifikojnë karakterin e shtetit, por që i trajtojnë problemet në një qasje strukturore dhe bashkëvepruese, e bazuar në një ndarje të pushtetit në mënyrë konsesuale. Një nga studiuesit që i ka kushtuar më shumë rëndësi një ndarjeje të tillë është Arend Lijphart, që mes të tjerash karakterizon masat që ndërmerren në ndarjen e përgjegjësive: a) një koalicion i zgjeruar qeverisës; b) përfaqësimi proporcional dhe përfshirja e të gjitha palëve në institucionet publike dhe legislative; c) e drejta e vetos dhe d) një autonomi e zgjeruar veprimi. Të gjitha këto japin një orientim thelbësor përmes të cilit duhet të organizohet një shoqëri në transformim dhe e ndarë, ku paraqitet nevoja e një riformulimi organizativ. (Lijphart, 1977, f. 25)

Këto mund të aplikohen në një ndarje të prerë me organizime federative, ose edhe më të butë, siç është rasti në Maqedoni, ku disa nga këto segmente përkufizohen taksativisht përmes ligjeve dhe normativave të ndryshme. Në theëb, një sistem i tillë gjen mundësitë e përfshirjes dhe bashkëveprimit të të gjitha komuniteteve në strukturën

organizative të shtetit, nga ku ata do shprehin shqetësimet e tyre, që më pas do aplikohen. Pra, ky dimension veprimi dhe ndërveprimi karakterizohet deri në njëfarë mase nga një sistem i dakordësuar dhe shpeshherë edhe i formalizuar nëpërmjet normave ligjore dhe pjesëmarrjes strukturore, duke u dhënë të drejtën e artikulimit grupeve të përfshira. Përfshirja dhe pjesëmarrja e komuniteteve duhet të jetë e paraqitur në përmasa horizontale dhe vertikale, ku të paraqesin një kohezion të gjerë strukturimi në të dy drejtimet. Ndonëse kjo kërkon një bashkërendim të veprimeve në mënyrë që të anulohen mundësitë e preceptimeve të njëanshme, duhet veçuar se qëllimi i kësaj qasjeje është trajtimi adekuat i çështjeve që mund të jenë shqetësuese dhe në disa raste edhe kërcënuese për njërën nga palët. (Lijphart, 1977, f. 25)

Megjithëse një çështje e tillë për ndarjen e pushtetit është e parashikuar në shumicën e institucioneve të shtetit, në rastin e Maqedonisë ajo ndryshon në mënyrën se si i akordohet komunitetit shqiptar dhe atij maqedonas. Formimi i qeverisë, që nga pavarësia e këtij ka pasur elementë përfaqësimi të komunitetit shqiptar, por, siç u theksua, ajo ka pasur defektet e saj kur vjen puna të implementimi i politikave që prekin pjesëmarrësit në ekzekutiv. E njëjta praktikë vazhdoi edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, duke pasur një periudhë të shkurtër dakordësimi mes palëve në qeverisje, por pa një përcaktim të drejtpërdrejtë për mënyrat se si do zgjidhet qeveria nga dy komunitetet. Por, me të marrë ndryshimet e zgjedhjeve dhe ndryshimet që ato sollën te pala maqedonase, kjo praktikë sikur e humbi efektin e saj dhe përzgjedhja ngeli përsëri e lirë nga fituesi shumicë, duke mohuar të drejtën e përfaqësimit të të zgjedhurve shumicë nga pala shqiptare. Kjo ndikoi dukshëm në perceptimet mbi stabilitetin e shtetit, duke penguar funksionimin normal të institucioneve dhe parlamentit. Por, në të njëjtën kohë,

marrëdhëniet mes dy komuniteteve filluan të përkeqësoheshin përsëri lidhur me perceptimet se çfarë ishte menduar me Marrëveshjen e Ohrit në këtë drejtim dhe frymën që ajo pasqyrore. (Bieber, 2008, f. 28)

Në zgjedhjet e vitit 2006, pala fituese maqedonase vendosi rregulla që nuk ishin të parashikuara në një riorganizim politik të Marrëveshjes së Ohrit, duke përzgjedhur pjesëmarrëse në qeveri një palë që ishte e humbur te elektorati shqiptar. Pala tjetër shqiptare e kontestoi pjesëmarrjen e palës humbëse duke argumentuar me parimin e numrave që kishte vendosur Marrëveshja e Ohrit, si dhe sistemi me të cilin kalonte ndarja e pushtetit dhe përgjegjësisë të palët, duke u dhënë të drejtën e tyre si fitues për formimin e qeverisë. Si rrjedhojë e krizave dhe mosmarrëveshjeve të krijuara për mënyrën e formimit të qeverisë, në maj të vitit 2007 u nënshkrua një marrëveshje mes VMRO-së maqedonase që ishte në pushtet dhe BDI shqiptare që ishte anashkaluar nga pushteti edhe pse fituese në zgjedhje. Kjo marrëveshje, përveç të tjerash theksonte krijimin e kushteve normative që do merrnin parasysh pjesëmarrjen në pushtet ndërmjet dy palëve fituese të zgjedhjeve nga dy komunitetet kryesore. Pika e pestë e kësaj marrëveshjeje bën fjalë për një zgjidhje për mënyrën e formimit të qeverisë nga fituesit e komuniteteve të mëdha dhe dakordësinë për formalizim statutor të kësaj çështjeje. (Markovikj dhe Popovikj, 2015, f. 27)

Nga një gjendje e tillë u hapën një sërë diskutimesh rreth asaj se çfarë sistemi politik përbën Maqedonia pas Marrëveshjes së Ohrit. Nga njëra anë ishin kundërshtarët e palës maqedonase, që përzgjedhjen e qeverisë e lidhnin ngushtë me sistemin unitar të shtetit, duke argumentuar me mundësinë e zgjedhjes së lirë të partisë fituese në shtet, që njihej akoma si unitar. Ndërsa pala shqiptare, duke argumentuar se Marrëveshja e Ohrit, që e ndryshoi mënyrën e perceptimit të shtetit, është nënshkruar nga dy komunitetet që

përbëjnë shumicën e popullsisë, dhe janë dy komunitetet që duhet jo vetëm të marrin përgjegjësitë nominale, por edhe ato formale në ekzekutimin e pushtetit dhe përgjegjësi që rrjedhin nga drejtimi i shtetit. Marrëveshja e mësipërme, ndonëse e mohuar nga pala maqedonase, përsëri mund të verifikohet nga dokumente që u shfaqën në publik, që tregonin ekzistencën e saj; por, në periudhën në vazhdim, disa nga pikat u dakordësuan më vonë, por jo edhe mënyra e formimit të qeverisë, megjithëse ajo u respektua nga të gjitha palët. (Markovikj dhe Popovikj, 2015, f. 28)

Një ndër aspektet e tjera që u instalua në ndarjen e pushtetit mori formë më të detajuar në legjislativ, respektivisht në parlamentin e Maqedonisë. Në fakt, nga Marrëveshja e Ohrit dhe si rrjedhojë e mbivotimit të përhershëm në parlament u shfaq e ashtuquajtura shumicë e dyfishtë, apo siç njihet ndryshe edhe Komisioni i Badenterit, që mban emrin e shpikësit të saj. Qëllimi i këtij mekanizmi parlamentar është që të fuqizojë komunitetet e tjera në parlament duke u dhënë mundësinë e vetos në çështje dhe ligje që kanë të bëjnë me kulturën, gjuhën, arsimin, pushtetin lokal dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë dhe identitetin e tyre. Një mbrojtje e tillë konstituon me faktin se në parlament, për çështjet e lartpërmendura diskuton një grup (për marrëdhënie ndëretnike) që ka një përbërje të përzier, dhe vendos mbi çështjet që kalojnë në parlament dhe nëse ato kanë të bëjnë me segmente që prekin komunitetet etnike atëherë propozimi i nënshtrohet procedurave të veçanta që kërkojnë edhe shumicën e komunitetve të tjera. Ligje të veçanta të grupet e lartpërmendura kërkojnë pëlqimin e domosdoshëm të shumicës së këtij grupi parlamentar, duke u mundësuar që ligjvënësit e grupeve joshumicë të kenë të drejtën e vendosjes. Ndonëse kjo masë ka ngritur përsëri dyshime si për rëndësinë ashtu edhe për efikasitetin e saj, në disa raste ka pasur mundësinë e shqyrtimit të çështjeve që

kanë qenë në vllugun e politizimit dhe ngritjes së tensioneve mes komuniteteve në vend, duke propozuar zgjidhje që kanë hapur mundësinë e negociatave të mëtejshme. (Ragaru, 2008, f.28)

Ndër segmentet tjera të rëndësishme që duhet spikatur në drejtim të qasjes që kishte Marrëveshja e Ohrit ndaj përfaqësimit horizontal dhe përfshirjes së një numri të caktuar të komunitetit shqiptar në institucionet publike. Posaçërisht kjo është e rëndësishme në institucione si forcat armatosure dhe njësitet policore, ku për arsye të një pranie të ulët të shqiptarëve ka pasur mundësi funksionimi të njëanshëm të tyre. Megjithëse në marrëveshjen kornizë qasja ndaj forcave të rendit ka një karakter decentralizues, ku paraqitet si një e drejtë e përcaktimit të udhëheqësisë së saj nga ana e vetë bashkive, kjo mbeti një nga pikat e kontestuara në vijim dhe mund të ketë hasur në devijime gjatë procesit të miratimit të aspektit legjislativ të saj. (Marrëveshja Kornizë e Ohrit, 2001, B, Paragrafi 4)

Një qasje ndryshe që rekomandohet në marrëveshjen kornizë të Ohrit mund të çojë deri te ndryshimi i perceptimit ndaj këtyre institucioneve nga komuniteti shqiptar, sidomos duke pasur parasysh numrin relativisht të vogël të pjesëmarrjes në forcat e rendit para periudhës së nënshkrimit të marrëveshjes dhe implikimet që ato kanë pasur për rendin dhe sigurinë. Ky perceptim negativ nuk është vetëm në sektorin e rendit dhe sigurisë, por përfshin një sërë elementesh të tjerë që kanë të bëjnë me përfaqësimin adekuat dhe proporcional të shqiptarëve në institucionet shtetërore. Fryma e Marrëveshjes së Ohrit lë një mundësi zhvillimi dhe përfshirjeje graduale të pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në këto institucione. E gjithë kjo për të garantuar pjesëmarrjen proporcionale të komuniteteve në institucionet e shtetit, në mënyrë që ato të jenë më të afërta dhe të japin

rezultate për kërkesat dhe nevojat e tyre. (Marrëveshja Kornizë e Ohrit, 2001, C, Paragrafi 5)

Ndonëse një nga segmentet e rëndësishme të një ndarje të pushtetit dhe përgjegjësi është edhe “autonomia substanciale” – siç shprehet Lijphart – në Maqedoni, një përkufizim territorial i tillë nuk ka ndodhur në procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, dhe as më pas gjatë aprovimit dhe aplikimit të kësaj marrëveshjeje. Në një kontekst të tillë është e vështirë të thuhet se në ç’drejtimi teorik hyn sistemi i aplikuar në Maqedoni. Në vetvete ai përfshin elemente që përcaktojnë deri në njëfarë mase një proces për ndarjen e pushtetit në një kontekst me dy kombësi, por kjo ndarje nuk identifikohet qartazi. Arsyet janë nga më të ndryshmet, por ajo që mund të përmendet në këtë kontekst është qëndrimi në marrëveshjen kornizë, se “nuk ka zgjidhje territoriale për problemet etnike” të Maqedonisë. (Marrëveshja Kornizë e Ohrit, 2001, A, Paragrafi 2) Si e tillë, zgjidhja e problemit, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik mori një përmasë tjetër, që i përgjigjej problemeve të mësipërme të qeverisjes vendore dhe mundësisë së zgjerimit të kompetencave të njësive bashkiake, duke u akorduar një mundësi si organizimi ashtu edhe vendimmarrjeje më të pavarur nga sistemi paraprak.

Ndonëse mundësia e riorganizimit territorial ishte e parashikuar të jepte një lloj avantazhi për komunitetet e tjera në çështje që kanë të bëjnë me probleme të natyrës vendore, ajo përsëri nuk i përgjigjet kontekstit të organizimit autonom territorial. Disa nga mundësitë që jepen si në zgjedhjen e shefit të njësisë së rendit por edhe në aspekte të organizimit financiar, ato nuk përgjigjen me mundësinë e një organizimi dhe mundësinë legislative që do të regullonte çështje të interesit nga një zonë e njësuar territoriale. Një qasje e tillë erdhi si kundërshtim i një organizimi territorial që mund të çonte drejt

federalizimit të shtetit, por, nga ana tjetër, nga komuniteti shqiptar shihej si një formë organizimi gjysmëqeverisës vendor. Ligjet e aprovuara që nga viti 2002 i qartësonin përgjegjësitë e pushtetit vendor duke zgjeruar një numër fushash ku bashkitë do kishin përgjegjësitë e tyre, duke u përmbyllur me ligjin e vitit 2004, në të cilën parashikohej edhe një riorganizim territorial i bashkësive. Së këndejmi del edhe një fakt ndryshe në përbërjen e popullsisë që fiton të drejtat e saj identitare dhe bën një refuzim të skajshëm të palës maqedonase duke organizuar referendum kundër ligjeve të pushtetit vendor. (Bieber, 2008 f. 35)

Një çështje tjetër që i ka prekur relacionet mes dy komuniteteve dhe perceptimet e tyre për kushte të pranueshme për ripërtëritje të aspekteve të kulturës dhe gjuhës ka qenë edhe ajo e arsimit dhe përdorimit të gjuhës amtare. Kjo është ngritur nga pala shqiptare si një nga segmentet e rëndësishme të zhvillimit të komunitetit shqiptar gjatë periudhlës së pavarësimit të Maqedonisë. U theksua më lart problemi i nevojës së arsimit të lartë dhe përdorimit të gjuhës në një cikël kohor ku një kërkesë e tillë e palës shqiptare edhe kundërshtohet me masa të jashtëzakonshme dhune. Por, një çështje e tillë, ndonëse ende e pakonsumuar deri në fund për arsye të diferencave në interpretim dhe për më tepër në perceptim, ka gjetur një zgjidhje përmes përcaktimeve të Marrëveshjes së Ohrit.

Me Marrëveshjen e Ohrit, përdorimi i gjuhës fiton një status të ngritur dhe të drejtën e përdorimit të saj në instanca të administrimit vendor dhe përdorimit të dokumenteve vetjake ndër të tjera. Në të thuhet se gjuhë zyrtare, përveç gjuhës maqedone dhe alfabetit të saj, është edhe gjuha që flitet nga më shumë se njëzet përqind e popullsisë. Përdorimi i saj duhet të merret parasysh me ligje shtesë që do përcaktojnë detyrimet shtetërore dhe përdorimin e gjuhës në nivel shteti. Në instanca të ndryshme ajo rregullohet me ligje të

veçanta, siç janë ligjet e qeversijes vendore dhe ato mbi shkollimin në gjuhën amtare. Pengesa të njëpasnjëshme rreth nivelit të përdorimit adekuat të gjuhës shqipe ka pasur në vazhdimësi që nga nënshkrimi i marrëveshjes, si pasojë e një perceptimi në vijim mbi formën e implementimit, por edhe të pronësisë së shtetit.

Këto dilema hapin mundësi dhe sfida të cilat i riciklojnë problemet duke mos ofruar ndonjë zgjidhje adekuate për to. (Ilievski, 2007, f. 12)

Një dinamikë e tillë vazhdoi edhe me çështjet e arsimit në gjuhën shqipe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, duke i dhënë një qasje taksative me ligje të veçanta në kuadrin e normave dhe përdorimit të gjuhës në të gjitha ciklet e arsimit. Marrëveshja thotë se “financimi për edukimin universitar për gjuhën që flitet nga më shumë se njëzet përqind të popullsisë do të bëhet nga shteti”. Në sajë të kësaj qasjeje zbulohet edhe zgjidhja e çështjes së universitetit të Tetovës në vitin 2004 dhe legalizimi i tij, duke hapur kështu mundësinë e financimit nga buxheti i shtetit dhe regullimin me ligj nga parlamenti. (Marrëveshja Kornizë e Ohrit, 2001)

6.4 Konkluzione

Në këtë kapitull shpalosëm një dinamikë ndërveprimi dhe disa çështje që paraqiten të një rëndësie të veçantë në aspektin e brendshëm të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë. Një dinamikë e tillë zhvillimore shpie drejt një analize të zgjeruar në atë hapësirë ku ndodhin ngjarjet, dhe se si ndërthuren ato në proces me rezultate që në raste të veçanta dalin nga një diskurs politik që lidhet me stabilitetin dhe sigurinë e shtetit. Në të shumtën e rasteve këto ndërveprime krijojnë një varësi mes veti, duke u përhapur në sektorë që kanë të bëjnë me shumë fusha të lidhura me sigurinë e njërës apo tjetrit

komunitet, që bën të mundshëm një kuptim tjetër mbi sfidat e sigurisë për aktorët që i krijojnë këto ndërveprime.

Duke prezantuar disa nga veçoritë e zgjerimit të fushave të sigurisë vërehet se siguria për një komunitet në raste konkrete mund të jetë një veprim ndryshe nga ajo që shteti e sheh si artikulum i mbrojtjes së sigurisë së tij nga brenda. Në shtetet multietnike sfidat mbi sigurinë mund të paraqiten jo thjeshtë në spektrin konvencional të analizuar përmes një qasjeje tradicionale mbi shtetin, por mund të kenë edhe forma të tjera që hapin dilema jo vetëm për sigurinë e territorit, por edhe të legjitimitetit të tij politik. Në veçanti kjo paraqitet e një rëndësie të veçantë kur elitat politike, përmes veprimeve të tyre, ndërmarrin hapa që janë në kundërshtim me pëlqimet e njërit prej komuniteteve të rëndësishëm që përbën shtetin. Veprimet e ndryshme dhe ujdia për një qasje normative duke mos përfillur shqetësimet e komunitetit tjetër, mund të hapin perceptime të ndryshme për natyrën e shtetit, dhe rrjedhimisht krijohet një dualitet në respektimin e legjitimitetit të normave të aprovuara.

Në këtë kontekst vjen edhe analiza në nivel të sigurisë shoqërore për të parë dhe reflektuar mbi zhvillimet që çojnë te gjendja e perceptimeve të ndryshme të një komuniteti mbi sigurinë që ai pranon nga institucionet e shtetit. Nëse shteti ka si përparësi sigurimin e territorit të tij dhe shtrirjen e legjitimitetit të institucioneve, nga ana tjetër, një komunitet/grup me një sfond identitar, kërcënimet ndaj sigurisë së tij i percepton bazuar te kërcënimet ndaj identitetit të tij, qoftë politik qoftë gjuhësor, kulturor etj.. Pra, këto perceptime, në një shoqëri ku identitetet komunitare mund të jenë të ndryshme, duhet të jenë të matura mirë, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm në procesin e formësimit të institucioneve, që të kenë një pasqyrim mbi specifikat e komunitetit, që për arsye të

ndryshme – në një kohë të caktuar – elitat e tij nuk arrijnë t'i artikulojnë mjaftueshëm kërkesat, ose nuk ka prirje për t'i pranuar ato nga elita e komunitetit tjetër.

Nga një dinamikë e tillë e zhvillimit të ngjarjeve në një periudhë që nga shpallja e pavarësisë pikaset një zhvendosje e problematikave në dy drejtime:

në njërën anë kemi veprime të elitës politike maqedonase për sigurimin e çështjeve që kanë të bëjnë me krijimin e shteti dhe institucioneve të tij bazuar në premisat e përparësisë së etnitetit sllavo-maqedonas;

nga ana tjetër kemi përpjekjen e komunitetit shqiptar për të gjetur mekanizma për eliminimin e kërcënimit të identitetit të formësuar të tij dhe përdorimit të forcës në ato raste kur pengohet shpërfaqja e këtij identiteti. Kjo dinamikë veprimi dhe ndërveprimi u përshkallëzua deri në atë masë sa shpërtheu konflikti i armatosur. Natyrisht që ndërveprime të tilla të sigurimit të njërit identitet duke mos reflektuar mbi nevojat e identitetit tjetër, në shtetet multietnike mund të shkaktojnë edhe përplasje të natyrës etnike.

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME

Përfundimi i Luftës së Ftohtë solli një numër sfidash të reja për shtetet, si për ato me një traditë më të gjatë veprimi në sistemin ndërkombëtar ashtu edhe për ato shtete që u krijuan apo fituan pavarësinë në proces të transformimit global. Këto sfida kërkonin një qasje dhe aplikim të atyre mekanizmave që nuk kishin patur një implikim parësor në sistemin ndërkombëtar deri në atë kohë. Dinamikat e sigurisë që u shfaqën rishtazi pas një transformimi të tillë të sistemit global nxorën në shesh një sërë sfidash që deri asokohe shtetet i kishin përballuar përmes një qasjeje tradicionale. Por, duke qenë se tani kishin një ambient të ndryshëm ndërkombëtar, verpime të tilla vunë në dyshim aplikueshmërinë e këtyre strategjive. Probleme të tilla si emigrimi, mbështetjet ideologjike, identiteti apo edhe ekzistenca e shteteve të mëdha shumëkombëshe ishin nga ato sfida që duheshin trajtuar në një këndvështrim tjetër.

Ndonëse shteti dhe fuqia që ai posedon mbetën koncepte të rëndësishme edhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, vargu i shqetësimeve të reja mbulonte një numër çështjesh që nuk ishin të lidhura me aspektet ushtarake. Në një gjendje të tillë transformimi global, popujt dhe shtetet hasën një gamë të shumëllojshme shqetësimesh, duke ndryshuar perceptimet dhe mënyrën e ndërveprimit në nivele të ndryshme, por edhe në fusha të zgjeruara, me qëllim ruajtjen e integritetit të shumëllojshëm të shtetit dhe eliminimin e rreziqeve që nisën të shfaqen. Mënyra e aplikimit të masave për parandalimin e rreziqeve ndryshonte shumë në varësi të shteteve që i aplikonin ato dhe pozitës gjeografike që kishin. Bashkëngjitur kësaj, shtetet filluan rishtazi të krijojnë masa ndërveprimi që lidheshin me aspektin e sigurisë së brendshme të tyre, por edhe me ndërvarësinë që shkatohej në

marrëdhënie me shtete e tjera, duke krijuar perceptime që shprehnin besueshmëri, interese të përbashkëta ose, në anën tjetër, duke shfaqur reciprocitet në frikë, skepticizëm dhe ndërvarësi negative.

Në një kontekst të tillë u gjend edhe Maqedonia si një entitet që kërkonte pavarësinë e në një rajon ku ndërveprimet e aktorëve ishin të lidhura mes veti si në vazhden e ngjarjeve në nivel global ashtu edhe në atë rajonal. Aplikimi e masave që ajo ndërmori u analizua nga këndvështrimi i një qasjeje të kombinuar; kjo për të pasur një kuptim më adekuat dhe gjithëpërfshirës për masat që u ndërmorën gjatë procesit të shkëputjes nga Federata Jugosllave, si dhe për problemet që u rishfaqën në kontekstin rajonal dhe atë të brendshëm. Në këtë drejtim, qëllimi i studimit paraqiti një dinamikë për ndryshimet që përfshinë rajonin, dhe se si çështje të ndryshme krijuan një numër politikash që kishin varësi në zgjidhjen e veprimeve të njëpasnjëshme nga ana e elitës politike të kohës.

Me ndryshimet që ndodhën në skenën politike ndërkombëtare u shfaq nevoja e një shqyrtimi ndryshe të teorive që studionin aspektet e sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Analiza dhe debatet mbi sigurinë filluan të zhvendosen nga një këndvështrim tradicional që kishte zënë rrënjë që herët në historikun e krijimit të shteteve, drejt një analizë më bashkëkohore, ku si përqendrim kryesor në debatin mbi sigurinë u futën edhe elemente shtesë, duke e zgjeruar analizën në vija horizontale dhe vertikale dhe duke e analizuar sigurinë në përmasat e ndërveprimit shoqëror, por edhe insitucional. Një sërë implikimesh si për sigurinë e shtetit ashtu edhe për mirëqenien e tij u parqitën si rezultat i fenomeneve të reja dhe ndryshimeve globale, duke ndryshuar konceptin bazë mbi shtetin dhe shtetndërtimin.

Aktori shtet, që ishte si më i rëndësishmi në një hapësirë të tillë ndërkombëtare, jo se humbi rëndësinë, por u detyrua që për mirëqenien e tij të shqyrtonte segmente të tjera që kishin potencialin e influencës mbi sigurinë si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Tashmë siguria nuk përbënte vetëm sektorin ushtarak, duke legjitimuar sovranitetin e shtetit, por kërkonte një dinamikë tjetër analize mbi fenomenet e reja në një hapësirë globale ku teknologjia, shkëmbimi dhe ndërveprimi në shumë fusha kish fituar përmasa që shkonin përtej kontrollit të shtetit. Globalizmi ndryshoi mënyrën e komunikimit, por, edhe ndryshimet ideologjike hapën mundësinë e lëvizjes jo vetëm të ideve, por edhe të një emigrimi të mundshëm njerëzish, gjë që në thelb mund t'i ndryshonte shtetet që u njohën deri asokohe.

Duke pasur parasysh këto ndryshime, studimi përqendrohet te një analizë e zgjeruar e paradigmave të sigurisë së Maqedonisë, duke marrë si bazë konceptet e analizës së sigurisë të Shkollës së Kopenhagenit. Kjo qasje shqyrton aspekte shtesë nga ato tradicionalet, duke e zgjeruar qasjen si në fusha të ndërveprimit ashtu edhe në nivele analize. Kështu ajo na jep mundësinë e një kutpimi më të gjerë të fushave të analizës, që të kemi një pasqyrë shumëpërmasore të sigurisë, duke u nisur nga lidhjet që mund të shfaqen mes tyre. Analiza e sigurisë nisët nga marrëdhëniet e shteteve dhe të grupeve që mund të ndërveprojnë brenda saj, dhe kjo e zhvendos edhe nivelin e analizës jo vetëm në fushën e ndërveprimit, por edhe në atë të lokacionit ku mund të ndodhë veprimi dhe marrëdhënia. Në këtë drejtim studimi përqendrohet në një analizë të tre niveleve, duke pasqyruar fusha ndërveprimi që ndërlidhen me njëra-tjetrën dhe rezultatet që ato japin në gjendjen e sigurisë së Maqedonisë.

Siguria në këtë kontekst paraqitet si një përkufizim ku ajo shënjon segmente “të mbrojtjes së lirisë nga kërcënimet e ndryshme dhe aftësitë e shteteve dhe shoqërive për të mbrojtur identitetin e tyre kundrejt forcave armiqësore. Funksioni parësor i saj është asgjësimi i shqetësimeve mbi ekzistencën dhe kushtet e mbijetesës”. (Buzan, 1991) Për të mbërritur deri te kushtet e sigurimit të saj, shoqëritë apo shtetet ndërmarrin një sërë veprimesh që në fillim paraqiten si faktorë politikë, duke e intensifikuar atë deri në atë masë sa problemet apo çështjet të paraqiten si kërcënuese për të lindur nevoja e ndërmarrjes së veprime shtesë, nga ato që janë të certifikuara në bazë të normave ekzistuese, duke kaluar në masa të jashtëzakonshme me kërkesa për veprime urgjente. (Buzan, Waever & Wilde, 1998)

Ndonëse forma tradicionale e analizës së sigurisë së Maqedonisë përqendrohet te qasjet tradicionale të veprimit, ajo ndihmon në gjetjen e kushteve që çojnë deri te një perceptim fillestar mbi ndërtimin e shtetit. Kushtet me të cilat mëtoi themelimin e saj kishin si pikënisje një orientim klasik të veprimit të elitave politike në përpjekje për vendosjen e sovranitetit të shtetit si në marrëdhënie me shtetet që e rrethonin ashtu edhe me veprimet drejt shtrirjes së legjitimitetit të normave të aporvuara gjatë kësaj periudhe edhe në rafsh të brendshëm. Kordinatat kryesore të saj ishin të trashëguara nga një traditë që në thelb kishte pikënisjen e kushteve të krijuara për shtetësinë e saj në një hapësirë të ndryshueshme rajonale, dhe vazhdoi edhe me përpjekjet për vendosjen e sovranitetit të plotë. Masat e ndërmarra për ballafaqimin me koncepte të tilla për sigurinë dhe rreziqet që shtroheshin nuk iu përgjigjën kërkesave në kuadër të politikës së brendshme, asaj të mbrojtjes dhe politikës së jashtme të sigurisë. Ato nuk përfshinin një dimension të zgjeruar të trajtimit adekuat, por ishin një zgjatje dhe politizim deri në atë masë sa nga një spektër politik të

kalonin në një nivel trajtimi me masa urgjente dhe të jashtëzakonshme në aplikim të politikave të sigurisë.

Në sajë të një përcaktimi të tillë dhe duke qenë se Maqedonia kalonte nëpër një rrugë tranzicioni, por njëkohësisht edhe shtetndërtuese, ajo nuk arriti t'i shmangej koncepteve tradicionale, duke anashkaluar sfidat e reja që ishin spikatur si rrjedhojë e ndryshimeve globale. Ajo u angazhua në krijimin e institucioneve që karakterizoheshin me një frymë nacionalizmi, duke treguar një formë tranzicioni dhe pavarësimi për të përmirësuar gjendjen e grupit etnik dominues, duke përdorur mekanizmat institucionalë. Një privilegjim i tillë u kalua në kurriz të krëkesave të popullsisë shqiptare, duke treguar qartazi një preferencë shtetndërtuese me homogjenizim etnik. Në këto kushte diskriminimi ishte i pashmangshëm, duke krijuar një hapësirë politike për ndërmarrjen e masave të jashtëzakonshme ndaj krëkesave të shqiptarëve në proces e sipër.

Sovraniteti në kushte të reja sigurie kishte shqetësime shtesë dhe referohej te një koncept jo thjesht për sigurinë e shtetit në mënyrë të njëanshme ndaj sfidave, sepse në raste të tilla mund të gjeneronte një gjendje të diskutueshme stabiliteti. Përgjegjësia e sovranitetit tani shtrihej në kushtet që krijonte dhe shfaqte për sigurinë e popullsisë, gjendjen ekonomike në shtet, infrastrukturën dhe sundimin e së drejtës etj. Nëse ajo nuk i krijon dhe siguron këto segmente, apo i aplikon ato në mënyrë ekskluzive, ndarja shoqërore është gati e pashmangshme, dhe në rastin e shteteve me popullsi të përzier gjeneron edhe kriza legjitimiteti karshi sovranitetit.

Komunitet e ndryshme shoqërore, bazuar në një koncept të zgjeruar të analizës së sigurisë, kërkojnë edhe aplikimin e masave mbrojtëse kur është fjala për kushtet e mbijetesës, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e gjuhës së identitetit dhe normave të tjera

kulturore të grupit. Në rastin konkret, komuniteti shqiptar e gjeti veten të rrezikuar nga qasja selektive dhe kufizuese e përdorimit të këtyre shenjave dalluese. Në raste të tilla, kur shfaqet një rrezik ndaj identitetit, atëherë kërkohen edhe masa që çojnë drejt kërkesës për mbrojtje nga rreziku. Komuniteti shqiptar e gjeti veten në një pozitë ku ishte i detyruar të ndërmerre hapa që do të grantonin kushte për ekzistencën e tij në hapësirën përkatëse. Kësisoj, në procesin shtetformues të Maqedonisë kemi një garë mes dy etnive për çështjen se çfarë përfaqëson shteti dhe çfarë sigurie garanton. Për më tepër, në kushte të tilla që shumë e qartë se institucionet krijuan një ndarje në vijën horizontale dhe vertikale, që kishte si pasojë një stabilitet të ulët dhe institucione të dobëta shtetërore, duke hedhur dyshim në legjitimitetin e tyre.

Marrëdhëniet ndëretnike u bënë problemtike në kohën kur shtetësia e Maqedonisë mori rrugën e ndërtimit të institucioneve. Autoritetet politike të kohës nuk i kushtuan rëndësinë e duhur marrëdhënieve ndërmjet dy komuniteteve, por në vend të një procesi integruar zgjodhën përjashtimin për palën shqiptare. Me zhvillimet njëpasnjëshme, ku komunitetit shqiptar i refuzohej e drejta e shprehjes së identitetit të tij, politika e sigurisë së Maqedonisë u përqendrua në një gjendje konflikti të mundshëm, duke identifikuar çështje politike të komunitetit shqiptar si kërcënim për shtetin. Kundrejt mundësisë për t'u marrë parasysh këto çështje si elemente përbërëse të shtetit, autoritetet e shtetit imponuan nevojën për fillimin e një përplasjeje. Një zgjidhje e tillë e sigurimit hapi rrugën e një përplasjeje jo vetëm të sigurisë, por edhe të ideologjisë së shtetit, që ishte ndërtuar në premisa etnocentrike.

Rajoni i Europës Juglindore ka një agjendë të ngjeshur çështjesh të sigruisë që lidhen me një sferë më të gjerë kontinentale. Poizicioni i Maqedonisë bën të mundur që

qëndrimet mbi orientimet e saj të marrin vëmendjen e institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare, por edhe të strukturave të tjera rajonale. Duke qenë si pjesë prëbërëse e këtij rajoni, Maqedonia përballlet pothuajse me të njëjtat sfida që paraqiten në rajon. Nga këndvështrimi i një historiku të shkurtër, përvoja e saj ndryshon në disa aspekte nga përvoja e shteteve të tjera të rajonit. Por, në të njëjtën masë shteti është hasur me çështje që kanë ndikuar edhe te perceptimet e tij mbi rajonin dhe veten. Mendimet e ndryshme mbi sfidat dhe mundësitë që janë paraqitur janë të llojllojshme, dhe nisur nga kjo i tillë është edhe impakti që ka pasur rajoni në sigurinë e tij. Maqedonia që në gjendje që të fitonte pavarësinë e saj pa ndonjë konflikt me ushtrinë jugosllave, dhe pasojat e drejtpërdrejta ishin të kufizuara.

Nga një kënvështrim i zgjeruar vërehet se çështja e Maqedonisë është mëse e pranishme në agjendën rajonale dhe marrëdhëniet e saj me shtetet e tjera në rajon. Kështu, çështja Maqedoni ka një dinamikë që ngërthen aktivitete të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin me shtete të veçuar, duke spikatur rëndësinë e lidhjes së saj në aspektin rajonal. Në këtë drejtim vihet re një diskurs që shfaq ndërvarësi të shteteve fqinje, deri në atë masë sa të marrë trajta mosbesimi, duke artikuluar perceptime negative. Megjithëse dendësia e tyre ndryshon nga një periudhë në tjetrën, kryesisht është varur nga përvoja e shtetit deri në krijimin e tij me shpalljen e pavarësisë në kushtet që shpjeguam. Një përvojë e tillë, po ashtu, shpreh ndërvarësinë e çështjeve që kanë të bëjnë me shtetet e tjera, ashtu siç artikulohet nëpërmjet një shjegimi teorik të kompleksit të sigurisë.

Përfshirja dhe prania e faktorëve ndërkombëtarë në Maqedoni krijoi mekanizma që do të shërbenin si platformë për një tranzicion në vijim. Prania e tyre ishte e shumëllojshme, duke aktivizuar çështje që kishin të bënin me politika të ndryshme, si ato ekonomike dhe

fusha të tjera, por duke mos anashkaluar as ato të sigurisë. Një prani e tillë, ndonëse ka një qasje strukturore, veçanërisht ajo e Bashkimit Europian, të lë të kuptosh nevojën e një organizimi sistemor që do u përgjigjet sfidave të kohës me një qasje tjetër nga ajo e pikënisjes së shtetndërtimit. Kjo shihet edhe me besimin që shpaloset nga opinioni publik në lidhje me integrimet europiane në përgjithësi, por edhe me masat e ndërmarra në këtë rrugëtim në veçanti.

Në këtë kontekst kemi edhe një analizë të sigurisë shoqërore që paraqitet në dinamikën e sigurisë së brendshme të Maqedonisë. Duke reflektuar mbi zhvillimet që çuan deri te perceptimet e ndryshme për çështjen se si duhet të duket shteti për të gjithë, kemi krijuar perceptimeve të ndryshme që u përvijuan në këtë rrugëtim. Pra, cilat janë ato premisa mbi të cilat ndërtohet shteti dhe si e mëton ai legjitimitimin në sektorë të ndryshëm të grupeve që e prebëjnë atë, mund të luajë një rol në përcaktimet e shanseve dhe sfidave që shfaqen në drejtim të paradigmave të sigurisë.

Bibliografia

- 1 Ackermann, A. (1999). Managing Conflicts Non-Violently Through Preventive Action. *Journal of Conflict Studies*.
- 2 Adler, E., & Barnett, M. (1998). *Security Communities*. Cambridge: Cambridge University Press.
- 3 Agestam, L., & Hyde-Price, A. (2006). *Security and Identity in Europe: Exploring the New Agenda*. Palgrave Macmillan.
- 4 Alagjovovski, R., & Stavrova, B. (2003, December 03). Macedonias Census Opens New Doors. *Transitions Online*.
- 5 Arel, D., & Kertzer, D. I. (2001). *Census and Identity: The Politics of Race, Ethnicity and Language in National Census*. Cambridge: Cambridge University Press.
- 6 Bieber, F. (2008). Power Sharing and Implementation of Ohrid Framework Agreement. In F. Bieber, *Power Sharing and Implementation of Ohrid Framework Agreement* (pp. 7-41). Shkup: Friedrich Ebert Stiftung.
- 7 Brubaker, R. (1996). *Nationalism Reframed: Nationhood and National Question in New Europe*. Cambridge University Press.
- 8 Brunnbauer, U. (2002). the Implementation of Ohrid Framework Agreement- Macedonian Resentment. (1).
- 9 Brunnbauer, U. (2004). Fertility, Families and Ethnic Conflict: Macedonian And Albanians in the Republic of Macedonia. *The Journal of Nationalism and Ethnicity*.

- 10 Buzan, B. (1991). *People, States and Fear; An Agenda for International Security*. Hertfordshire: Harvester Wheatsheaf.
- 11 Buzan, B., & Weaver, O. (2003). *Regions and Powers*. Cambridge: Cambridge University Press.
- 12 Buzan, B., Waever, O., & Wilde, J. D. (1998). *Security: A New Framework For Analysis*. London: Lynne Rienner Publishers.
- 13 Buzan., B. (1991). New Patterns of Global Security in the Twenty First Century. *International Affairs*, 431-435.
- 14 Cavelty, M. D., & Mauer, V. (2010). *The Routledge Handbook of Security Studies*. London, New York: Routledge, Taylor and Francis Group.
- 15 Cho, Y. C. (2009). Conventional and Constructivist Approaches to National Security. *The Korean Journal of International Relations*, 75-102.
- 16 Chryssochoou, D. N. (2001). *"Theorizing European Integration"*. London: Sage.
- 17 Cierco, T. (March 2006). Stabilizing Macedonia: The Key Role of European Union.
- 18 Collins, A. (n.d.). *Studime Bashkëkohore të Sigurisë*. Tiranë: UET Press.
- 19 Courbage, Y. (2003). Census, Elections and Population: The Case of Macedonia. *Institut National d'Etudes Demographiques*, 429-450.
- 20 Craven, M. C. (1996). What's in a Name? *Australian Yearbook of International Law*.
- 21 Danforth, L. M. (1995). Transnational Influences on National Conflict: The Macedonian Question. *Political And Legal Anthropology review*, 19-34.

- 22 Daskalovski, Z. (2002). Language and Identity: The Ohrid framework Agreement and Liberal Notions of Citizenship and Nationality in Macedonia. *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues In Europe*.
- 23 Deutch, K. W. (1957). *Political Community and the North Atlantic Area. International Organization in the Light of Historical Experience*. Princeton: Princeton university press.
- 24 Dreyzov, K. (1991). Macedonian Identity: An Overview of Major Claims. In J. Pettifer, *The New Macedonian Question* (pp. 47-59). London : Palgrave Macmillan.
- 25 Engstrom, J. (2002). Multiethnicity or Binationalism:The Ohrid Framework Agreement and Future of Macedonian State. *Journal Of Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, 2-21.
- 26 Engstrom, J. (2002). The Power of Perception: The impact of the Maedonian Question on Inter-Ethnic Relations in the Republic of Macedonia. *The Global Review of Ethnopolitics*, 3-17.
- 27 European Comission, Progress Report. (2011). *Progress report*. Brussels: European Comission.
- 28 Faber, A. (2009). The Effects of Enlargement on European Polity. In G. Avery, A. Faber, & A. Schmidt, *Enlargin the European Union: Effects on the New member States and the EU*. Brussels: trans European Policy Studies Association.
- 29 Firedman, V. (2002). Observing the Observers: Language, Ethnicity and Power in 1994 Macedonian Census and Beyond. *New Balkan Politics*.
- 30 Gilpin, R. (1996). No One Loves a Political Realist. 5(3).
- 31 Gligorov, V. (2004). European Partnership With Balkans. 2.

- 32 Gocevski, T. (2006). *Bazat e mbrojtjes Nacionale të Maqedonisë*. Shkup: Fakulteti Filozofik Shkup.
- 33 Haas, E. (1958). *The Uniting of Europe: Political, Social and Economic Forces 1950-1957*. Stanford University Press.
- 34 Hayden, R. (1999). *Blueprint for a House Divided: The constitutional Logic of the Yugoslav Conflict*. Ann Arbor : Universitz of Michigan Press.
- 35 Hislope, R. (2004). *How Is Ethnic Peace Possible, Explaining Macedonia's Peaceful Decade*. Chicago: Midwest Political Science Association.
- 36 Holliday, G. (2004). From Ethnic Privileging to Power Sharing: Ethnic Dominance and Democracy in Macedonia. In S. Smooha, *Fate of Ethnic Democracy In Post Communist Europe*. Budapest: Open Society Institute.
- 37 Hopf, T. (1998). The Promise of Constructivism in International Relations. *International Security*, 171-200.
- 38 Huysmans, J. (2000). The European Union and the Securitization of Migration. *Journal of Common Market Studies* , 751-777.
- 39 Ilievski, Z. (2007). Conflict settlement agreement Macedonia. *European Academy Bolzano*, 2-37.
- 40 International Crisis Group. (2001). *Macedonia's Name: Why The Dispute Matters and How to Resolve it*. Skopje/brussels: ICG.
- 41 J.Morgenthau, H. (1978). *Politics among Nations, the struggle for power and peace*. New York: Alfred A. Knopf.

- 42 Jackson, R. H., & Sorensen, G. (2007). *Introduction to International Relations; Theories and Approaches*. Oxford University Press.
- 43 Janev, I. (vol. 93, January 1999). Legal aspects of the use of provisional name for Macedonia in the United Nations system. *The American Journal Of International Law*.
- 44 Jano, D. (2009). The Whys and When enlarging EU to the Western Balkans. *European Journal of Economic and Political Studies*, 61-77.
- 45 Jano, D. (Summer 2009). Aspects of Security" Dilemma" What we have learned from Macedonian case.
- 46 Jervis, R. (1978). Cooperation under Security Dilemma. *30*(2).
- 47 Jovic, D. (2001). Fear of Becoming Minority as a Motivator of Conflict in Former Yugoslavia. *Blakanologie*, 21-36.
- 48 Katzenstein, P. (1996). *The Culture of National Security*. New York : Columbia University Press.
- 49 Koinova, M. (2011). Challenging Assupmtions of Enlargement Literature: The EU, Democratization and Human Rights in Macedonia. *Europe Asia Studies*.
- 50 Kratochwill, F. (1993). The Embarrassement of Changes; Neo-Realism as the Science of Realpolitics without Politics. *Review of International Studies*, 63-80.
- 51 Krause, K., & Williams, M. (1996). Broadening the Agenda of Security Studies: Politics and Methods. *Mershon International Studies Review* , 229-254.
- 52 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Preambula (Gazeta Zyrtare N. 52 1991).

- 53 Lake, D. A., & Morgan, P. M. (1997). *Regional Orders: Building Security in a New World*. University Park : Pennsylvania State University.
- 54 Lijphart, A. (1977). *Democracy In Plural Societies: A Comperative Exploration*. New Heaven : Yale University Press.
- 55 Lilly, C. (2001). *Power and Persuasion: Ideology and Rethoric in Communist Yougoslavia 1944-1953*. Boulder: Westview Press.
- 56 Lynch, D., & Missiroli, A. (n.d.). ESDP Operations. *Institute for Security Studies*.
- 57 Maleska, M. (2005). What Type of Political System did Macedonia get After The Ohrid Peace Agreement. *New Balkan Politics*.
- 58 Markovikj, N., & Popovijk, M. (2015). *Dialogu Politik*. Shkup: Konrad Adenauer.
- 59 (2001). *Marrëveshja Kornizë e Ohrit*.
- 60 Mathews, B., & Ross, L. (2010). *Metodat e Hulumtimit*. Tiranë: Centre For Democratic Education.
- 61 Mazower, M. (2000). *The Balkans*. London: Phoenix Press.
- 62 McGrew, A. (2002). Liberal Internationalism;Between realism and Cosmopolitanism. In A. M. David Held, *Governing Globalization: Power, Authority and Global Governance*. Polity Press.
- 63 Mearsheimer, J. (1994/95). The False Promise of International Institutions. *International Security*, 5-49.
- 64 Mitrany, D. (1996). *A Working Peace System*. Chicago: Quadrangle Books.

- 65 Nacev, Z., & Petreski, T. (2013). *Proekcionet Strategjike Të R. Maqedonisë Në Politikën e jashtme dhe Sigurisë*. Kocani: Evropa 92.
- 66 Ostreni, G. (2014). *UÇK: Shkaqet, Lufta dhe Paqja në Maqedoni në vitin 2001*. Dibër: Arbëria Design.
- 67 Pettifer, J. (2001). *The New Macedonian Question*. Palgrave Macmillan.
- 68 Ragaru, N. (January 2008). Macedonia: Between Ohrid and Brussels. 107.
- 69 Rakipi, A. (2008). *Weak States and Security*. Tirana: Albanian Institute for International Studies.
- 70 Ramcharan, B. (1997). *The international Conference on the Former Yugoslavia: Official Papers*. Brill.
- 71 Reka, A. (January 2008 vol 9). The Ohrid Agreement: The Travails of Interethnic Relations in Macedonia. *Human Rights Review*, 55-69.
- 72 Rexhepi, Z. (2005). *Zhvillimet Politiko-Shoqërore të Shqiptarët në Maqedoni 1991-2001*. Tetovë: Tringa.
- 73 Risteska, M. (2007). The Macedonian Accession to European Union. *Centre for research and Policy making*.
- 74 Rosamond, B. (2000). *Theories of European Integration*. McMillan.
- 75 Rossos, A. (1994). The British Foreign Office and Macedonian national Identity 1918-41. *Slavic Review*.

- 76 Roudometof, V. (2002). *Collective Memory, National Identity and Ethnic Conflict: Greece, Bulgaria and MAcedonian Question*. Praeger.
- 77 Saleh, A. (2010). Broadening The Concept Of Security. *Geopolitics Quarterly*, 228-241.
- 78 Schimmelfennig, F., & Sedelmeier, U. (August 2002). Theorizing EU enlargement: research focus, hypotheses, and the state of research. 9(4).
- 79 Schneckener, U. (January 2002). Developing and Applying EU Crisis Management: Test Case Macedonia. 14.
- 80 Seraphinoff, M. (2008). Dimensions of the Greek-Macedonian Dispute. www.macedonianlit.com.
- 81 Simmons, B. A., & Kelley, J. G. (2014). Politics by Number: Indicators as Social Pressure in International Relations. *American Journal of Political Science*, 1-56.
- 82 Smith, A. (1995). *Nations And Nationalism*. Cambridge: Polity Press.
- 83 Smooha, S. (2001). *The Model of Ethnic Democracy*. Flensburg: ECMI Working Paper .
- 84 Smouts, M.-c. (2001). *The New International Relations: Theory and Practice*. London : C. Hurst & Co.
- 85 Sokoli, L. (2011). *Metodat e Kërkimit*. Tiranë: Instituti I Sociologjisë.
- 86 *State Statistical Office*. (n.d.). Retrieved 2016
- 87 Stefanovski, I. (July 2009). Negotiating a Potholed Road: The Republic of Macedonia on its Journey Towards EU.

- 88 Steunenberg, B. (2001). Enlargement and Institutional Reform in the European Union: Separate or Connected. *Constitutional Political Economy*, 351-370.
- 89 Stone, M. (2009). Security According to Buzan: A Comprehensive Security Analysis. *GEEST*.
- 90 Talevski, D. (2007). Public opinion and EU Integration, Attitudes and EU Integration in Macedonia.
- 91 Vankovska, B. (2000). Civil Military Relations in Macedonia. *Copenhagen Peace Research institute*.
- 92 Vankovska, B. (2008). *Institucionet e Bashkimit Europian*. Shkup: Fakulteti Filozofik.
- 93 Vayrynen, R. (2000). Stable Peace through Securitz Communities? Steps Towards Theory Building. *Joan B. Kroc Institute Occasional Articles*.
- 94 Vlora, I. (1965). *Kujtime*. Tiranë.
- 95 Waever, O., Buzan, B., Kelstrup, M., & Lemaitre, P. (1993). *Identity, Migration and the New Security Agenda In Europe*. New York: St. Martins Press.
- 96 Waltz, K. (1979). *Theory of International Politics*. Reading: Addison-Wesley.
- 97 Wiener, A. (2003). Constructivism: The Limits of bridging the gap. *Journal of International Relations and Development*, 252-275.
- 98 Zachariadis, N. (1994). Natioanlism and small State foreign Policy. *Political Science Quarterly*.

